


SHQIPËRIA NË PROCESIN E BERLINIT



ARRITJET AKTUALE
DHE SFIDAT
E SAMITIT TË PARISIT
Vjeshtë 2015

SHQIPËRIA NË PROCESIN E BERLINIT

*Arritjet aktuale
dhe sfidat e Samitit të Parisit*

Vjeshtë 2015

Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim / ShtetiWeb



ShtetiWeb

**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**



**Hanns
Seidel
Stiftung**



**Konrad
Adenauer
Stiftung**

Botimi u mundësua nga:

Fondacioni Friedrich Ebert

Zyra Tiranë

Rr. "Abdi Toptani", Torre Drin

Kati 3, P.O. Box 1418

Tiranë, Shqipëri

www.fes-tirana.org

Fondacioni Hanns Seidel

Hotel "Europapark"

Bvd. Dëshmorët e Kombit

Tiranë, Shqipëri

<http://www.hss.de/albanien>

Fondacioni Konrad Adenauer

Zyra Shqipëri

Bvd. "Dëshmorët e Kombit"

Kulla binjake 1, Kati 11, Zyra A3


Tiranë, Shqipëri

<http://www.kas.de/albanien>

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Friedrich Ebert, të Fondacionit Hanns Seidel dhe të Fondacionit Konrad Adenauer.

Ky botim nuk mund të përdoret për arsye tregtare pa miratimin me shkrim të autorëve dhe të tre fondacioneve të sipërpërmendura.

ISBN:



PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	4
<i>“Shqipëria në Procesin e Berlinit: Arritjet aktuale dhe sfidat e Samitit të Parisit”</i> - ARDIAN HACKAJ, GENTIOLA MADHI, KRISELA HACKAJ, Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim/ShtetiWeb	5
<i>“Shoqëria Civile: Aktor politik në Ballkanin Perëndimor”</i> - FRANK HANTKE, Drejtor i Fondacionit Friedrich Ebert, Zyra Tiranë	39
<i>“Procesi i Berlinit: Hapi i ardhshëm në rrugën e integritetit të Ballkanit Perëndimor në BE”</i> - KLAUS FIESINGER, Shef i Departmentit të Evropës Qëndrore, Lindore dhe Juglindore, Kaukazit dhe Azisë Qendrore, Fondacioni Hanns Seidel	41
<i>“Reformat e mëtejshme dhe bashkëpunimi i ngushtë ekonomik i vendeve të Ballkanit Perëndimor”</i> - THOMAS SCHRAPEL, Drejtor i Fondacionit Konrad Adenauer, Zyra për Shqipërinë	43
<i>“Nga Konferenca e Berlinit tek Procesi i Berlinit: Një perspektivë gjermane”</i> - HELLMUT HOFFMANN, Ambasador i Republikës Federale Gjermane në Shqipëri	45
<i>“Samiti i Parisit: Piketa e ardhshme për bashkëpunimin rajonal”</i> - BERNARD FITOUSSI, Ambasador i Francës në Shqipëri	47
<i>“Plotësim apo devijim: Si ndikon ndërlidhja tek dinamikat e integritetit në BE të Ballkanit Perëndimor?”</i> - JAN RUDOLPH, Shef i Seksionit Politik, Ekonomik dhe Informacionit, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri	51
<i>“Përfitime të prekshme për vendin/qytetarët: Projektet e konektivitetit”</i> - NAND SHANI, Menaxher Programi, Shkolla Rajonale e Administratës Publike	53
<i>“Konteksti institucional, instrumentat financiarë dhe mekanizmat: Parakushtet për një proces kombëtar efikas”</i> - ARDIAN HACKAJ, Drejtor i ShtetiWeb	56
<i>“Agjenda e Qeverisë Shqiptare”</i> - ODETA BARBULLUSHI, Zëvendësministre e Punëve të Jashtme	60
<i>“Kontributi i Parlamentit (I)”</i> - MAJLINDA BREGU, Kryetare e Këshillit Kombëtar të Integritetit Evropian	63
<i>“Kontributi i Parlamentit (II)”</i> - EDUART SHALSI, Kryetar i Komisionit Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese, Tregëtinë dhe Mjedisin	65
<i>“Kontributi i Parlamentit (III)”</i> - GENC POLLO, Kryetar i Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik	67

PARATHËNIE

Ky botim është dokumenti i parë që analizon Procesin e Berlinit. Ai është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë të CDI / ShtetiWeb dhe OSHC-ve partnere rajonale, Fondacionit Friedrich Ebert, Fondacionit Hanns Seidel, Fondacionit Konrad Adenauer, Ambasadave Gjermane dhe Franceze në Tiranë, Delegacionit të BE-së në Shqipëri, Kryeministritë, Ministritë së Punëve të Jashtme dhe deputetëve të shquar të Kuvendit të Shqipërisë.

Pjesa e parë e botimit përfshin një punim kërkimor mbi Procesin e Berlinit, të kryer nga studiuesit e CDI / ShtetiWeb, dhe të kompletuar me një vlerësim të pozicionit të Shqipërisë në këtë proces deri në nëntor 2015. Punimi kërkimor shërbeu si dokument pune për konferencën “*Shqipëria në Procesin e Berlinit: Vlerësime dhe Rekomandime – Vjeshtë 2015*”, organizuar në Tiranë, në 5 nëntor 2015. Kontributet e pjesëmarrësve u redaktuan dhe gjenden në pjesën e dytë të botimit.

Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë të gjithë kontribuesve për kohën dhe angazhimin e tyre në këtë përpjekje të madhe. Çdo gabim apo mangësi e mundshme është përgjegjësia jonë.

Konferenca mbi Procesin e Berlinit do të ndiqet në 2016 nga nisma të tjera në Shqipëri dhe në vendet e Ballkanit Perëndimor, në funksion të përgatitjes së kontributit të OSHC-ve për Samitin e Parisit.

CDI / ShtetiWeb

Tiranë, Dhjetor 2015



Ardian HACKAJ, Gentiola MADHI, Krisela HACKAJ

SHQIPËRIA NË PROCESIN E BERLINIT

*Arritjet aktuale
dhe sfidat e Samitit të Parisit*

Vjeshtë 2015



Lista e tabelave

Tabela 1: Panorama e fushave politike të përfshira në çdo dokument politik, 2013-2015	13
Tabela 2: Lista e samiteve dhe ministerialeve 2014-2015	15
Tabela 3: Lista e Vetme Sektoriale e Projekteve Prioritare Strategjike, Nëntor 2015	25
Tabela 4: Pjesëmarrësit e Konferencës së Berlinit dhe Samitit të Vjenës	33

Lista e shkurtimeve

BE	Bashkimi Evropian
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qëndrore
FES	Fondacioni Friedrich Ebert
IPA	Instrumenti i Para-Anëtarësimit
KfW	Banka e Zhvillimit KfW
MARRI	Iniciativa Rajonale për Migrimin, Azilin dhe Refugjatët
NERP	Programi Kombëtar i Reformës Ekonomike
NPZHS	Njësia për Planifikim dhe Zhvillimin Strategjik
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PIKE	Projekte me Interes të Komunitetit të Energjisë
RCC	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
SEE	Evropa Juglindore
SEECp	Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore
SEETO	Observatori i Transportit për Evropën Juglindore
SMG	Grupi për Menaxhim Strategjik
SPP	Lista e Vetme e Projekteve Prioritare Strategjike
SRC	Kritere të Rëndësisë Strategjike
SSMG	Grupi Sektorial për Menaxhim Strategjik
SSPP	Lista e Vetme Sektoriale e Projekteve Prioritare Strategjike
SWG	Grupi Sektorial i Punës
TEN-T	Rrjeti Trans-Evropian i Transportit
WB6	Vendet e Ballkanit Perëndimor
WBIF	Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor



Nën udhëheqjen e Kancelares Gjermane Angela Merkel, në gusht 2014, u organizua në Berlin një Konferencë e Nivelit të Lartë për Ballkanin Perëndimor. Konferenca synonte të tregonte angazhimin e palëkundur politik të Bashkimit Evropian për zgjerimin e ardhshëm të Ballkanit Perëndimor.

Konferenca e Berlinit ishte pika fillestare e krijimit të të ashtuquajturit “Proces i Berlinit”. Kjo nismë e re ka për qëllim përmirësimin e qeverisjes së përbashkët ekonomike rajonale - në kuadër të perspektivës evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor – duke hedhur themelet për një rritje ekonomike të lartë dhe të qëndrueshme. Procesi do të kontribuojë në forcimin e një mjedisi të shëndoshë ekonomik dhe të strukturave të besueshme politike, ligjore dhe shoqërore në këto vende.

Procesi i Berlinit ka një agjendë – të njohur si “Agjenda e Berlinit” – e cila fokusohet kryesisht në qeverisjen ekonomike dhe projektet e ndërlidhjes infrastrukturore. Agjenda përdor programet ekzistuese të financimit, si Kuadri i Investimeve për Ballkanin Perëndimor, institucione dhe mekanizma si Komiteti Kombëtar për Investimet, Grupet Sektoriale të Punës, Lista e Vetme e Projekteve Prioritare Strategjike, etj., për të identifikuar, përzgjedhur dhe mbështetur financiarisht nismat rajonale, përfshirë këtu dhe projektet infrastrukturore dhe “masat e buta”. Agjenda e Berlinit është e harmonizuar me politikat përkatëse të BE-së, nëpërmjet nismave ekzistuese si TEN-T, SEETO ose PIKE.

Gjithsesi, Procesi i Berlinit mbetet ende një risi jo e mirëdokumentuar. Ka shumë pak dokumente zyrtare, studime, vlerësime, etj. që ofrojnë një panoramë gjithëpërfshirëse mbi këtë iniciativë jashtëzakonisht të rëndësishme. Kundrejt këtij mjedisi, ky punim kërkimor synon të mbulojë këtë boshllëk dhe të sigurojë një skicë të parë të këtij procesi.

Metodologjia bazohet në identifikimin, analizën dhe vlerësimin e: a) deklaratave zyrtare, deklaratave të përbashkëta, fjalimeve publike, deklaratave politike dhe njoftimeve për shtyp të aktorëve kryesorë institucionalë të BE-së dhe WB6; b) impaktit të tyre dhe zhvillimet në Shqipëri; së bashku me c) intervista gjysmë të strukturuar me aktorët dhe palët e interesuara.

Punimi kërkimor është pasuruar me disa nga mesazhet kryesore të nënvizuara nga folësit gjatë konferencës “Shqipëria në Procesin e Berlinit: Vlerësime dhe Rekomandime - Vjeshtë 2015”, organizuar nga ShtetiWeb në partneritet me Fondacionin Friedrich Ebert, Fondacionin Hanns Seidel dhe Fondacionin Konrad Adenauer. Konferenca u mbajt në Tiranë në 5 nëntor 2015. Ky punim kërkimor fokusohet tek rrënjët historike të procesit, përkufizimi(et), qasja, objektivat, aktorët, mekanizmat dhe mundësitë e financimit. Më pas, ai merret me përshkrimin dhe analizën e kuadrit institucional, ligjor dhe politik në nivel evropian, rajonal dhe kombëtar; trajton vlerësimin e argumentit të ndërlidhjes dhe kontributin e tij në rritjen ekonomike dhe në mirëqënien e rajonit; si dhe plotësohet me një panoramë të iniciativave rajonale ekzistuese që ndikojnë drejtpërdrejt ose pjesërisht në Agjendën e Berlinit. Evidenca në dispozicion është përdorur për të kryer një analizë krahasimore (ku ishte e mundur) në mënyrë që të identifikohen mbivendosjet dhe sinergjitë midis nismave të ndryshme rajonale.

1. Procesi i Berlinit

1.1 Konturet e Procesit të Berlinit

Viti 2014 ishte një moment i veçantë historik për kontinentin evropian. Ai shënoi 100 vjetorin e nisjes së Luftës së Parë Botërore dhe 10 vjetorin e valës më të madhe të zgjerimit të Bashkimit Evropian drejt vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore. Në këtë kontekst dhe me qëllimin e dhënies së një shtyese të re bashkëpunimit rajonal dhe procesit të integritetit evropian të rajonit, Kancelarja gjermane Angela Merkel priti në Berlin, në 28 gusht 2014, një Konferencë të Nivelit të Lartë mbi Ballkanin Perëndimor. Konferenca mundësoi një forum të përbashkët komunikimi për krerët e Ballkanit Perëndimor kundrejt njëri-tjetrit dhe kundrejt shteteve anëtare të BE-së si dhe Komisionit Evropian.

Pavarësisht jehonës në media dhe në opinionin publik të Ballkanit Perëndimor, nuk ka asnjë përkufizim të pranuar gjërësisht apo një shpjegim zyrtar se çfarë është ekzaktësisht “Procesi i Berlinit”. Në terma të përgjithshme, ai ka karakteristikat e një nisme politike shumëpalëshe midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe perceptohet se është nën “patronazhin gjerman”. Kohëzgjatja është nga 2014-2018, edhe pse disa angazhime politike shkojnë përtej afatit kohor të rënë dakord.

Nuk ka asnjë përkufizim të pranuar gjërësisht apo një shpjegim zyrtar se çfarë është ekzaktësisht ‘Procesi i Berlinit’. Në terma të përgjithshme, ai ka karakteristikat e një nisme politike shumëpalëshe midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe perceptohet se është nën “patronazhin gjerman”.

Duke promovuar qëllimin e tij për të gjeneruar përfitime të prekshme për qytetarët e vendeve të WB6, Deklarata Finale e Berlinit (shkurt Deklarata e Berlinit) nuk e përmend fjalën “proces”. Sikurse përmendet në dokumentin final, qëllimi kryesor është të “ofrojë një kuadër për një periudhë prej katër vitesh”.¹ Gjatë kësaj kohe, vendet e Ballkanit Perëndimor pritet të çojnë përpara përpjekjet e tyre reformuese, drejt një demokracie të vërtetë dhe ekonomie tregu funksionale, të përfundojnë procesin e pajtimit dhe të përmirësojnë bashkëpunimin ekonomik rajonal, si bazë për një rritje të qëndrueshme dhe mirëqenie.

Ndonëse është e vështirë për t’u zbuluar se kush e përmendi i pari – krerët e Ballkanit Perëndimor apo media – koncepti i “kornizës” i përmendur në Deklaratën e Berlinit u shndërrua në një “proces” në fazën e post-Berlinit. Në fakt, koncepti i “procesit” u përmend gjatë konferencës për shtyp të 28 gushtit 2014, kur Kancelarja Merkel deklaroi se Konferenca e Berlinit “nuk është një ngjarje e ditës, sot për sot, por do të ketë një vazhdimësi, do të ketë një proces pune”.²

1 Deklarata Finale e Kryetarit të Konferencës për Ballkanin Perëndimor, Berlin, 28 gusht 2014, pika 1.

2 Konferenca e përbashkët për mediat e Kryeministrit Rama, Kancelares Merkel dhe Presidentit të Komisionit Evropian Barroso, Berlin, 24 gusht 2014, konsultoni: <http://www.kryeministria.al/en/newsroom/news/historic-moment-for-the-common-future-of-the-western-balkans>

Që nga zanafilla, vet qeveritë e Ballkanit Perëndimor dëshironin ta konsideronin një “proces”, për të dhënë idenë e vazhdimësisë së iniciativës.³ Megjithatë, ndryshimi terminologjik nuk është pasuar me sqarime të hollësishme rreth këtij procesi, si p.sh. aktorët, mekanizmat, rezultatet e pritshme, monitorimi dhe burimet në dispozicion. Mungesa e informacionit ka ndikuar në spekulime dhe pritshmëri të larta për burime të konsiderueshme financiare shtesë të rezervuara për vendet e WB6.

Strategjia e Zgjerimit e Komisionit Evropian, e tetorit 2014, është dokumenti i parë i identifikuar që iu referua këtij procesi. Ajo thekson se “Procesi i Berlinit” mund të jetë i dobishëm për nxitjen e reformave dhe dakordësim për prioritetet reale të investimeve kryesore të ndërlidhjes. Ai mund të veprojë gjithashtu si një levë në zgjidhjen e çështjeve dypalëshe të mbetura pezull”.⁴

I zyrtarizuar ex-post, Procesi i Berlinit është vlerësuar pozitivisht nga qeveritë e WB6, si dhe nga BE-ja dhe strukturat e saj. Ai ka (ri-)gjeneruar një moment shumë të nevojshëm për komponentin e bashkëpunimit rajonal dhe ka sjellë në vëmendjen e BE-së rolin gjeostrategjik të Ballkanit Perëndimor dhe perspektivën e tij evropiane.

Procesi i Berlinit ka (ri-)gjeneruar një moment shumë të nevojshëm për komponentin e bashkëpunimit rajonal dhe ka sjellë në vëmendjen e BE-së rolin gjeostrategjik të Ballkanit Perëndimor dhe perspektivën e tij evropiane.

Hyrja e Deklaratës Finale të Vjenës (shkurt Deklarata e Vjenës) i referohet “Procesit të Berlinit”, por pa e shtjelluar atë. Ky samit i dytë ishte ideuar një vit më parë – pra, koncepti i vazhdimësisë – si një mundësi për të vlerësuar rezultatet fillestare të Konferencës së Berlinit dhe vazhdimin e punës për çështjet e rëndësisë kyçe për Ballkanin Perëndimor.⁵ Samitet e ardhshme të Parisit dhe të Romës sanksionojnë kështu shndërrimin e kësaj “kornize” në një proces.

Procesi i Berlinit u mbështet plotësisht nga Qeveria shqiptare, e cila ka shprehur angazhimin e saj të palëkundur dhe ka publikuar disa deklarata dhe angazhime politike. Megjithatë, rezultatet praktike dhe efikasiteti i këtij aktiviteti intensiv institucional ka qënë i vështirë për t’u vlerësuar. Qeveria shqiptare duhet të demonstrojë gjatë vitit 2016 kapacitetet e saj në zbatimin e angazhimeve politike të ndërmarra. Gjithashtu, përveç deklaratave të përbashkëta, njoftimeve për shtyp, intervistave dhe disa artikujve në media mbi suksesin e projekteve infrastrukturore, asnjë dokument tjetër mbi Procesin e Berlinit nuk ka qënë i aksesueshëm për publikun.

1.2 Si arritëm tek Procesi i Berlinit?

Organizimi i Konferencës së Berlinit u bë publik në fillim të qershorit 2014, me qëllim konfirmimin e perspektivës evropiane të Ballkanit Perëndimor dhe të prezencës së Gjermanisë në rajon.⁶ Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet ta përdorin këtë moment për të realizuar reforma në vendet

3 Bushati, Ditmir, Fjala e Ministrit të Punëve të Jashtme, *Procesverbal i Takimit të Dytë të Këshillit Kombëtar të Integritetit Evropian*, Tiranë, 21 korrik 2015, fq. 4, konsultoni:

http://www.parlament.al/web/Procesverbal_date_21_07_2015_20825_1.php

4 Komisioni Evropian, *Enlargement Strategy and Main Challenges 2014-2015*, Bruksel, 8.10.2014, COM(2014) 700 final, fq.17.

5 Deklarata Finale e Kryetarit të Konferencës për Ballkanin Perëndimor, Berlin, 28 gusht 2014, pika 2.

6 Die Bundeskanzlerin, “*Klare EU-Perspektive für Balkanstaaten*”, 7 qershor 2014, konsultoni: http://www.bundeskanzlerin.de/Webs/BKin/DE/Mediathek/mediathek_node.html?cat=videos&id=875926

përkatëse. Ky version i “diplomacisë shumëpalëshe”⁷ u konsiderua si “metoda” më e përshtatshme, e menjëhershme dhe e lehtë për të mbuluar boshllëkun e krijuar nga deklarata e Junckerit⁸ mbi pezullimin e procesit të zgjerimit deri në vitin 2019.

Krerët e Ballkanit Perëndimor perceptuan pozitivisht sinjalin e fortë politik të dërguar nga Kancelarja Merkel, duke qënë se Procesi i Berlinit ofron një shans të mirë për të çuar përpara procesin e integritetit, si në nivel rajonal edhe në atë evropian. Gjithsesi, është e rëndësishme të përmendet se ky proces nuk zëvendëson procesin e anëtarësimit në BE. Përkundrazi, ai është konceptuar si një instrument përforcues në shërbim të perspektivës së anëtarësimit në BE dhe të lidhjeve ekonomike dhe politike midis vendeve të Ballkanit Perëndimor. Procesi ka gjeneruar disa deklarata dhe angazhime politike dhe praktike që janë në përputhje dhe/ose plotësojnë procesin e integritetit në BE.

Procesi i Berlinit nuk zëvendëson procesin e anëtarësimit në BE. Ai është konceptuar si një instrument përforcues në shërbim të perspektivës së anëtarësimit në BE dhe të lidhjeve ekonomike dhe politike midis vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Parë në një perspektivë më të gjërë, ka një larmi të madhe faktorësh që kontribuan në dinamikën e kësaj “konference-të-kthyer-në-proces”, gama e të cilëve shkon nga gjeopolitika tek financat. Përballë konfliktit në Ukrainë, rritjes së influencës së Rusisë dhe Turqisë në rajon dhe imazhit negativ të “lodhjes nga zgjerimi”, organizimi i një Konferencë të Nivelit të Lartë në Berlin me qeveritë partnere të Ballkanit Perëndimor ishte një sinjal politik inkurajues për rajonin. Ndërsa pranvera arabe po destabilizonte brigjet jugore të Mesdheut, ishte gjeopolitikisht e drejtë që BE-ja të mbante gjallë dhe të fortë “unazën e saj të miqësisë”⁹ me vendet fqinje të Ballkanit Perëndimor. Është e drejtë të thuhet se themeli i kësaj nisme ishin pikërisht problemet e sigurisë.

Nga ana e BE-së ishin tre çështjet kryesore që kontribuan në Procesin e Berlinit:

- o Vazhdimi i krizës financiare dhe ekonomike të 2008 dhe perceptimi i “përçarjes dhe pafuqisë” së BE-së për ta përballuar. “Konferenca-e-kthyer-në-proces” mund të ishte një mënyrë efikase për të ripaketuar zotimet politike dhe financiare të BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor;
- o Rritja e lëvizjeve populiste dhe partive politike ekstremiste, agjenda evropiane e të cilave bazohet në gjithçka përveç zgjerimit. Për të balancuar mesazhin e tyre kundër zgjerimit, një konferencë do të mund të ofronte të paktën një kornizë ku të ripërsëritej destinacioni i vendeve të Ballkanit Perëndimor drejt BE-së;
- o Perceptimi i fundit i modelit aktual të zgjerimit, sikurse vërehet nga problemet e vazhdueshme të Rumanisë dhe Bullgarisë një herë që u anëtarësuan në BE. Ky faktor shpjegon – midis të tjerave – fokusin e Procesit të Berlinit në projekte infrastrukturore konkrete, lehtësisht të identifikueshme dhe të matshme.

7 “Multilateralizmi mund të përkufizohet si një praktikë e koordinimit të politikave kombëtare në grupe prej tre ose më shumë shtetesh, përmes marrëveshjeve ose përmes institucioneve”, në Keohane, Robert O., “Multilateralism: An Agenda for Research”, International Journal, vol. XLV, 1990, fq. 731-764.

8 Juncker, Jean-Claude, “A New Start for Europe: My Agenda for Jobs, Growth, Fairness and Democratic Change”, Political Guidelines for the next European Commission, Opening Statement in the European Parliament Plenary Session, Strasbourg, 15 korrik 2015, fq. 12, konsultoni: http://ec.europa.eu/priorities/docs/pg_en.pdf

9 Koncepti “unaza e miqve” u konceptua nga Romano Prodi, ish President i Komisionit Evropian, në fjalën e tij “A wider Europe – A proximity policy as the key to stability”, Bruksel, 5-6 dhjetor 2002, konsultoni: http://europa.eu/rapid/press-release_SPEECH-02-619_en.htm

Partnerët e Ballkanit Perëndimor përkrahën Procesin e Berlinit kryesisht për shkak të:

- o Paaftësisë për të avancuar në reformat e pritshme dhe nevoja e politikanëve të Ballkanit Perëndimor për të sjellë në vend diçka të re dhe të një profili të lartë;
- o Vazhdimësisë së normës së ulët të rritjes ekonomike, të papunësisë së lartë dhe mungesës – ose paaftësisë për të prodhuar – një strategji zhvillimi ekonomik realiste dhe gjithëpërfshirëse që i përshtatet kontekstit. Gjithçka që jep përshtypjen se politikanët lokalë janë të angazhuar në përmirësimin e ekonomisë është e dobishme;
- o Rritjes së pabarazisë në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe për rrjedhojë rreziqet reale për instabilitet të brendshëm. Një lidhje më e mirë me zemrën e Evropës pritet që t'i bëjë qytetarët dhe votuesit të ndihen më mirë dhe më shumë evropianë;
- o Magjepsjes lokale ndaj “përsosmërisë gjermane”. Imazhi i “eurokratëve”, në Brukselin abstrakt dhe të vrenjtur, zëvendësohet nga imazhi popullor i figurës dashamirëse të Kancelares Merkel dhe lokomotivës ekonomike të plotfuqishme gjermane.

Është interesante të theksohet se, që nga tërheqja graduale e Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore, për herë të parë vendet e Ballkanit Perëndimor kërkuar një alternativë kundrejt qasjes së zakonshme normative që BE-ja ka mbështetur dhe promovuar që nga Procesi i Stabilizimit dhe Asociimit. Angazhimi politik për intensifikimin e bashkëpunimit rajonal ka qënë shumë i theksuar nga krerët e Ballkanit Perëndimor. Kryeministrat shqiptar dhe serb duket se kanë investuar personalisht për këtë sukses. Çdo takim, çdo hap përpara dhe çdo dokument i nënshkruar është prezantuar në vendet përkatëse si një sukses politik personal.

Në tërësi, kjo nismë shumëpalëshe sjell në vëmendjen e Bashkimit Evropian rëndësinë gjeostrategjike të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Përpjekjet tashmë duhet të synojnë drejt shndërrimit të zotimeve retorike të bashkëpunimit rajonal në angazhime efektive dhe efikase të zbatuara në terren dhe me rezultate të prekshme. Sfida kryesore mbetet vazhdimësia e zotimeve politike dhe efikasiteti i pronësisë rajonale, përkthyer në masa konkrete cilësore, të qëndrueshme dhe me impakt për qytetarët. Vetëm kështu bashkëpunimi rajonal do të mund të shndërrohej në një vlerë më vete, në pronësi të qytetarëve të Ballkanit Perëndimor, në vend që të konsiderohet apo interpretohet si një tjetër parakusht i procesit të integritit evropian.¹⁰

2. Kuadri politik

Kuadri politik zakonisht përkufizohet si një “grup parimesh dhe objektivash afatgjatë që formojnë bazën e hartimit të rregullave dhe udhëzimeve, dhe i japin drejtimin e përgjithshëm planifikimit dhe drejtimit të [një] organizate [specifike]”.¹¹ Ai është një dokument vizionar, i shkruar përgjithësisht për një audiencë të gjerë.

Duke i qëndruar këtij përkufizimi, Procesi i Berlinit ka kornizën e tij të politikave, e cila i ofron aktorëve të përfshirë arsyetimin e nevojshëm dhe filozofinë në përzgjedhjen e projekteve specifike, si dhe udhëheqjen gjatë fazës së zbatimit të projekteve. Megjithatë, nuk është identifikuar një dokument

10 Anastasakis, Othon & Vesna Dojicic-Dzelilovic, “*Balkans Regional Cooperation and European Integration*”, London School of Economics and Political Science, korrik 2002, fq. 56.

11 Përkufizim sipas fjalorit “Business Dictionary”, konsultoni: <http://www.businessdictionary.com/definition/policy-framework.html#ixzz3mk9QgT95>

ekzakt që përshkruan këtë kornizë. Kuadri politik mund të identifikohet vetëm nëpërmjet një analize krahasuese të deklaratave finale të aprovuara gjatë samiteve të përvitshme dhe deklaratave të përbashkëta të ministerialeve të mbajtura gjatë periudhës gusht 2014 - gusht 2015.

Deklarata e Berlinit pohon se ekziston një agjendë e dakordësuar bashkarisht, objektivat e së cilës do të arrihen nëpërmjet mbështetjes dhe zbatimit të projekteve rajonale specifike.¹² Gjithashtu, ekzistojnë dy çështje transversale që përforcojnë njëra-tjetrën, përta i përket: a) perspektivës evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor; dhe b) forcimit të shtetit të së drejtës dhe qeverisjes së mirë në rrugën drejt anëtarësimit në BE.

2.1. Tre dimensionet tematike

Fushat tematike të Agjendës së Berlinit mund të paraqiten në një strukturë tre dimensionale:

1. *Dimensioni diplomatik*: synon zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dypalëshe midis vendeve të WB6, në funksion të forcimit të marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë dhe stabilitetit rajonal. Në këtë drejtim, gjatë Samitit të Vjenës, ministrat e punëve të jashtme të WB6 nënshkruan një deklaratë të përbashkët ku vendet angazhohen të zgjidhin në mënyrë paqësore të gjitha çështjet dypalëshe dhe të evitojnë procesin e bllokimit të avancimit të fqinjëve në rrugën drejt BE-së.¹³
2. *Dimensioni ekonomik*: fokusohet në zhvillimin e projekteve të përbashkëta infrastrukturore dhe rritjes së qëndrueshme në rajon. Aktualisht, asnjë nga vendet e WB6 nuk konsiderohet si ekonomi tregu funksionale.¹⁴ Zgjatja e krizës ekonomike - ilustruar nga norma e lartë e papunësisë dhe nga pengesat e ndryshme strukturore ndaj rritjes ekonomike - nënvizon nevojën e vendeve të WB6 për gjetjen e mënyrave alternative në lidhje me rritjen ekonomike të ngadaltë dhe konkurrencën globale.
3. *Dimensioni social*: nënvizon rëndësinë e shoqërisë civile dhe marrëdhënieve mes popujve. Konferenca e Berlinit përfshiu shoqërinë civile në listën e partnerëve strategjik të bashkëpunimit rajonal. Vendet e Ballkanit Perëndimor nënshkruan një deklaratë të përbashkët për themelimin e Zyrës së Bashkëpunimit Rinor Rajonal të Ballkanit Perëndimor. Madje, Konferenca e Berlinit i rezervoi një vëmendje të veçantë rritjes së aftësisë akademik dhe profesional, si një mjet për të trajtuar papunësinë e të rinjve dhe për të rritur në nivel vendor numrin dhe nivelin e kualifikimit të forcës punëtore. Duke patur parasysh rëndësinë e dimensionit human, në korrik 2015 u mbajt në Berlin/Halle Konferenca e I^{te} e Përbashkët Shkencore e Ballkanit Perëndimor, me qëllim zvogëlimin e fenomenit të "ikjes së trurit" dhe forcimin e dialogut shkencë-politikë-shoqëri në kuadrin e politikëbërjes.

Deklarata e Vjenës thekson se pjesëmarrësit "ranë dakord [...] të zbatojnë agjendën e dakordësuar në Berlin, [...] zgjeruar në Vjenë, dhe të çojnë përpara projekte të ndryshme të identifikuar gjatë vitit".¹⁵ Kjo frazë e paqartë lë hapur mundësinë për të prezantuar çështje të reja politike në kornizën

12 Deklarata Finale e Kryetarit të Konferencës për Ballkanin Perëndimor, Berlin, 28 gusht 2014, pika 2.

13 Samiti i Vjenës për Ballkanin Perëndimor 2015, Adendum, Aneksi 3, Bashkëpunimi rajonal dhe zgjidhja e çështjeve dypalëshe, 27 gusht 2015.

14 Komisioni Evropian, Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, *EU Enlargement Strategy*, COM(2015) 611 final, Bruksel, 10.11.2015, fq. 8.

15 Deklarata Finale e Kryetarit të Konferencës për Ballkanin Perëndimor, Berlin, 28 gusht 2014, pika 1.

e Agjendës së Berlinit. Vet Samiti i Vjenës prezantoi në Agjendën e Berlinit çështjen e “luftëtarëve të huaj” dhe “flukseve të migrimit” – duke ngritur kështu shqetësimin për shkallën në të cilën këto çështje të aktualitetit, të cilat dominojnë agjendën e BE-së dhe WB6, mund të dobësojnë procesin e planifikuar.

Analiza e pesë deklaratave të përbashkëta (listuar në tabelën 2) tregon se fokusi primar i ministerialeve ka qënë qeverisja ekonomike dhe ndërlidhja – në sektorët e transportit dhe energjisë. Në këtë kontekst, të gjithë vendet kanë rënë dakord që:

- Të vazhdojë zbatimin e strategjisë ekzistuese SEE 2020;
- Të sigurohet komplementariteti me SEECP;
- Të identifikohet projektet kryesore të ndërlidhjes; dhe,
- Të adresohen pa vonesa të gjitha masat përkatëse që mund të sjellin përfitime të menjëherëshme në ndërlidhjen e vendeve të WB6, me kosto të arsyeshme.

2.2. Fokusi mbi projekte konkrete dhe të matshme

Shfaqja e nismave ekzistuese që mbulojnë sektorë të njëjtë apo të ngjashëm të bashkëpunimit ngre çështjen e risisë dhe individualitetit të Procesit të Berlinit. Për të vlerësuar nëse Agjenda e Berlinit ofron një kuadër politik të ri dhe vizionar, apo një “ripaketim” të thjeshtë të strategjive të zbatuara tashmë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, janë marrë në analizë katër dokumenta politikë të tre viteve të fundit (siç shihet në tabelën 1).

Tabela 1: Panorama e fushave politike të përfshira në çdo dokument politik, 2013 - 2015

Fushat	...sipas Strategjisë SEE 2020 (2013)	... sipas Strategjisë së Zgjerimit 2013	... sipas Deklaratës së Berlinit 2014	... sipas Deklaratës së Vjenës 2015
Integrimi në BE	Perspektiva evropiane	Integrimi në BE	Rruga drejt të ardhmes në Evropë	Perspektiva evropiane
Bashkëpunimi Rajonal	Bashkëpunimi rajonal	Bashkëpunimi rajonal Ballafaqimi me çështjet dypalëshe dhe tejkalimi i trashëgimisë së të shkuarës	Thellimi i bashkëpunimit rajonal si bazë thelbësore	Bashkëpunimi rajonal dhe zgjidhja e çështjeve dypalëshe
Qeverisja e Mirë	Qeverisja e mirë Lufta kundër krimit të organizuar	Shteti i së drejtës Funksionimi i institucioneve që garantojnë demokracinë	Forcimi i qeverisjes së mirë	Shteti i së drejtës dhe qeverisja e mirë
Rritja Ekonomike e Qëndrueshme	Tregëtia dhe investimet Rritja e punësimit	Qeverisja ekonomike dhe konkurrenca (Masa të tjera që nxisin konkurrencën, investimet, rritjen dhe vendet e punës)	Rritja e mirëqënies nëpërmjet rritjes ekonomike të qëndrueshme	Integrimi i tregjeve - lehtësimi i tregëtisë, mobiliteti dhe nismat e përbashkëta të rritjes
	Infrastruktura dhe mjedisi			Mirëqënia ekonomike dhe konektiviteti

Lufta kundër Ekstremizmit dhe Radikalizimit	-	-	-	Lufta kundër Ekstremizmit dhe Radikalizimit
Migrimi	Menaxhimi i migrimit dhe azilit	Shteti i së drejtës	-	Migrimi
Rinia, Arsimi, Shkenca dhe Kërkimi	Arsimi dhe inovacioni	Qeverisja ekonomike dhe konkurrenca	Intensifikimi i bashkëpunimit rajonal si bazë themelore	Rinia, Arsimi, Shkenca dhe Kërkimi
Shoqëria Civile	Shoqëria Civile	Të drejtat themelore		Shoqëria Civile

Burimi: Strategjia SEE 2020 (2013)¹⁶; Strategjia e Zgjerimit (2013)¹⁷; Deklarata Finale e Berlinit (2014); Deklarata Finale e Vjenës (2015), të përpunuara nga autorët.

Analiza përfshinë Strategjinë SEE 2020 dhe Strategjinë e Zgjerimit 2013 të Komisionit Evropian për arsye të rëndësishme të tyre strategjike dhe referencës që i bëjnë këtyre dokumentave aktorët kryesorë të Procesit të Berlinit.

Strategjia SEE 2020 është aktualisht në zbatim nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal¹⁸ dhe pritet të përafrojë prioritetet kombëtare të Ballkanit Perëndimor në pozicione të përbashkëta në fushat e rritjes ekonomike, investimeve, punësimit, etj. Strategjia e Zgjerimit 2013 përbën dokumentin strategjik dhe qasjen e BE-së për zhvillimin e Ballkanit Perëndimor. Kjo strategji ishte ende në fuqi kur u mbajt Konferenca e Berlinit.

Siç mund të vërehet, rritja ekonomike e qëndrueshme - së bashku me perspektivën evropiane, bashkëpunimin rajonal, qeverisjen e mirë dhe përfshirjen e shoqërisë civile - përbëjnë prioritetet kyçe të të gjitha dokumentave të marra në analizë. Të gjitha këto fusha – përveç luftës kundër ekstremizmit dhe radikalizmit - përsërisin kryesisht përmbajtjen e shtyllave të Strategjisë SEE 2020 dhe të Strategjisë së Zgjerimit 2013. Për këtë arsye, mund të pohohet se prioritetet e Agjendës së Berlinit duket se janë deri në një farë mase, një “ripaketim” i qasjes normative të BE-së ndaj anëtarësimit (Strategjia e Zgjerimit të BE-së 2013) dhe i strategjisë rajonale të konkurrueshmërisë dhe rritjes (SEE 2020), në vend të një qasjeje të re dhe të përshtatur ndaj vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Megjithatë, për momentin avantazhi i Procesit të Berlinit konsiston në faktin se ai është mjaft i “kufizuar dhe i fokusuar”, duke mundësuar kështu ecjen përpara të Ballkanit Perëndimor dhe afrimit të tij me BE-në.¹⁹ Rëndësia që i është dhënë projekteve konkrete, shoqëruar me përfitime konkrete dhe të matshme, pritet të shtyjë përpara procesin e reformave dhe të agjendës së investimeve në vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu, Procesi i Berlinit pritet të krijojë një klimë pozitive bashkëpunimi dhe konkurrencë të shëndoshë midis këtyre vendeve. Në thelb, hipotetizohet që nëpërmjet bashkëpunimit rajonal në projekte praktike dhe investime të përbashkëta, vendet e

16 Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, *South East Europe 2020: Jobs and Prosperity in a European Perspective*, nëntor 2013, konsultoni: <http://rcc.int/files/user/docs/reports/SEE2020-Strategy.pdf>

17 Komisioni Evropian, *Communication from the Commission to the European Parliament and the Council, Enlargement Strategy and Main Challenges 2013-2014*, COM(2013) 700 final, Bruksel, 16.10.2013.

18 Për më shumë informacion rreth rolit të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal në Procesin e Berlinit konsultoni seksionin 3.1.

19 Johan Sattler cituar tek Manu, Doris, *“EU Enlargement to the Balkans: The Berlin Process is moving Things Forward”*, European Western Balkans, Bruksel, 23 nëntor 2015 konsultoni: <http://europeanwesternbalkans.com/2015/11/23/eu-enlargement-to-the-balkans-the-berlin-process-is-moving-things-forward/>

Ballkanit Perëndimor do të arrijnë përfitime të prekshme të përbashkëta dhe progres të shpejtë drejt integritimit të tyre në BE.

3. Tiparet e kuadrit institucional

3.1 Përcaktimi i agjendës, përbërja dhe aktorët

Procesi i Berlinit parashikon një format të ri takimesh, me qëllim ofrimin e një bashkëpunimi më të mirë në nivel rajonal. Ndonëse nuk përmendet në asnjë dokument zyrtar, procesi udhëhiqet nga ministerialet drejt samitit të përvitshëm.

Pavarsisht se i bëhet shpesh referencë Agjendës së Berlinit, në aspektin praktik nuk ka një kalendar të paracaktuar të ministerialeve dhe të tematikave përkatëse për diskutim. Nuk ka asnjë rregull as se ku do të mbahen samitet e ardhshme. Me sa kuptojmë, është në dorën e qeverive të shfaqin vullnetin e tyre në këtë drejtim. Në Konferencën e Berlinit në 2014, Kancelari Federal i Austrisë u ofrua për të pritur samitin e 2015, i cili do të ndiqet përkatësisht nga Franca dhe Italia, në 2016 dhe 2017.

Konferenca e Berlinit u ndoq nga shtatë ministeriale dhe pesë deklaratë të përbashkëta, të cilat përcaktuan fushat politike të bashkëpunimit midis vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ato rezultuan në propozime konkrete, të cilat çuan në Samitin e Vjenës të gushtit 2015. Tabela 2 paraqet një panoramë të përgjithshme të ministerialeve të mbajtura sipas rendit kronologjik.

Tabela 2: Lista e samiteve dhe ministerialeve 2014-2015

Data	Vendi	Niveli i Takimit	Lloji i Takimit	Dokumenti Final
28/08/2014	Berlin	Konferenca e Berlinit	Konferenca nismëtare	Deklaratë Finale
24/09/2014	Budva	Ministrat e Ekonomisë të Ballkanit Perëndimor	Konferenca: "Ekonomia – Baza për Ballkanin Perëndimor"	-
23/10/2014	Beograd	Ministrat e Ekonomisë & Ministrat e Punëve të Jashtme të Ballkanit Perëndimor	Konferenca: "Qeverisja Ekonomike dhe Konektiviteti"	Deklaratë e Përbashkët
25/03/2015	Prishtinë	Ministrat e Transportit & Ministrat e Punëve të Jashtme të Ballkanit Perëndimor	Ministerial: "Përmirësimi i Ndërlidhjes dhe një Rrjet Kryesor i Fortë"	Deklaratë e Përbashkët
21/04/2015	Bruksel	Takimi i Kryeministrave të Ballkanit Perëndimor	Samit i Krerëve të WB6: "Ngritja e Rrjeteve, Lidhja e Qytetarëve"	Deklaratë e Përbashkët
23/04/2015	Brdo	Ministrat e Punëve të Jashtme të Ballkanit Perëndimor ¹	Ministerial: "Agjenda Pozitive për Rininë në Ballkanin Perëndimor"	Deklaratë e Përbashkët
22/06/2015	Riga	Ministrat e Transportit të Ballkanit Perëndimor	Takim tek Forumi TEN-T	-
02/07/2015	Vjenë	Ministrat e Energjisë të Ballkanit Perëndimor	Ministerial: "Lidhja e Sistemeve, Lidhja e Tregjeve"	Deklaratë e Përbashkët
27/08/2015	Vjenë	Samiti i Vjenës	Samit i Përvitshëm	Deklaratë Finale

Burimi: Përpunim i autorëve, bazuar në të dhëna nga burime zyrtare online të institucioneve pjesëmarrëse.

Në samitete përvitshëm marrin pjesë krerët e qeverive të Ballkanit Perëndimor, përfaqësues nga Komisioni Evropian, ngavendet anëtare të BE-së (Gjermania, Austria, Franca, Italia, Sllovenia dhe Kroacia), nga Institucionet Ndërkombëtare Financiare, nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal dhe nga Sekretariate të CEFTA-s, SEETO-s dhe Komunitetit të Energjisë.

Përsa i përket **tipologjisë së aktorëve** të përfshirë në këtë proces, nuk ka rregulla specifike se kush do të jetë prezent ku. Në formatin e samiteve (në Berlin dhe Vjenë) të gjitha shtetet (përveç Francës dhe Italisë) janë përfaqësuar nga kryeministrat përkatës, ministrat e punëve të jashtme dhe ministrat e ekonomisë/financës.²⁰

Në Berlin në 2014, **Komisioni Evropian** u përfaqësua nga Presidenti Jose Manuel Barroso, ndërsa në Vjenë përfaqësimi iu delegua Përfaqësueses së Lartë për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë dhe Zëvendës Presidentes së Komisionit, Federica Mogherini. Ky ndryshim ndodhi për shkak të riorganizimit të Komisionit Evropian në nëntor 2014, që çoi në rritjen e kompetencave të Përfaqësueses së Lartë.

Është interesante të përmendet që në Samitin e Vjenës, **Franca** u përfaqësua nga Sekretari i Shtetit për Çështjet Evropiane, i shoqëruar nga një i dërguar i posaçëm i Ministrit të Punëve të Jashtme. Duke patur parasysh që Franca do të mirëpresë Samitin në Parisit në 2016, dhe duke patur parasysh prezencën e Kancelarit të Austrisë në Berlin një vit më parë, pritej një prezencë më e lartë e Qeverisë së Francës. **Italia** iu bashkua Procesit të Berlinit vetëm në 2015 dhe në Vjenë ajo u përfaqësua nga Ministri i Punëve të Jashtme.

Institucionet Ndërkombëtare Financiare prezente në samitet e përvitshëm kanë qënë Banka e Zhvillimit të Këshillit të Evropës; Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim; Banka Evropiane e Investimeve; Grupi i Bankës Botrore; dhe Banka Gjermane për Zhvillim – KfW.

Ndërkohë, nismat rajonale ekzistuese që mbulojnë fushat e tregëtisë, transportit dhe energjisë, si **Sekretariatet e CEFTA-s, SEETO-s dhe Komunitetit të Energjisë**, iu besua një kontribut më i madh në Samitin e Vjenës. Deklarata e Vjenës i cakton role specifike në fushat përkatëse secilit prej këtyre sekretariateve.

Ministerialet janë ndjekur nga ministrat e vendeve të Ballkanit Perëndimor, në bazë të fushave tematike në diskutim. Nga ana e BE-së, këto takime janë ndjekur nga Komisioneri Hahn, dhe në bazë të tematikës, nga Zëvendës Presidenti i Komisionit Evropian për çështjet ekonomike, monetare dhe euron, Komisioneri për transportin, Komisioneri për energjinë dhe klimën, dhe/ose nga Presidenca e rradhës e Këshillit të Ministrave të BE-së, etj.

Struktura e **Këshillit për Bashkëpunimit Rajonal** ka qënë prezente në të gjitha ministerialet dhe samitet e përvitshme. Përfshirja e tij u parashikua nga Deklarata e Berlinit, e cila theksoi qartë rolin e RCC-së në forcimin e bashkëpunimit rajonal midis vendeve të WB6. Më pas, kjo u reflektua edhe në deklaratën e përbashkët të Ministerialit të Beogradit, që nënvizoi rëndësinë e zbatimit të strategjisë SEE 2020 në kontekstin e programeve kombëtare të reformave ekonomike.

Në tërësi, Deklarata e Vjenës forcoi rolin dhe influencën e RCC-së, duke i caktuar detyra specifike

²⁰ Aneksi 1 paraqet një panorama gjithëpërfshirëse të pozicioneve dhe ministrave që kanë marrë pjesë në Konferencën e Berlinit në 2014 dhe Samitin e Vjenës së 2015.

në fushën e mobilitetit, rritjes ekonomike dhe arsimit profesional të dyfishtë. Roli i RCC-së u konsiderua i dobishëm për ofrimin e një platforme koordinimi për bashkëpunimin rajonal dhe të një bashkëbiseduesi, i cili mund të kontribuojë gjithashtu në mënjanimin e mbivendosjeve të mundshme dhe forcimin e sinergjive midis vendeve të Ballkanit Perëndimor.

3.2 Aktor i ri në bllok: Shoqëria civile

Deklarata e Berlinit theksoi rolin e shoqërisë civile aktive dhe të mbështetjes së saj konstruktive në nxitjen e mëtejshme të demokracisë në Ballkanin Perëndimor. Në Vjenë, përfaqësuesit e shoqërisë civile u mblodhën për të diskutuar rreth kontributit të tyre. Gjashtë prej tyre paraqitën konkluzionet e OSHC-ve dhe debatuan me Kryeministrat e Shqipërisë dhe Serbisë, ministrat nga Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina, si dhe me Komisionerin Evropian për politikën e zgjerimit.

Nga qasjet e vjetra të integritit dhe bashkëpunimit rajonal, tashmë perceptohet kalimi dhe gatishmëria e BE-së dhe Ballkanit Perëndimor e të konsideruarit të shoqërisë civile si një aktor strategjik, i cili duhet konsultuar që në fillim të procesit politikëbërës dhe përcaktimit të agjendës.

Në aspektin e gjerë, përfshirja e dimensionit të shoqërisë civile në përpjekje të tilla është në linjë me politikën e BE-së mbi promovimin e gjithëpërfshirjes dhe konsultimit të drejtpërdrejtë me shoqërinë civile gjatë procesit politikëbërës. Gjithsesi, këtë herë aktivistët e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e medias, të mbështetur nga Fondacionet Friedrich Ebert dhe ERSTE, shfrytëzuan mundësinë për t'u përfshirë më tej dhe për të institucionalizuar rolin e tyre në këtë proces. Për herë të parë në samite të tilla të nivelit të lartë, ata u ftuan zyrtarisht të shprehnin mendimin e tyre mbi proceset e integritit në BE dhe të bashkëpunimit rajonal, si dhe arritën t'ia dilnin mbanë në përmendjen e pikëpamjeve të tyre në deklaratën finale.²¹ Nga qasjet e vjetra të integritit dhe bashkëpunimit rajonal, tashmë perceptohet kalimi dhe gatishmëria e BE-së dhe Ballkanit Perëndimor të konsideruarit të shoqërisë civile si një aktor strategjik, i cili duhet konsultuar që në fillim të procesit politikëbërës dhe përcaktimit të agjendës.

Në këtë frymë, gjatë fillimit të 2015 u organizuan tre takime rajonale paraprake të shoqërisë civile të WB6, që adresuan këto tematika: (i) krijimi i vendeve të punës dhe mirëqënies, udhëhequr nga FES; (ii) ndërtimi i një kulture bashkëpunimi rajonal, udhëhequr nga Fondacioni ERSTE; dhe (iii) liria e shprehjes, udhëhequr nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative. Përpara Samitit të Vjenës, përfaqësuesit e shoqërisë civile përgatitën një seri rekomandimesh mbi tematikat e sipërpërmendura, duke demonstruar aftësinë e OSHC-ve të rajonit për të folur me një zë të vetëm. Për herë të parë, shoqëria civile u angazhua në një dialog me krerët politikë të BE-së, por jo vetëm, dhe i kërkuan qeverive të Ballkanit Perëndimor ta pranojnë shoqërinë civile si një partner të barabartë në procesin e integritit në BE.

²¹ Deklarata Finale e Kryetarit të Konferencës për Ballkanin Perëndimor, Berlin, 28 gusht 2014, pika 8.

4. Dimensioni ekonomik

Procesi i Berlinit thekson nevojën për të forcuar qeverisjen ekonomike në vendet e Ballkanit Perëndimor, në linjë me qasjen e re të Komisionit Evropian.²² Gjithashtu, ai nënvizon nevojën e vendeve të Ballkanit Perëndimor për tregje të hapura dhe rritje të investimet të huaja direkte, ulje të deficiteve të llogarive rrjedhëse, forcim të sigurisë juridike dhe mundësim të një klime pozitive për investimet. Në Samitin e Vjenës, krerët e Ballkanit Perëndimor ranë dakord për t'i dhënë fund, përpara mesit të 2016, negociatave aktuale në CEFTA mbi Marrëveshjen për Lehtësimin e Tregëtisë dhe për të nxitur më tej zhvillimin e zinxhirit rajonal të vlerave. Ata theksuan gjithashtu nevojën dhe njohën rëndësinë e përfshirjes së partnerëve socialë në procesin e reformës ekonomike.

Në këtë kuadër, nën mbështetjen teknike të Komisionit Evropian, vendet e Ballkanit Perëndimor ranë dakord të përgatisin çdo vit Programet Kombëtare të Reformave Ekonomike (NERP),²³ duke përfshirë si *programin makroekonomik dhe fiskal* dhe *programin e reformave strukturore dhe konkurrencës*.²⁴ Në janar 2015, qeveritë e Ballkanit Perëndimori dorëzuan Komisionit Evropian NERP-et e para, të cilat përfshinë afate kohore të qarta dhe implikime buxhetore të detajuara.

4.1 Agjenda e konektivitetit

Projektet e ndërlidhjes lidhen ngushtë me qeverisjen ekonomike dhe me Programet Kombëtare të Reformave Ekonomike të përgatitura nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Zbatimi i NERP-it konsiderohet si një faktor kyç për nxitjen e rritjes ekonomike dhe punësimit. Përcaktimi i një “agjende konektiviteti” ka për qëllim rritjen e bashkëpunimin rajonal, duke ofruar perspektiva të reja për një rritje ekonomike dhe punësim të qëndrueshëm, dhe mundësim të efekteve pozitive zinxhir (spill-over) në rajon. Agjenda përfshin procedurat e identifikimit, hartimit, aprovimit, zbatimit dhe qëndrueshmërisë për projektet infrastrukturore dhe investimet komplekse në transport dhe energji, të cilat do të lidhin vendet e Ballkanit Perëndimor me Rrjetin Trans-Evropian të Transportit.

Procesi i identifikimit dhe përzgjedhjes së projekteve kryesore të ndërlidhjes ka ndodhur gjatë ministerialeve. Për shembull, në prill 2015 kryeministrat e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor ranë dakord mbi Rrjetin Kryesor të Transportit,²⁵ ndërsa në qershor 2015, gjatë Forumit të Rigës, u vendos mbi zgjatimin e tre korridoreve kryesore të Rrjetit Trans-Evropian të Transportit në Ballkanin Perëndimor.²⁶

22 Komisioni Evropian, *Enlargement Strategy and Main Challenges 2013-2014*, op.cit.

23 Deklaratë e Përbashkët, “Western Balkan 6 Ministerial – Economic Governance and Connectivity”, Beograd, 23 tetor 2014, pika 5.

24 Komisioni Evropian, *Enlargement Strategy and Main Challenges 2013-2014*, op.cit., fq. 4.

25 Komisioni Evropian, *Western Balkans 6 Meeting in Brussels*, Brussels, Statement, Bruksel, 21 prill 2015, konsultoni: http://europa.eu/rapid/press-release_STATEMENT-15-4826_en.htm

26 Komisioni Evropian, Commission Staff Working Document, *Albania 2015 Report*, SWD(2015) 213 final, Brussels, 10.11.2015, fq. 22.

Gjatë Samitit të Vjenës, qeveritë e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor prezantuan një agjendë konektiviteti ambicioze, me 50 projekte në kërkim të bashkëfinancimit:²⁷

- 11 projekte të ndërtimit të rrugëve;
- 8 projekte të ndërtimit të hekurudhave;
- 20 projekte rinovimi të rrugëve dhe hekurudhave;
- 6 projekte energjetike; dhe,
- 5 projekte strategjike të gazit.

Megjithatë, numri i projekteve të maturuara në listën e projekteve prioritare strategjike u reduktua në 10: katër projekte energjetike dhe gjashtë projekte infrastrukture. Prioritizimi i këtij numri të kufizuar të projekt-investimeve siguron fokusimin e përpjekjeve dhe mundësi më të mëdha zbatimi.²⁸

Kosto totale e projekteve të ndërlidhjes të aprovuar është 616.5 milion euro, nga të cilat 205.7 milion euro do të jepen në formën e granteve nga Instrumenti i Para-Anëtarësimit (IPA II) i Bashkimit Evropian. Projektet e ndërlidhjes do të financohen nga donatorë ndërkombëtarë sipas procedurave të financimit të WBIF. Grantet do të ndahen kryesisht për asistencë teknike në përgatitjen e investimeve infrastrukturore, ndërsa kreditë do të kontraktohen për investimet infrastrukturore.²⁹

Në periudhën afatshkurtër, vendet e Ballkanit Perëndimor pritet gjithashtu të angazhohen në zbatimin e plotë të listës prioritare të “masave të buta”, të hartuara nga Observatori i Transportit për Evropën Juglindore dhe Komuniteti i Energjisë, përkatësisht në sektorët e transportit dhe të energjisë. Zbatimi i këtyre “masave të buta” pritet të hapi tregjet, eliminojë barrierat tregtare dhe të gjenerojë një mjedis rregullator transparent.³⁰ Ndërsa në periudhën afatmesme, do të zbatohet një seri projektesh prioritare të identifikuar përgjatë seksioneve të veçanta të korridorëve kryesorë.³¹

Procesi i Berlinit ende mbetet kryesisht politik. Thirrjet për ndërlidhje më të mirë midis WB6 duhet të të pasohen me të dhëna të sakta rreth arritjeve të deritanishme dhe cilat janë kostot për buxhetet kombëtare. Ambiciet politike janë të larta dhe të kushtueshme, dhe pasqyrojnë projekte ndërlidhëse komplekse në transport dhe energji.

Megjithatë, për momentin Procesi i Berlinit ende mbetet kryesisht politik. Thirrjet për ndërlidhje më të mirë dhe investime më të mëdha midis vendeve të Ballkanit Perëndimor duhet të pasohen me të dhëna të sakta rreth arritjeve të deritanishme, si dhe me kostot specifike për buxhetet kombëtare. Duke pasqyruar projekte ndërlidhëse komplekse në transport dhe energji, ambiciet politike të WB6 mbeten të larta dhe të kushtueshme. Projektet ndërlidhëse kërkojnë kompetenca të specializuara dhe koordinim kombëtar të përsosur gjatë fazës përgatitore, derisa të arrijnë krijimin e Listës së Vetme të Projekteve Prioritare Strategjike. Këto projekte mbulojnë një periudhë kohore afatgjatë dhe - përtej ndikimit të tyre të rëndësishëm mbi komponentët e tjerë të strategjive të zhvillimit socio-ekonomik në rajon - nevojitet një koordinim shumë i mirë gjatë zbatimit dhe një përgjegjshmëri e lartë ndërkufitare.

27 Holzner, Mario, Robert Stehrer & Hermine Vidovic, “Infrastructure Investment in the Western Balkans”, Vjenë Institute for International Economic Studies (WIIW), Research Report, nr. 407, shtator 2015, fq. 22-26.

28 Ibid., fq. 33.

29 Për më shumë informacion mbi procedurat e financimit të WBIF konsultoni faqen web: <https://www.wbif.eu/About%20WBIF>

30 Komisioni Evropian, *EU Enlargement Strategy 2015*, op.cit., fq. 9.

31 Ibid., fq. 10.

4.2 “Projektet e Berlinit” në Shqipëri

Projektet ndërlidhëse janë kryesisht investime infrastrukturore në shkallë të gjerë, të identifikuar nga Observatori i Transportit për Evropën Juglindore nën Projektet e Rrjetit Gjithëpërfshirës³² dhe/ose janë pjesë e listës PIKE³³, hartuar nga Komuniteti i Energjisë. Këto projekte ose kanë marrë financim në formën e grantit, ose janë identifikuar si përfitues të granteve të BE-së, në mënyrë që të plotësojnë kredinë e financuar nën Kornizën e Investimeve për Ballkanin Perëndimor.

Ndonëse nuk ka prova faktike, duket llogjik konkluzioni se këto projekte konektiviteti janë favorizuar nga Procesi i Berlinit për shkak se përdorin kornizën ekzistuese ligjore, institucionale dhe financiare rajonale. Për më tepër, duhet theksuar se këto projekte janë pjesë e dy kapitujve specifik të *acquis communautaire*, përkatësisht kapitullit 21 mbi rrjetet trans-evropiane dhe kapitullit 5 mbi energjinë.

Projektet e konektivitetit duket se janë favorizuar nga Procesi i Berlinit për shkak se përdorin kornizën ekzistuese ligjore, institucionale dhe financiare rajonale.

Në një kontekst më të gjerë, WBIF mbledh burimet dhe ekspertizën e palëve të interesuara për të financuar projekte dhe për të forcuar koordinimin midis donatorëve dhe përfituesve në vendet e Ballkanit Perëndimor.³⁴ Korniza është funksionale që prej gjashtë vitesh dhe ka mbështetur me sukses vendet përfituese të Ballkanit Perëndimor në përgatitjen e projekteve infrastrukturore të maturuara, zbatimi i të cilave është financiar kryesisht nëpërmjet kredive të Institucioneve Ndërkombëtare Financiare dhe/ose me financim të BE-së. Në këtë drejtim, mund të pohohet se Procesi i Berlinit thekson dimensionin rajonal të këtyre projekteve të ndërlidhjes. Fillimisht, WBIF përzgjidhte projektet për financim “mbi bazën e nevojave rajonale dhe/ose të vendit, si dhe konsistencën e tyre me prioritetet e anëtarësimit në BE”.³⁵ Një shembull i kësaj qasjeje ka qënë përmirësimi i infrastrukturës rurale. Në kuadër të Procesit të Berlinit, në thirrjet e fundit për projekte është nënvizuar “dimensioni rajonal” i projekteve infrastrukturore në energji dhe transport, si parakusht për t’i vendosur ato në kornizën evropiane.

Konkretisht thirrja e fundit për propozime specifikon në mënyrë të qartë:

- Në sektorin e energjisë: “Projekte investimesh, që shfaqen në listen e Projekteve me Interes për Komunitetin e Energjisë (PIKE), miratuar nga Këshilli i Ministror i Traktatit të Komunitetit të Energjisë në tetor 2013, do të përfitojnë vëmendje të veçantë”³⁶;
- Në sektorin e transportit përmendet qartë dimensionin rajonal: “Projektet e WBIF, veçanërisht ato rajonale, duhet të jenë pjesë e Rrjetit Gjithëpërfshirës të SEETO-s dhe / ose të përfshira në politikat e Komisionit Evropian dhe në Memorandumin e Mirëkuptimit të SEETO-s”³⁷.

32 Për më shumë informacion rreth Projektet Gjithëpërfshirëse të Rrjetit SEETO konsultoni faqen web: <http://www.seetoint.org/projects/seeto-comprehensive-network-projects/>

33 Komuniteti i Energjisë, “Development and application of methodology to identify Projects of Energy Community Interest”, Final Report, Vjenë, 26 shtator 2013, konsultoni: https://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/DOCS/2558181/0633975AD4927B9CE053C92FA8C06338

34 Për më shumë informacion mbi procedurat e financimit të WBIF konsultoni faqen web: <https://www.wbif.eu/About%20WBIF>

35 Western Balkans Investment Framework, “A new approach to financial support”, 12 nëntor 2010, fq. 2, konsultoni: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/western-balkans-conference/wbif-a4-def_en.pdf

36 Western Balkans Investment Framework, “Practical Guidelines for WBIF Project Application and Submission”, janar 2014, fq. 8.

37 Ibid., fq. 9.

Në Vjenë, Shqipërisë iu aprovua për bashkë-financim vetëm një projekt, linja e interkonjeksionit 400 kV Elbasan – Manastir. Ky përbën projektin energjetik më të rëndësishëm dhe kosto e parashikuar është 129 milion euro.³⁸ Investimi në territorin shqiptar i linjës së transmetimit kushton 70 milion euro; 80% e vlerës është në formë kredie dhe do të mbulohet nga Banka Gjermane për Zhvillim – KfW, ndërsa pjesa tjetër prej 20% do të mbulohet në formë granti nga IPA II.³⁹ Ky investim i përbashkët është pjesë e nismës së Komisionit Evropian për të ndërtuar një korridor energjetik transmetimi lindje-perëndim, midis Bullgarisë, Maqedonisë, Shqipërisë, Malit të Zi dhe Italisë.⁴⁰

Dy projektet shqiptare të përmendura në Samitin e Vjenës si “hyrje të reja”, dhe të pranueshme për mbështetje të WBIF, janë:

- “Interkonjeksioni 400 kV OHTL Fier-Elbasan-Manastir (pjesa shqiptare)” bashkë-financim i investimit; dhe,
- “Studimi i fizibilitetit të autostradës Adriatiko-Joniane (Itinerari 1 dhe Itinerari 2)” si grant për asistencë teknike.

Studimi i fizibilitetit të autostradës Adriatiko-Joniane u miratua nga Komisioni Drejtues i WBIF gjatë takimit të Parisit në 16 dhjetor 2015.

Në tërësi, për të financuar dhe zbatuar Agjendën e Berlinit, Qeveria e Shqipërisë është duke përdorur mekanizmat e ngritur tashmë nga WBIF. Megjithatë, duhet përmendur se ndryshimi kryesor qëndron në shikueshmërinë e lartë që këto projekte po marrin tani. Ndërsa WBIF nuk ishte aspak i njohur për publikun në përgjithësi, projektet e Procesit të Berlinit kanë hasur një mbulim të gjerë mediatik.

4.3 Institucionet dhe mekanizmat kombëtare

Bazuar në udhëzimin e Komisionit Evropian, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë ngritur Komitetet Kombëtare për Investimet, të cilët janë përgjegjës për miratimin e Listës së Vetme të Projekteve Prioritare Strategjike përkatëse. Kjo kornizë e re i vendos një theks të veçantë aftësisë së Këshillit Kombëtar për Investimet për t’u bërë një mekanizëm gjithëpërfshirës priorizimi dhe planifikimi të detajuar, në gjendje të sigurojë burimet buxhetore dhe hapsirën fiskale të vendit, së bashku me kontraktimin e kredive dhe zbatimin e projekteve në kohë.⁴¹

38 Holzner, Stehrer & Vidovic, *op.cit.*, fq. 24.

39 Samiti i Vjenës për Ballkanin Perëndimor 2015, Addendum, Aneks 1, Connectivity Agenda, *Co-financing of Investment Projects in the Western Balkans in 2015*, fq. 4.

40 Western Balkans Investment Framework (WBIF), Albania – the Former Yugoslav Republic of Macedonia Power Interconnection (II): Grid Section in the Former Yugoslav Republic of Macedonia, fq.1, konsultoni: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/publication/2015/20150820_wbif_cf_1002_mkd_ene.pdf

41 Ibid.

Shqipëria ka përdorur mekanizmin ekzistues të WBIF për përgatitjen e dokumentave të projekt-financimeve. Që prej vitit të shkuar, metodologjia e re e WBIF për mbështetjen e projekteve infrastrukturore në Ballkanin Perëndimor ka prezantuar këto risi:

- Skemën e bashkë-financimit të investimeve;
- Një dallim të qartë midis projekteve “kombëtare” dhe “rajonale”;
- Ka sanksionuar krijimin e një mekanizmi të institucionalizuar.

Kjo metodologji synon të identifikojë, përgatisë dhe përzgjedhë për financim projektet prioritarë për investim - pavarësisht burimit të financimit – nëpërmjet ngritjes së Komitetit Kombëtar për Investimet dhe të Listës së Vetme të Projekteve Prioritare Strategjike. Ngritja dhe funksionimi i këtij komiteti është “çelësi” për miratimin e granteve bashkë-financuese për investimet në projekte rajonale dhe për projektet e ardhshme me asistencë teknike nën kornizën e WBIF.

Ndërsa procesi dhe aktorët mund të duken si një “risi”, deri më tani në Shqipëri ka ekzistuar Komiteti i Planifikimit Strategjik – një strukturë vendimmarrëse e kryesuar nga Kryeministri. Ky komitet ka pësuar disa modifikime të vogla në mënyrë që të përvetsojë parimet e Komitetit Kombëtar për Investimet – parimet e pronësisë, koherencës strategjike, qëndrueshmërisë dhe transparencës afatgjatë – si dhe rëndësinë dhe angazhimin në nivel politik për përzgjedhjen përfundimtare të projekteve. Për të mbështetur vendet e Ballkanit Perëndimor në zbatimin e kësaj kornize, asistencë teknike është ofruar nga Zyra e Koordinimit të Institucioneve Ndërkombëtare Financiare.

Përgatitja e Listës së Vetme të Projekteve Prioritare Strategjike është përgjegjësi e Njësisë për Planifikim dhe Zhvillimin Strategjik dhe procedura përbëhet nga shtatë hapa kryesorë.

Përgatitja e Listës së Vetme kombëtare të Projekteve Prioritare Strategjike (SPP) është përgjegjësi e Njësisë për Planifikim dhe Zhvillimin Strategjik (NPZHS) (pjesë e Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj) në Kryeministri. NPZHS, pjesë e Sekretariatit të Komitetit për Planifikim Strategjik / Komitetit Kombëtar për Investimet, udhëhoqi dhe koordinoi të gjithë procesin.⁴² Mekanizmi në zbatim në Shqipëri përbëhet nga shtatë hapa kryesorë, qëllimi i së cilës është miratimi përfundimtar i Listës së Vetme të Projekteve Prioritare Strategjike.

- **Hapi i 1^{ri}:** Ngritja e Grupit Sektorial për Menaxhim Strategjik (SSMG)

Kjo strukturë bazohet në një urdhër të ministrit kryesues (ministra që preket më shumë). SSMG-ja në fjalë kryesohet nga ministri ose sekretari i përgjithshëm përkatës. SSMG-ja është e ngarkuar me përgatitjen e kriterëve të rëndësisë strategjike për secilin sektor që do të përfshihet në përcaktimin e Fishës së Identifikimit të Projektit (PIF). PIF-et do të shërbejnë si dokument fillestar për përcaktimin e fushëveprimit të projekteve të ardhshme. SSMG-të do të vlerësojnë dhe rendisin PIF-et në përputhje me kriteret e dakordësuara të rëndësisë strategjike; dhe do të prodhojnë në fund Listën

⁴² Informacionet mbi metodologjinë, mekanizmin dhe zbatimin e procesit u siguruan nga znj. Oriana Arapi, Drejtore e Njësisë për Planifikim dhe Zhvillimin Strategjik (pjesë e Departamentit të Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndhmës së Huaj) në Kryeministri. NPZHS udhëhoqi dhe koordinoi procesin me ministritë e linjës dhe institucionet e përfshira në finalizimin e Listës së Vetme Sektoriale të Projekteve Prioritare Strategjike, si dhe përgatitjen dhe aprovimin e Listës së Vetme të Projekteve Prioritare Strategjike nga Komiteti për Planifikim Strategjik / Komiteti Kombëtar për Investimet.

e Vetme Sektoriale të Projekteve Prioritare Strategjike (lista e projekteve në këtëj sektori të veçantë e rradhitur sipas rëndësisë së tyre).

Gjatë periudhës korrik-gusht 2015, janë ngritur katër SSMG në fushat e transportit, energjisë, mjedisit dhe çështjeve sociale. Për të evituar mbivendosjen dhe për një përdorim më të mirë të burimeve njerëzore ekzistuese, SSMG-të e ngritura janë bazuar në strukturat ekzistuese të “Grupeve të Menaxhimit Strategjik”, të cilat janë pjesë procesit të përgatitjes vjetore të planifikimit të buxhetit afatmesëm.

- **Hapi i 2^{të}:** Përgatitja e Kritereve të Rëndësisë Strategjike të Fishave të Identifikimit të Projektit dhe trajnimi i stafit shqiptar

Kriteret e Rëndësisë Strategjike aplikohen në fazën e vlerësimit të fishave nga grupi i menaxhimit strategjik. Ato u diskutuan dhe dakordësuan nga ministritë e përfshira të linjës dhe u miratuan formalisht nga secili grup i menaxhimit strategjik gjatë muajve gusht-shtator 2015. Metodologjia e përgatitjes së fishave u përgatit në fillim të shtatorit.

Metodologjia e re iu prezantua palëve shqiptare të interesuara dhe ministrive të linjës nëpërmjet një serie trajnimesh/seminarësh: (i) në korrik u zhvilluan tre evente për secilin sektor: transport, energji dhe ujë; dhe (ii) në shtator një event për sektorin e çështjeve sociale. Këto evente zgjatën gjysëm dite dhe nëpërmjet tyre stafi i ministrive të interesuara u informua mbi kornizën, procesin, procedurat dhe punën në vijimësi.

- **Hapi i 3^{të}:** Përgatitja dhe dorëzimi i 112 fishave

Në mes të shtatorit numri total i fishave të identifikimit të projektit të dorëzuara për shqyrtim formal nga sekretariati teknik i Komitetit Kombëtar për Investimet ishte 112. Për shkak të mungesës së stafit, sekretariati teknik bëri vetëm vlerësimin e përgjithshëm dhe të përshtatshmërisë të cilësisë prej fishave. Nga ky proces rezultoi se cilësia e fishave të dorëzuara nuk i përmbushte pritshmëritë.

Gjatë kësaj faze u identifikuan gjithashtu disa probleme. Së pari, Njësitë e Qeverisjes Vendore nuk ishin përfshirë në fazën përgatitore të fishave, çka ndikon në pranimin dhe mbështetjen nga popullsia lokale të Procesit të Berlinit, si dhe të strategjive të territorit dhe të planeve të zhvillimit lokal. Së dyti, cilësia e fishave të dorëzuara u ndikua nga mungesa e një kuadri strategjik (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 - 2020⁴³, si dhe nga Strategjitë Sektoriale të Transportit dhe Energjisë, 2015-2020). Së treti, është ende e paqartë madhësia e dritares financiare në dispozicion për bashkë-financim kombëtar të këtyre projekteve. Për më tepër, lidhja e mundshme dhe harmonizimi me planifikimin e buxhetit afatmesëm duhet të realizohet më mirë në këtë fazë - Drejtoria e Buxhetit duhet të përfshihet tërësisht në proces (kjo pritet të korrigjohet në 2016). Së fundmi, ndërsa nevojat financiare të projekteve aktuale në zbatim janë përfshirë në disa raste – p.sh. në projektin e Korridorit të Kaltër – ato mungojnë ose janë të padisponueshme për projektet e ujit dhe tëmbetjeve.

⁴³ Përgatitja e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015-2020 është kompetencë e Njësisë për Planifikim dhe Zhvillimin Strategjik. Ky është dokumenti strategjik kryesor kombëtar, i cili kombinon perspektivën zhvillimore dhe integrimin evropian të vendit. SKZHI-ja përmban prioritetet politike dhe drejtimet zhvillimore kryesore, që duhet të zbatohen brenda vitit 2020, duke dhënë udhëzime për perspektivën financiare dhe makroekonomike. SKZHI-ja ofron një kuadër real për përfshirjen e Procesit të Berlinit nën prioritetet kryesore të politikave dhe tek shpenzimet buxhetare të vendit. Draft SKZHI-ja është duke u finalizuar dhe do të miratohet nga Komiteti për Planifikim Strategjik.

- **Hapi i 4^{të}:** Grupi i menaxhimit strategjik dhe kryerja e vlerësimeve të rëndësishme strategjike

Secili Grup i Menaxhimit Strategjik është përgjegjës për kryerjen e vlerësimit të rëndësishme strategjike dhe të fishave (grid) të projekteve. Nën koordinimin e punonjësit të lartë të programit dhe pas miratimit në nivel politik të secilit sektor nga ministria kryesuese, SMG-ja harton listën përfundimtare të projekteve të propozuara sipas sektorit, të cilat më pas do t'i prezantohen donatorëve. Në këtë fazë kemi ende katër lista të projekteve prioritare strategjike të ndryshme – një për secilën SSMG – dhe asnjë Listë të Vetme të Projekteve Prioritare Strategjike.

OSHC-të, think tanket dhe akademia duhet të përfshihen gjithashtu në këtë fazë. Hapja e procesit ndaj shoqërisë civile lidhet me transparencën dhe pjesëmarrjen e tyre në politikëbërje, çka është vendimtare për një planifikim më të mirë të projekteve prioritare të vendit. Kjo çështje duhet të diskutohet në raundin e ardhshëm të përditësimit të SSPP-së.

- **Hapi i 5^{të}:** Finalizimi i katër Listave të Vetme Sektoriale të Projekteve Prioritare Strategjike dhe konsultim me donatorët

Gjatë kësaj faze, katër Listat Vetme Sektoriale të Projekteve Prioritare Strategjike janë plotësuar me vlerësimet përkatëse të mangësive. Gjithashtu, në bashkëpunim me grupin kryesor të buxhetit bëhet identifikimi i hapësirës fiskale. Më pas, me secilën ministri përgjegjëse bëhet harmonizimi i planifikimit të buxhetit afatmesëm me fondet IPA.

Në thelb, SMG-ja merr katër SSPP të ndryshme dhe është e lirë të përzgjedhë projektet që do të paraqiten për financim. Ndonëse duket llogjike, kjo qasje lë listën e projekteve të pambrojtur nga cikli politik dhe nga preferencat elektorale përkatëse. Ndikimi nga “fjala e fundit e politikës” bëhet edhe më i madh karshi kohëzgjatjes dhe kostos së këtyre projekteve.

Në këtë fazë, katër listat e SSPP-ve konsultohen me donatorët, por nevojitet hapja e konsultimeve ndaj palëve të tjera të interesuara, si përfaqësues të OSHC-ve, akademisë, etj. Konsultimi dhe hapja e procesit është parakusht për një kufizim sa më të madh të influencës së cikleve politike.

- **Hapi i 6^{të}:** Finalizim, konsultim dhe miratim i Listës së Vetme të Projekteve Prioritare Strategjike

Në këtë fazë, sfida kryesore mbetet identifikimi i kriterëve që mundësojnë shkrirjen e katër SSPP-ve të ndryshme në një SPP-je të vetme. Kjo vështirësi u kapërcye nëpërmjet prezantimit të disa parimeve kryesore në renditjen dhe priorizimin e projekteve, në mënyrë që të krijohet një listë projektesh/SPP unike dhe homogjene.

Nën mbështetjen teknike të IFICO-s, u prezantuan tre elementë për kategorizimin dhe renditjen përfundimtare të projekteve të Berlinit: (i) rëndësia strategjike; (ii) pjekuria e tyre në terma zbatimi; dhe (iii) qëndrueshmëria e tyre financiare pas përfundimit të investimit. Vlerësimi i projekteve u bë në bazë të këtyre tre parimeve. Ka qënë shumë e rëndësishme përfshirja e bashkëpunimit rajonal dhe e kriterëve të rëndësishëm. Draft SPP-ja u prezantua në takimin e Partnerëve për Zhvillim dhe Integrim.⁴⁴

⁴⁴ Takimi i Partnerëve për Zhvillim dhe Integrim është një mbledhje e rregullt e donatorëve, pjesë e mekanizmit të koordinimit të donatorëve drejtuar nga Sekretariati Teknik i Donatorëve.

• **Hapi i 7^{të}:** Mbyllja e procesit

Lista e SPP-së u diskutua nga Komiteti për Planifikim Strategjik / Komiteti Kombëtar për Investimet, i cili debatoi mbi rëndësinë strategjike të projektit kryesor prioritar, dhe miratoi më pas SPP-në finale. Lista e Vetme e Projekteve Prioritare Strategjike iu dorëzua Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë dhe do të prezantohet në Samitin e Parisit.

Në mes të shtatorit numri total i fishave të dorëzuara ishte 112. Ndërkohë, numri është reduktuar në 78 (tabela 3), duke i dhënë prioritet projekteve me cilësi më të lartë. Cilësia e tyre është ndikuar kryesisht nga mungesa e personelit, mungesa e miratimit të një Strategjie Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrimin, si dhe të Strategjive Sektoriale për Transportin dhe Energjinë për periudhën 2015-2020.

Tabela 3: Lista e Vetme Sektoriale e Projekteve Prioritare Strategjike, Nëntor 2015

Nr.	Sektori	Nr. i fishave të dorëzuara	Nr. i projekteve të vlerësuara	Kostot/sektori i parashikuar (në milionë EUR)
1	Energji	13	13	175
2	Transport	13	13	1.193
3	Mjedis	20	20	508
4	Çështje sociale	32	17*	165
	Totali	78	63	2 041

Burimi: Zyra e Kryeministrit dhe përpunim i autorëve.

*Projektet në fushën e arsimit nuk janë të përfshira.

Kosto totale për zbatimin e 78 fishave është pothuajse 2.041 milion euro dhe afërsisht 58% e kësaj vlere shkon për projektet e transportit.

Në mes të dhjetorit, SPP-ja - e përbërë nga 15 projekte me rëndësi rajonale (apo projekte të agjendës së konektivitetit) dhe 24 projekte me rëndësi kombëtare - iu prezantua BE-së dhe WBIF-it. Këto 39 projekte kanë nevojë për një financim total prej 1.899 miliardë euro dhe 92% të hendeut financues (vetëm 141 milion euro do të mbulohen me grante/kredi ose nga buxheti).

Në këtë fazë, sfida kryesore është identifikimi i hapësirës fiskale në dispozicion, që do të mundësonte bashkë-financimin e projekteve nga qeveria, dhe do të qartësonte madhësinë e dritares financiare në dispozicion. Në periudhën afatshkurtër, Shqipëria, sikurse të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, po has papunësi të lartë, norma të ulta të rritjes ekonomike dhe shqetësime për një borxh publik të lartë. Ndrydhja e financave publike mund të ndikojë në bashkë-financimin e projekteve të mësipërme dhe në fizibilitetin e tyre. Në krahasim me investimet e tjera të mundshme që ndikojnë mbi shpenzimet buxhetore, nuk ekziston asnjë vlerësim paraprak mbi efikasitetin dhe kosto-efektivitetin e këtyre projekteve madhore. Një vlerësim më i mirë dhe menaxhim i mëvonshëm i investimeve aktuale të dështuara apo të ndërprera apo një orientim i investimeve aktuale drejt prioritetëve të politikave kombëtare nuk do të ishte i mjaftueshëm. Zgjidhje të reja dhe alternative duhet të eksploroohen nëpërmjet investimeve të huaja direkte dhe pjesëmarrjes së aktorëve privatë në këto “paketa investimesh të mëdha”. Qeveria duhet të jetë më agresive përsa i përket tërheqjes së sa më shumë investimeve të huaja direkte, çka do të mundësonte kapital të ri dhe teknologji moderne, do të promovonte zhvillimin ekonomik dhe do të gjeneronte punësim fitimprurës dhe pasuri.

5. Procesi i Berlinit dhe “shpella e Ali Babës” e nismave rajonale

5.1 Mësimet nga Pakti i Stabilitetit

Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore i nisur në 1999, u pasua në 2008 nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal. Është interesante të theksohet se - megjithëse me një diferencë gjashtë vjeçare – Procesi i Berlinit dhe Pakti i Stabilitetit ndajnë qëllime të ngjashme, të tilla si nxitja dhe forcimi i bashkëpunimit midis vendeve të rajonit dhe riorganizimi i përpjekjeve ekzistuese drejt anëtarësimit në BE. Fushat e tyre janë pothuajse të njëjta, ndonëse kushtet fillestare ndryshojnë nga njëra-tjetra në mënyrë substanciale.

Të dyja këto nisma janë konsideruar si tepër të rëndësishme për zhvillimin e rajonit dhe kanë krijuar pritshmëri të mëdha. Nga perspektiva politike, Pakti i Stabilitetit është konsideruar si një eksperiencë pozitive, e cila krijoi bazat për Procesin e Berlinit, duke bërë të mundur në këtë mënyrë krijimin e “paktit të ndërlidhjes” dhe duke synuar drejt “paktit të demokracisë dhe zhvillimit”.⁴⁵

Pakti i Stabilitetit kishte një natyrë të gjerë shumëpalshe⁴⁶, çka tregoi mungesën e kapacitetit të donatorëve për t’u koordinuar në mënyrë efektive me njëri-tjetrin gjatë fazës së shpërndarjes së fondeve drejt fushave specifike të ndërhyrjes.⁴⁷ Gjithashtu, Pakti i Stabilitetit pësoi probleme në keqinterpretimin e strategjisë së tij për shkak të: a) mungesës së një drejtimi të qartë; b) konceptimit jo të mirë dhe me mekanizma jo transparent në përzgjedhjen e projekteve prioritare për financim; dhe, c) mungesës serioze së përfshirjes së rajonit dhe të kontributit në Procesin e Stabilizimit dhe Asociimit.⁴⁸ Është e rëndësishme të theksohet se donatorët dhe ekspertët kanë pohuar vazhdimisht se Pakti i Stabilitetit arriti të gjeneronte lista projektesh në vend të strategjive dhe planeve të veprimit gjithëpërfshirëse.⁴⁹

Përsa i përket Procesit të Berlinit, krahasuar me Paktin e Stabilitetit, numri i aktorëve të përfshirë është më i vogël (dhe do të nënvizonim përfshirjen strategjike të shoqërisë civile). Megjithatë, është i habitshëm fakti që Procesi i Berlinit i jep gjithashtu një theks të veçantë projekteve infrastrukturore me kosto të lartë. Aktualisht, pavarësisht kushteve të favorshme në tregjet ndërkombëtare të kapitaleve, për shkak të nivelit të lartë të borxhit publik, qeveritë e Ballkanit Perëndimor nuk disponojnë burimet për të bashkë-financuar pjesërisht këto projekte infrastrukture. Ndërkohë nuk

45 Ditmir Bushati cituar tek Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, “Ministri Bushati merr pjesë në Konferencën e Ministrave të Jashtëm të EJT në Berlin”, 25 nëntor 2015, konsultoni: <http://www.punetejashtme.gov.al/al/zyra-e-shtypit/lajme/ministri-bushati-merr-pjesë-ne-konferencen-e-ministrave-te-jashtem-te-ejt-ne-berlin?page=1>

46 Termi i referohet numrit të konsiderueshëm të pjesëmarrësve në Paktin e Stabilitetit, duke filluar me vendet anëtare të BE-së, vendet e G8-s, Organizatat Ndërkombëtare (OKB, OSBE, Këshilli i Evropës, UNHCR, NATO, OECD, WEU), Institucionet Ndërkombëtare Financiare (Banka Botrore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim), Iniciativat Rajonale (Procesi i Royaumontit, BSEC, CEI, SECI, SEECIP), dhe vende të tjera.

47 H. D. Jacobsen, “The Stability Pact for South East Europe – Did it work?”, Contribution to the Isodarco 15th Winter Course “South-Eastern Europe – Internal Dynamics and External Intervention”, Andalo, 20-27 janar 2002, konsultoni: <http://www.isodarco.com/courses/andalo02/paper/andalo02-jacobsen.html>

48 Ibid.

49 Ibid.

ka studime gjithëpërfshirëse mbi kostot dhe përfitimet nga këto investime, si dhe ndikimin e tyre në ekonominë e këtyre vendeve. Në të shkuarën e afërt të rajonit, disa projekte infrastrukture janë dëmtuar nga akuza për korrupsion dhe kosto mirëmbajtjeje shumë të larta.

Vërehet se në mungesë të strategjive të qarta të zhvillimit lokal dhe rajonal, të modeleve të qëndrueshme të zhvillimit ekonomik të Ballkanit Perëndimor, të homologëve politik kompetentë dhe të besueshëm, donatorët ndërkombëtare preferojnë të alokojnë fondet për projekte që kanë rezultate të dukshme dhe të matshme.⁵⁰ Kjo sjellje përputhet me modelin e biznesit të institucioneve ndërkombëtare financiare – publike dhe private – të cilat janë shumë të pranishme në proces. Në rastin e Procesit të Berlinit – dhe ekonomive jo të qëndrueshme të Ballkanit Perëndimor – nuk është ende e qartë se deri në çfarë shkalle donatorët (dhe bankat) do të përfshihen në zbehjen e projekteve post-infrastrukture dhe cila do të jetë kostoja që vendet do të duhet të mbulojnë vet.


5.2 Matrica e bashkëpunimit në Ballkanit Perëndimor

Nisma të ndryshme tematike janë shfaqur në rajon që prej Paktit të Stabilitetit, me qëllim ndërtimin e lidhjeve të forta midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe për të lehtësuar bashkëpunimin teknik në fushat me interes të përbashkët. Pavarsisht ambicjeve të tyre për të arritur pajtimin dhe transformimin e rajonit, shumica e këtyre nismave të bashkëpunimit rajonal janë përballur me fragmentim, mbivendosje të përgjegjësisë, mungesë të influencës, etj.

Mbivendosja e Procesit të Berlinit në matricën aktuale të bashkëpunimit rajonal rrezikon të “shkeli mbi këmbët” e nismave të tjera ekzistuese. Për të evituar çdo mundësi të dyfishimit të kompetencave, përfaqësuesit e vendeve të Ballkanit Perëndimor kanë pohuar se, në kuadër të Procesit të Berlinit, qeveritë e tyre do të veprojnë në komplementaritet dhe sinkronizim paraprak me nismat e themeluara më herët.

Krahasimi i Agjendës së Berlinit me nismat tematike rajonale ekzistuese identifikon ekzistencën e disa mbivendosjeve, të cilat duhet të adresohen nëpërmjet koordinimit të përbashkët, sinkronizimit dhe/ose nëpërmjet masave shfuqëzuese. Figura 1 paraqet një panoramë të fushave të veprimit të nismave dhe mbivendosjen e tyre me Procesin e Berlinit.

Figura 1: Mbivendosje midis nismave të ndryshme rajonale dhe Procesit të Berlinit.



Burimi: Përpunim i autorëve.

50 Ibid.

Së pari, bashkëpunimi me Këshillin për Bashkëpunim Rajonal është siguruar përmes përfshirjes së RCC-së si aktor i përhershëm i Procesit të Berlinit.

Pesë nismat e tjera janë teknike ose shumë politike dhe si të tilla vazhdojnë të operojnë përkrahë dhe në bashkëpunim (disa në sinkronizim, si p.sh. SEETO) me Procesin e Berlinit.

- **Observatori i Transportit për Evropën Juglindore (SEETO)** është një organizatë rajonale teknike e themeluar në 2004 me një Memorandum Mirëkuptimi midis vendeve të Ballkanit Perëndimor. Detyra e tij është të ndihmojë në zbatimin e memorandumit dhe nuk ka kompetenca ekzekutive. SEETO promovon bashkëpunimin në zhvillimin e infrastrukturës kryesore dhe ndihmëse të transportit në Evropën Juglindore; përqipet të rrisë kapacitetet lokale në zbatimin e programeve të investimeve; dhe të integrojë Rjetin Gjithëpërfshirës të SEETO-s në kuadrin e gjerë të Rjetit Trans-Evropian. Rjeti Gjithëpërfshirës i SEETO-s lidhet me rrjetin TEN-T dhe ai është i përbërë prej 6,554 km rrugë, 4,807 km linjë hekurudhore, 4 lumenj, 10 porte detare, 17 aeroporte dhe 8 porte të brendshëm të lumenjëve të lundrueshëm. SEETO është porta kryesore e projekteve ndërlidhëse të transportit në Procesin e Berlinit.

Deklarata e Berlinit nënvizon rëndësinë e infrastrukturës së transportit për Ballkanin Perëndimor, si një shtysë pozitive për zhvillimin ekonomik dhe për ndërlidhjen logjistike të rajonit me tregjet evropiane.⁵¹ Në këtë drejtim, në Ministerialin e Brukselit, kryeministrat e rajonit ranë dakord mbi rrjetin kryesor të transportit, bazuar në Rrjetin Gjithëpërfshirës të SEETO-s, duke reflektuar udhëzimet e rrjetit TEN-T. Procesi i Berlinit u sinkronizua zyrtarisht me SEETO-n gjatë Samitit të Vjenës, ku u mandatua RCC-ja – së bashku me SEETO-n dhe aktorë të tjerë - për koordinimin e zhvillimit të konceptit të korridoreve ekonomike, në funksion të Samitit të ardhshëm të Parisit.⁵²

Më poshtë, janë listuar katër nisma politike rajonale që mbulojnë fusha tematike të njëjta me ato të Agjendës së Berlinit:

- **Procesi i Bashkëpunimit Juglindor (SEECIP)** është një nismë rajonale jo institucionale, e ndërmarrë në 1996, dhe që synon të forcojë procesin e reformave demokratike në rajon. SEECIP mbështetet në parimin e pronësisë rajonale dhe mbulon bashkëpunimin në fushat politike, ekonomike dhe teknologjike. Pjesëmarrja është në nivel të lartë të përfaqësuesve të shtetit dhe në bazë rotacioni, çdo vend anëtar ka presidencën për një vit. SEECIP nuk ka një sekretariat të përhershëm, për shkak të hezitimit të disa prej vendeve anëtare, të cilat kishin frikë se një përfshirje më e madhe do t'u vinte në rrezik progresin drejt anëtarësimit në BE.⁵³ SEECIP nuk ka shkuar kurrë përtej deklaratave politike, duke mos patur kështu një ndikim real në nivel rajonal, duke i munguar shikueshmëria në rajon dhe duke e shndërruar parimin e pronësisë rajonale në një deklaratë të thjeshtë retorike.⁵⁴

Në kuadër të Procesit të Berlinit, Ministerialet e Beogradit dhe Brdos pohuan rëndësinë e nxitjes së bashkëpunimit dhe sigurimit të komplementaritetit me Procesin e Bashkëpunimit Juglindor. Më tej, SEECIP deklaroi partneritetin e tij strategjik me RCC-në në thellimin e procesit të bashkëpunimit rajonal, duke bërë thirrje për “përfshirje dhe hapje të mëtejshme të Procesit të Berlinit, përfshirë një

51 Deklarata Finale e Kryetarit të Konferencës për Ballkanin Perëndimor, Berlin, 28 gusht 2014, pika 16.

52 Deklarata Finale e Kryetarit të Samitit të Vjenës për Ballkanin Perëndimor, Vjenë, 27 gusht 2015, pika 28.

53 Malinka Ristevska Jordanova, “Regional Cooperation in the Balkans 1996-2008 – from Imposed to Intrinsic”, në FES (ed.), *Dialogues: Ownership for Regional Cooperation in the Western Balkan Countries*, qershor 2009, fq. 57.

54 Ibid., fq. 64.

angazhim më të madh financiar”.⁵⁵ Megjithatë, deri në fund të 2015 asnjë veprim i mëtejshëm nuk u ndërmor rreth rolit potencial të SEECp-së në kuadër të Procesit të Berlinit.

- **Iniciativa Rajonale per Migrimin, Azilin dhe Refugjatët (MARRI)** është një organizatë ndërkombëtare e themeluar në 2003 në Shkup, që synon të lehtësojë shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencës, si dhe të marrë vendime me interes të përbashkët në fushën e azilit, migrimit, menaxhimit të kufijve, etj. Iniciativa bazohet në parimin e pronësisë rajonale. Forumi Rajonal i MARRI-t është organi më i lartë mbështetës dhe është i përbërë nga Ministrat e Brendshëm të Ballkanit Perëndimor, të cilët takohen dy herë në vit për qëllime koordinimi dhe konsultimi mbi çështje ndërsektoriale.

Në mbledhjen e tij të fundit, Forumi Rajonal i MARRI-t miratoi Deklaratën e Shkupit, e cila pohon angazhimin e forumit në Procesin e Berlinit dhe intensifikimin e punës me strukturat rajonale. Agjenda e Berlinit i jep një rëndësi të veçantë çështjeve të migrimit, ndonëse nuk i bën asnjë referim MARRI-t apo kontributit të tij potencial.

Totalisht i shkëputur nga Procesi i Berlinit është dhe Forumi Ministror BE-Ballkani Perëndimor.

- **Forum i Ministror BE-Ballkani Perëndimor mbi Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme** është një nismë e ngritur me mandat të Këshillit Evropian të Selanikut në qershor 2003. Pjesëmarrës në takime janë vendet e WB6, përfaqësues të institucioneve dhe agjencive të BE-së, Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, etj.
- **Procesi i Brdo-Brijunit** u ndërmor në 2013 nga Kroacia dhe Sllovenia me qëllim nxitjen e bashkëpunimit rajonal dhe dialogut strategjik. Kjo është një nismë e nivelit të lartë e cila mbledh një herë në vit kryetarët e shteteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe figura të shquara nga vendet anëtare të BE-së.

Ndonëse jo formalisht pjesë e Procesit të Berlinit, Procesi i Brdo-Brijunit ka krijuar një platformë për dialog politik rajonal bazuar në marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe mirëkuptimit të përbashkët. Në takimin vjetor të korrikut 2014 mori pjesë Kancelarja gjermane Merkel dhe vëmendja u fokusua tek nevoja për të investuar në projekte infrastrukturore kyçe dhe në politikën energjitike të vendeve të Ballkanit Perëndimor.⁵⁶ Ndërkohë në takimin vjetor të 2015 mori pjesë Presidenti austriak dhe aty u dha një rëndësi e veçantë luftës ndaj ekstremizmit, rritjes ekonomike të qëndrueshme, ndërlidhjes dhe mobilitetit rinor.⁵⁷

Roli i Procesit të Brdo-Brijunit duhet të rishikohet drejt kompetencave më të mëdha, duke qënë se ai ofron një platformë të vlefshme për përfshirjen e kryetarëve të shteteve të Ballkanit Perëndimor në Procesin e Berlinit.

Në tërësi, vetëm RCC dhe SEETO janë të integruara në kuadrin e Procesit të Berlinit. Ndërkohë roli, kontributi dhe bashkëpunimi me SEECp, MARRI-n dhe Forumin Ministror BE-Ballkani Perëndimor janë ende në pikëpyetje. Duke patur parasysh anëtarësinë dhe fushën tematike, nuk është e paimagjinueshme që MARRI dhe Forumi Ministror të shndërrohen në një iniciativë të vetme.

⁵⁵ Deklarata e Samitit të Tiranës të SEECp, Tiranë, 26 maj 2015, pika 5.

⁵⁶ Zyra e Presidentit të Republikës së Sllovenisë, Presidenti slloven Pahor dhe Presidenti kroat Josipović presin krerët e Procesit të Brdo-s në Dubrovnik, Komunikatë për Shtyp, Dubrovnik, 15 korrik 2014, konsultoni: <http://www.up-rs.si/up-rs/uprs-eng.nsf/pages/86AC1F31BD4A4B2FC1257D3400433769?OpenDocument>

⁵⁷ Zyra e Presidentit të Republikës së Sllovenisë, Konkluzionet e Samitit të Përvitshëm të Procesit të Brdo-Brijunit, Budva, 8 qershor 2015.

Ndërsa roli i Procesit të Brdo-Brijunit duhet të rishikohet drejt kompetencave më të mëdha, duke qënë se ai ofron një platformë të vlefshme për përfshirjen e kryetarëve të shteteve të Ballkanit Perëndimor në Procesin e Berlinit.

6. A do ta kthejë Parisi në një “Proces”?

Ndonëse është i pamohueshëm “efekti shkrirës” që Procesi i Berlinit ka patur në bashkëpunimin rajonal të Ballkanit Perëndimor deri më tani, ne duhet të vlerësojmë zbatimin e tij në terren, ndikimin në sektorët e synuar dhe cilat janë kostot për buxhetet kombëtare dhe qytetarët e vendeve të rajonit. Ambicjet e përcaktuara janë të larta dhe të kushtueshme dhe reflektojnë kostot e larta të projekteve të ndërlidhjes infrastrukturore. Gjithashtu, këto projekte janë komplekse, kanë nevojë për një periudhë të gjatë zbatimi dhe aksione të mëdha ndërkufitare mes vendeve të WB6. Në skenarin më të keq, zbatimi i tyre mund të shtrembërojë strategjitë kombëtare ekzistuese për zhvillim dhe integrim, bilancën fiskale dhe planifikimin buxhetor përkatës, si dhe/ose të ndikojë negativisht në llogaritë kombëtare.

Një strategji ekonomike e përbashkët përfshirëse e të gjitha reformave të nevojshme në vendet e Ballkanit Perëndimor është e vetmja mundësi për të përshpejtuar procesin, si një shtysë e re drejt integritimit në BE. Vlerësohet shumë fakti që në Procesin e Berlinit çështjet ekonomike dhe sociale luajnë një rol të madh, por rritja e balancuar ka nevojë për një qasje gjithëpërfshirëse.

Një strategji ekonomike e përbashkët përfshirëse e të gjitha reformave të nevojshme në vendet e Ballkanit Perëndimor është e vetmja mundësi për të përshpejtuar procesin, si një shtysë e re drejt integritimit në BE.

Një strategji e thjeshtë e promovimit të ndërtimit të infrastrukturës së nevojshme nuk do të ketë sukses për aq kohë sa nuk do të plotësohet nga një strategji që mbështet ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Zhvillimi ekonomik nuk mund të bazohet vetëm në sektorin e ndërtimit, me ngritjen e rrugëve (me financa publike) dhe të shtëpive (shpesh me prurje të remitancave). Rajoni ka nevojë për një zhvillim paralel të infrastrukturës, përfshirë këtu: nga njëra anë, ndërlidhjet hekurudhore më të mira e më të shpejta dhe transportin publik lokal; dhe nga ana tjetër, një ri-industrializim të lidhur me shërbimet dixhitale. Vetëm një zhvillim i tillë i balancuar mund të nxisë rritjen ekonomike, të krijojë një vlerë të shtuar të lartë dhe punësim të qëndrueshëm për rininë.

Ndërlidhja e rajonit sigurisht do të rrisë mundësitë për qytetarët dhe për kompanitë që të ulin kostot operacionale dhe të jenë më konkurrues në tregjet globale dhe të BE-së. Megjithatë, pa politikën e duhur industriale që mbështet prodhimin lokal, që inkurajon ngritjen e aktiviteteve ekonomike inovative dhe me vlerë të shtuar, që integron ndërmarrjet e WB6 në zinxhirin e vlerave të BE-së, ndërlidhja infrastrukturore do ta konvertojë Ballkanin Perëndimor vetëm në një treg të madh konsumatorësh. Qeverisja e përbashkët ekonomike e WB6, e fokusuar tek ri-industrializimi – i përshtatur për shekullin e XXI – duhet të jetë së paku në të njëjtin nivel me ndërlidhjen.

Procesi i Berlinit ofron një mundësi unike për Ballkanin Perëndimor për t’u përgatitur dhe koordinuar më mirë, në mënyrë që të rrisë peshën e vet gjatë negociatave të ndryshme, jo vetëm me BE-në, por gjithashtu me institucionet ndërkombëtare financiare ose me organizatat ndërkombëtare.

Shqipëria ndan të njëjtin profil dhe qëllim afatgjatë me fqinjët e saj: një vend kandidat që synon të bëhet pjesë e pandarë e Bashkimit Evropian. Megjithatë, kriza e vazhdueshme ekonomike dhe financiare, flukset migratore dhe pyetjet e shpeshta që BE po ngre rreth faktit se ku dëshiron të jetë pas 10 apo 30 vjetësh, e bëjnë bashkëpunimin rajonal me fqinjët e Ballkanit edhe më të nevojshëm. Ky dimension rajonal i politikave kombëtare mund të ilustruhet me fjalimin e Kryeministrit Rama në Hong Kong ku ai promovoi Shqipërinë si pikëmbështetje të një tregu me 26 milion banorësh.⁵⁸

Në nivel kombëtar, institucionet shqiptare kanë nevojë të avancojnë drejt një përgatitjeje më të mirë të projekteve infrastrukturore, duke filluar me një koordinim më të mirë midis ministrive të ndryshme të linjës. Hapësira fiskale ka nevojë të merret realisht në konsideratë kur planifikohen financime, sikurse të konsiderohen kompleksiteti dhe kostot e mirëmbajtjes. Rreth “masave të buta”, Shqipëria mbështet nismën e Zyrës për Bashkëpunimin Rinor Rajonal dhe duhet të përdorë këtë mundësi për të rritur profilin e saj. Çështje të tjera si VET apo migrimi kanë nevojë gjithashtu për vëmendje të plotë të autoriteteve, për të mundësuar një pjesëmarrje profesionale dhe të koordinuar të vendit në Procesin e Berlinit.

Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, kontributi i shoqërisë civile të Shqipërisë mbetet një nga kartat kryesore që vendi duhet të përdorë për të aritur objektivat e dakordësuara për një pjesëmarrje efikase në Procesin e Berlinit. Njohuria, energjia, rrjetet dhe burimet e shoqërisë civile shqiptare janë një aset i paçmuar që duhet të përdoret në bashkëpunim organik me qeverinë dhe eventualisht me institucionet parlamentare.

7.Pyetje pa përgjigje


Në tërësi, Procesi i Berlinit është konsideruar si një nisme inkurajuese dhe konstruktive si për marrëdhëniet ndërqeveritare ashtu dhe për zhvillimin ekonomik të rajonit. Megjithatë, përgjatë punës kërkimore, autorët kanë identifikuar një sërë çështjesh që kanë mbetur akoma pa përgjigjen e duhur:

- Së pari, të gjitha deklaratat e përbashkëta i referohën “investimeve afatgjata dhe mbështetjes financiare të donatorëve ndërkombëtar”. Do të ishte me interes zbulimi i arsyes pse u përzgjedhën investimet infrastrukturore, në vend që të adresoheshin vëmendja drejt sektorëve të tjerë, si ata që përmenden në strategjinë SEE 2020;
- Së dyti, duke qënë se Procesi i Berlinit pritet të zgjasë deri në 2018, sa do arrijnë të përmbushin vendet e Ballkanit Perëndimor në kuptimin e respektimit të standardeve kryesore të vendosura nga BE deri atëherë?
- Së treti, asnjë referencë nuk i bëhet qëndrueshmërisë financiare efektive të projekteve. Në periudhën afatshkurtër, pothuajse të gjitha vendet e rajonit përballen me papunësi të lartë, norma të ulta rritjeje dhe probleme me borxhin e lartë publik. Asnjë vlerësim nuk është kryer mbi efikasitetin e tyre kur krahasohen me objektiva të tjerë të mundshëm, të cilët ndikojnë në madhësinë e investimeve publike tëWB6;
- Së katërti, si do të ndikojnë dhe nxisin këto projekte – që janë të gjitha afatgjata dhe shkojnë përtej 2018 – hapjen dhe mbylljen e kapitujve gjatë negociatave? A mbetet anëtarësimi në BE

⁵⁸ Edi Rama, “Investimi në Shqipëri do të thotë investim në një treg prej 26 mln banorësh”, Gazeta Dita, 28 tetor 2015, konsultoni: <http://www.gazetadita.al/investimi-ne-shqiperi-do-te-thote-investim-ne-nje-treg-26-mln-banorësh/>

prioriteti kyç i Ballkanit Perëndimor apo vjen bashkëpunimi rajonal në vend të parë?

- Së pesti, si është i integruar Procesi i Berlinit në strategjitë kombëtare për zhvillim dhe integrim? Si ndërvepron ai me planifikimin buxhetor me plan veprimet, me strategjitë e sektorëve të tjerë, dhe veçanërisht me strategjitë e zhvillimit socio-ekonomik?
- Së gjashti, Deklarata e Vjenës rrit numrin e tematikave nën konsideratë, duke përfshirë luftën kundër ekstremizmit dhe radikalizmit, si dhe migrimin. Kjo krijon një precedent për përfshirjen e çështjeve të tjera përgjate tre viteve të ardhshme. Zgjerimi i agjendës rrezikon të spostojë vëmendjen nga ndërlidhja tek drejtësia dhe çështjet e brendshme dhe/ose çështje të minutës së fundit. Mungesa e një hierarkie të prioriteteve politike mund të minojë procesin.
- Së fundmi, rëndësia që iu dha rinisë dhe shoqërisë civile është një zhvillim strategjik që duhet të kapitalizohet. Kjo mundësi duhet të kompletohet me një vizion të qartë, me një plan aktiviteteve realist dhe me një mbështetje afatgjatë nga autoritetet kombëtare, nga BE-ja dhe nga vendet e saj anëtare të përfshira në Procesin e Berlinit.




Aneks

Tabela 4: Pjesëmarrësit e Konferencës së Berlinit dhe Samitit të Vjenës

	Konferenca e Berlinit	Samiti i Vjenës
Shqipëria	Edi Rama , Kryeministër Ditmir Bushati , Ministër i Punëve të Jashtme Arben Ahmetaj , Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes	Edi Rama , Kryeministër Ditmir Bushati , Ministër i Punëve të Jashtme Arben Ahmetaj , Ministër i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes
Bosnja dhe Hercegovina	Vjekoslav Bevanda , Kryetar i Këshillit të Ministrave Zlatko Lagumdžija , Zëvendës Kryetar i Këshillit të Ministrave Boris Tučić , Ministër i Marrëdhënieve Ekonomike dhe Tregëtisë me Jashtë	Denis Zvizdić , Kryetar i Këshillit të Ministrave Mirko Šarović , Zëvendës Kryetar i Këshillit të Ministrave dhe Ministër i Marrëdhënieve Ekonomike dhe Tregëtisë me Jashtë Igor Crnadak , Ministër i Punëve të Jashtme
Maqedonia	Nikola Gruevski , Kryeministër Vladimir Peševski , Zëvendës Kryeministër për Marrëdhëniet Ekonomike Bekim Neziri , Ministër i Ekonomisë	Nikola Gruevski , Kryeministër Nikola Popovski , Ministër i Punëve të Jashtme Bekim Neziri , Ministër i Ekonomisë
Mali i Zi	Milo Djukanovic , Kryeministër Igor Lukšić , Ministër i Punëve të Jashtme Vladimir Kavarić , Ministër i Ekonomisë	Milo Djukanovic , Kryeministër Igor Lukšić , Ministër i Punëve të Jashtme Vladimir Kavarić , Ministër i Ekonomisë
Kosova	Hashim Thaci , Kryeministër Enver Hoxhaj , Ministër i Punëve të Jashtme Besim Beqaj , Ministër i Financave	Isa Mustafa , Kryeministër Hashim Thaci , Zëvendës Kryeministër i Parë dhe Ministër i Punëve të Jashtme Lutfi Zharku Ministër i Tregëtisë dhe Industrisë
Serbia	Aleksandar Vučić , Kryeministër Ivica Dačić , Zëvendës Kryeministër i Parë dhe Ministër i Punëve të Jashtme Dušan Vujović , Ministër i Financave	Aleksandar Vučić , Kryeministër Ivica Dačić , Zëvendës Kryeministër i Parë dhe Ministër i Punëve të Jashtme Dušan Vujović , Ministër i Financave
Bashkimi Evropian	Jose Manuel Barroso , President i Komisionit Evropian Günther Oettinger , Zëvendës President i Komisionit Evropian Stefan Fule , Komisioner për Zgjerimin	Federica Mogherini , Përfaqësuese e Lartë për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë Maros Sefcovic , Zëvendës President i Komisionit Evropian Johannes Hahn , Komisioner për Politikën e Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit
Austria	Werner Faymann , Kancelar Reinhold Mitterlehner , Zëvendës Kancelar dhe Ministër i Ekonomisë Sebastian Kurz , Ministër i Punëve të Jashtme	Werner Faymann , Kancelar Reinhold Mitterlehner , Zëvendës Kancelar dhe Ministër i Ekonomisë Sebastian Kurz , Ministër i Punëve të Jashtme

Kroacia	Zoran Milanovic , Kryeministër Vesna Pusic , Ministër i Punëve të Jashtme dhe Evropiane Ivan Vrdoljak , Ministër i Ekonomisë	Zoran Milanovic , Kryeministër Vesna Pusic , Ministër i Punëve të Jashtme dhe Evropiane Ivan Vrdoljak , Ministër i Ekonomisë
Franca	Alain Richard , I dërguar i posaçëm i Ministrit të Punëve të Jashtme për Diplomaci Ekonomike në Ballkan	Harlem Désir , Sekretar Shteti për Çështjet Evropiane Alain Richard , I dërguar i posaçëm i Ministrit të Punëve të Jashtme për Diplomaci Ekonomike në Ballkan
Gjermania	Angela Merkel , Kancelar Siegmar Gabriel , Zëvendës Kancelar dhe Ministër për Çështjet Ekonomike dhe Energjinë Frank-Walter Steinmeier , Ministër i Punëve të Jashtme	Angela Merkel , Kancelar Siegmar Gabriel , Zëvendës Kancelar dhe Ministër për Çështjet Ekonomike dhe Energjinë Frank-Walter Steinmeier , Ministër i Punëve të Jashtme
Italia		Paolo Gentiloni , Ministër i Punëve të Jashtme Amedeo Teti , Drejtor i Përgjithshëm pranë Ministrisë për Zhvillimin Ekonomik
Sllovenia	Alenka Bratušek , Kryeministër Karl Erjavec , Ministër i Punëve të Jashtme Metod Dragonja , Ministër i Zhvillimit Ekonomik dhe Teknologjisë	Miro Cerar , Kryeministër Karl Erjavec , Ministër i Punëve të Jashtme Zdravko Počivalšek , Ministër i Zhvillimit Ekonomik dhe Teknologjisë

Burimi: Përpunim i autorëve i bazuar në të dhëna të marra nga burime të medias online.



Bibliografia

Anastasakis, Othon & Vesna Dojicic-Dzelilovic, “*Balkans Regional cooperation and European Integration*”, London School of Economics and Political Science, Korrik 2002.

Bushati, Ditmir, Fjala e Ministrit të Punëve të Jashtme, *Procesverbal i Takimit të Dytë të Këshillit Kombëtar të Integritimit Evropian*, Tiranë, 21 korrik 2015, konsultoni: http://www.parlament.al/web/Procesverbal_date_21_07_2015_20825_1.php

Deklarata Finale e Kryetarit të Konferencës për Ballkanin Perëndimor, Berlin, 28.08.2014.

Deklarata Finale e Kryetarit të Samitit të Vjenës për Ballkanin Perëndimor, Vjenë, 27.08.2015.

Deklaratë e Përbashkët, “*Western Balkan 6 Ministerial – Economic Governance and Connectivity*”, Beograd, 23.10.2014.

Die Bundeskanzlerin, “*Klare EU-Perspektive für Balkanstaaten*”, 7.06.2014, konsultoni: http://www.bundeskanzlerin.de/Webs/BKin/DE/Mediathek/mediathek_node.html?cat=videos&id=875926

Forumi Rajonal i MARRI-t, *Deklarata e Shkupit*, Shkup, 10.06.2015, konsultoni: <http://www.marri-rc.org/upload/novi/201506./Skopje%20Declaration.pdf>

Holzner, Mario, Robert Stehrer & Hermine Vidovic, “*Infrastructure Investment in the Western Balkans*”, Vienna Institute for International Economic Studies (WIIW), Research Report, nr. 407, shtator 2015.

Invest in Albania, “*Ahmetaj call for Reduction of Bureaucracies in the Montenegro Conference*”, 25.09.2014, konsultoni: <http://invest-in-albania.org/albanian-minister-economy-calls-reduction-bureaucracies-economic-conference-montenegro/>

Jacobsen, H. D. “*The Stability Pact for South East Europe – Did it work?*”, Contribution to the Isodarco 15th Winter Course “South-Eastern Europe – Internal Dynamics and External Intervention”, Andalo, 20-27.01.2002, konsultoni: <http://www.isodarco.com/courses/andalo02/paper/andalo02-jacobsen.html>

Jordanova, Malinka Ristevska, “*Regional Cooperation in the Balkans 1996-2008 – from Imposed to Intrinsic*”, in FES (ed.), *Dialogues: Ownership for Regional Cooperation in the Western Balkan Countries*, qershor 2009.

Juncker, Jean-Claude, “*A New Start for Europe: My Agenda for Jobs, Growth, Fairness and Democratic Change*”, Political Guidelines for the next European Commission, Opening Statement in the European Parliament Plenary Session, Strasburg, 15.07.2015, konsultoni: http://ec.europa.eu/priorities/docs/pg_en.pdf

Keohane, Robert O., “*Multilateralism: An Agenda for Research*”, International Journal, vol. XLV, 1990.

Këshilli Kombëtar i Integritetit Evropian, *Procesverbal i Takimit të Dytë*, Tiranë, 21.07.2015, konsultoni: http://www.parlament.al/web/Procesverbale_20635_1.php

Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, *South East Europe 2020: Jobs and Prosperity in a European Perspective*, Nëntor 2013, konsultoni: <http://rcc.int/files/user/docs/reports/SEE2020-Strategy.pdf>

Komisioni Evropian, “*Connectivity Agenda for the Western Balkans*”, Press Release Database, SPEECH/15/4693, Prishtinë, 25.03.2015.

Komisioni Evropian, “*TEN-T Days 2015 in Riga: innovative investment in transport infrastructure projects for jobs and growth in Europe*”, Press Release Database, Press Release, IP/15/5232, Riga, 22.06.2015.

Komisioni Evropian, Commission Staff Working Document, *Albania 2015 Report*, SWD(2015) 213 final, Bruksel, 10.11.2015.

Komisioni Evropian, Communication from the Commission to the European Parliament and the Council, “*Enlargement Strategy and Main Challenges 2013-2014*”, COM(2013) 700 final, Bruksel, 16.10.2013.

Komisioni Evropian, Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, *EU Enlargement Strategy*, COM(2015) 611 final, Bruksel, 10.11.2015.

Komisioni Evropian, Communication from the Commission to the European Parliament and the Council, *Enlargement Strategy and Main Challenges 2013-2014*, COM(2013) 700 final, Bruksel, 16.10.2013.

Komisioni Evropian, *Enhanced cooperation within the Stabilization and Association Process*, Non-Paper, MEMO/14/481, Bruksel, 10.07.2014.

Komisioni Evropian, *Enlargement Strategy and Main Challenges 2014-2015*, COM(2014) 700 final, Bruksel, 8.10.2014.

Komisioni Evropian, *Western Balkans 6 Meeting in Brussels*, Brussels, Statement, Bruksel, 21.04.2015, konsultoni: http://europa.eu/rapid/press-release_STATEMENT-15-4826_en.htm

Komuniteti i Energjisë, “*Development and application of methodology to identify Projects of Energy Community Interest*”, Final Report, Vjenë, 26 shtator 2013, konsultoni: https://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/DOCS/2558181/0633975AD4927B9CE053C92FA8C06338

Komuniteti i Energjisë, Western Balkans 6 Ministerial “*Connecting Systems, Connecting Markets*”, Vienna, 2.07.2015, konsultoni: https://www.energy-community.org/portal/page/portal/ENC_HOME/DOCS/3768160/Final_statement_150630.pdf

Konferenca e Përbashkët për Shtyp e Kryeministrit Rama, Kancelares Merkel dhe Presidentit të Komisionit Evropian Barroso, Berlin, 28.08.2014, konsultoni: <http://www.kryeministria.al/en/newsroom/news/historic-moment-for-the-common-future-of-the-western-balkans>

Manu, Doris, “*EU Enlargement to the Balkans: The Berlin Process is moving Things Forward*”, European Western Balkans, Brussels, 23.11.2015, konsultoni: <http://europeanwesternbalkans.com/2015/11/23/eu-enlargement-to-the-balkans-the-berlin-process-is-moving-things-forward/>

Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Sllovenisë, *Meeting of Ministers of Foreign Affairs at Brdo*, Deklaratë e Përbashkët, Brdo, 23.04.2014, konsultoni: http://www.mzz.gov.si/fileadmin/pageuploads/foto/1504/joint_statement_Brdo_ministers.pdf

Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë, “*Minister Bushati attends Conference of SEE Foreign Ministers in Berlin*”, 25.11.2015, konsultoni: <http://www.punetegashtme.gov.al/en/press-office/news/minister-bushati-attends-conference-of-see-foreign-ministers-in-berlin&page=1>

Prodi, Romano, Fjalimi “A wider Europe – A proximity policy as the key to stability”, Bruksel, 5-6.12.2002, konsultoni: http://europa.eu/rapid/press-release_SPEECH-02-619_en.htm

South East European Cooperation Process, Albanian Chairmanship, *SEECF Tirana Summit Declaration*, Tiranë, 26.05.2015, konsultoni: http://www.punetegashtme.gov.al/files/userfiles/SEECF_Tirana_Summit_Declaration.pdf

Western Balkans Investment Framework, “*A new approach to financial support*”, 12.11.2010, konsultoni: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/western-balkans-conference/wbif-a4-def_en.pdf

Western Balkans Investment Framework, “*Practical Guidelines for WBIF Project Application and Submission*”, Janar 2014.


Western Balkans Investment Framework, Albania – the Former Yugoslav Republic of Macedonia Power Interconnection (II): Grid Section in the Former Yugoslav Republic of Macedonia, konsultoni: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/publication/2015/20150820_wbif_cf_1002_mkd_ene.pdf

Zyra e Presidentit të Republikës së Sllovenisë, *Konkluzionet e Samitit të Përvitshëm të Procesit të Brdo-Brijuni-t*, Budva, 8.06.2015.

Zyra e Presidentit të Republikës së Sllovenisë, *Slovenian President Pahor and Croatian President Josipović Host Leaders at Brdo Process in Dubrovnik*, Deklaratë për Shtyp, Dubrovnik, 15.07.2014, konsultoni: <http://www.up-rs.si/up-rs/uprs-eng.nsf/pages/86AC1F31BD4A4B2FC1257D3400433769?OpenDocument>

KONFERENCA
“SHQIPËRIA NË PROCESIN E BERLINIT:
VLERËSIME
DHE REKOMANDIME - VJESHTË 2015”
5 Nëntor 2015

Fjalimet dhe Kontributet



“Shoqëria Civile: Aktor politik në Ballkanin Perëndimor” - FRANK HANTKE, Drejtor i Fondacionit Friedrich Ebert, Zyra Tiranë

Fondacioni Friedrich Ebert (FES) mbështet organizatat e shoqërisë civile, për një pjesëmarrje më të madhe në politikëbërje në përgjithësi dhe si partner në Procesin e Berlinit në veçanti. FES ishte një nga organizatorët e Forumit të Shoqërisë Civile që u zhvillua në Vjenë, pjesë e Konferencës zyrtare për Ballkanin.

Shoqëria civile është një aktor politik

Shoqëria civile në Ballkan duhet të ndërgjegjësohet se, në një “demokraci të gjallë”, ajo është aktor politik - jo vetëm në mënyrë pasive, si votues, por edhe në mënyrë shumë aktive, si një këshilltar kritik i përditshëm, si një grup ekspertësh, ose si një risi për reformat dhe zhvillimet. Kjo nuk është vetëm një ofertë e demokracisë, por një nevojë dhe detyrë për të gjithë qytetarët. Për rrjedhojë, nevojiten organizata të shoqërisë civile, që fokusohen në interesa të ndryshme, për t’u dhënë një zë të fuqishëm. Ftesa e OSHC-ve si partnerë në Procesin e Berlinit ishte një tregues shumë i mirë progresi.

Organizatat e shoqërisë civile kanë nevojë për një zë të përbashkët dhe besiminin e qytetarëve

Nuk ka mungesë të sasisë së OSHC-ve në Ballkan, por ka ende mungesë të unitetit dhe gatishmërisë për të vepruar fuqishëm - në nivel kombëtar dhe rajonal. Gjithashtu, vërehet se shumë OSHC - pavarësisht se punojnë majft mirë - nuk kanë kontakte dhe marrëdhënie të mjaftueshme me qytetarët - sidomos në zonat rurale. Bashkimi dhe marrëdhënia e mirë me qytetarët është sfida e parë me të cilën duhet të përballen OSHC-të.

Në vendet e Ballkanit tashmë ka shumë shembuj të mirë të punës së OSHC-ve, por fatkeqësisht nuk njihen nga të tjerët. Një rrjet rajonal që funksionon mirë është i nevojshëm për të patur më shumë kompetenca dhe për t’u bërë më kreativ. Megjithatë, fuqia e OSHC-ve në rajon dhe ndikimi i tyre në politikën rajonale varet nga aftësia e tyre për të vepruar në nivel kombëtar.

Zhvillimi ekonomik dhe kohezioni social janë binjakë të natyrshëm

Objektivat kryesore të progresit të Ballkanit janë shumë të ngjashme midis shteteve. Ekonomia duhet të rritet, ndërsa kohezioni social duhet të jetë shtylla tjetër e fortë e një integrimi evropian të suksesshëm. Nuk ka udhërrëfyes nga asnjë shtet apo nga BE-ja. Vet Ballkani duhet të zhvillojë modelin e tij, si pjesë përbërëse e mozaikut të modeleve të ndryshme të mirëqenies sociale në Evropë. Por, çka duhet të marrim përsipër të gjithë është “Modeli Ekonomik dhe Social Evropian”.

Nuk do të ketë kohezioni social pa progres ekonomik – por, nuk do të ketë as përparim ekonomik pa zhvillim social në shumë fusha.

Arsimi dhe aftësimi profesional janë çështje kryesore

Arsimi dhe aftësimi profesional janë të një rëndësie të veçantë. Për të krijuar industri të reja, për të forcuar artizanatin apo për të fuqizuar bujqësinë, për zhvillimin apo administrimin e turizmit, nevojitet një fuqi punëtore e mirëkualifikuar - akademike dhe jo-akademike - në të gjitha nivelet dhe në të gjitha shtetet. Aftësimi profesional për të gjitha profesionet është kushti kryesor për krijimin e vende të reja të punës dhe për të çuar përpara ekonominë.

Bashkëpunimi është i nevojshëm për reformat

Politikanët mund dhe duhet të zhvillojnë kornizat përkatëse - por biznesi, sindikatat, organizatat e shoqërisë civile dhe vetë qytetarët janë motorri i vërtetë i suksesit ekonomik. Pa to, pa vullnetin dhe kompetencat e tyre, nuk do të ketë reformë të vërtetë, pavarësisht faktit se analizat dhe strategjitë bëhen gjithmonë e më të forta.

Krerët e Ballkanit dhe të BE-së ranë dakord mbi disa çështje shumë të rëndësishme në Vjenë. Programe të mëdha janë planifikuar dhe fjalë e numra edhe me të mëdhenj janë publikuar. Tani është në dorën e tyre t'i përkthejnë këto premtime në aktivitete reale dhe të dukshme, në bashkëpunim me ata që kanë për të bërë punën - qytetarët, biznesi, ekspertët dhe të tjerët. Ende shumë politikanë nuk e shohin "arin" në trurin e qytetarëve - dhe ende shumë qytetarë dhe organizatat përkatëse bëjnë sikur nuk janë të vetëdijshëm për këtë.

OSHC-të synojnë të bashkojnë qytetarë me interesa të ngjashme, të fokusojnë dëshirat dhe mundësitë e tyre, për t'u bërë një partner kompetent dhe i fortë për një Ballkan më të mirë. Ky është fakt: nuk do të ketë zgjidhje pozitive në fushat ekonomike apo sociale, pa bashkëpunim rajonal. Çdo vend në vetvete është shumë i vogël për të vepruar vetëm apo për t'u bërë një partner i respektuar në procesin e integritetit - i tërë rajoni mund të jetë ky partner i respektuar dhe i fortë, çka është e nevojshme për të mirën e qytetarëve të Ballkanit.

Probleme të ngjashme për të zgjidhur - një zë i përbashkët në rajon si premisë për sukses

Si vendet e Ballkanit dhe politikanët e tyre, ashtu dhe OSHC-të duhet të bashkëpunojnë në rajon si partnerë për zgjidhje të përbashkëta. Kjo konferencë ishte pjesë e disa aktiviteteve që duhet të zhvilloheshin për t'u bërë më të fuqishëm. Ide të reja u zhvilluan dhe aktivitete të tjera janë planifikuar. Kanë marrë pjesë partnerë të konsiderueshem të OSHC-ve nga vendet fqinje si dhe ekspertë nga i gjithë rajoni, çka duhet të vazhdojë të thellohet.

Për të theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes së OSHC-ve në politikëbërje, të gjitha fondacionet gjermane prezente mbështetën bashkarisht këtë konferencë. Nuk nevojitet spektri i majtë apo i djathtë në shoqërinë civile, por ideja e interesave dhe zërit të përbashkët të qytetarëve.



“Procesi i Berlinit: Hapi i ardhshëm në rrugën e integritetit të Ballkanit Perëndimor në BE” - KLAUS FIESINGER, Shef i Departmentit të Evropës Qëndrore, Lindore dhe Juglindore, Kaukazit dhe Azisë Qendrore, Fondacioni Hanns Seidel

Sërisht vendet e Ballkanit Perëndimor janë në qendër të vëmendjes dhe interesit ndërkombëtar.

Emigrantë nga varfëria apo refugjatë të luftës, të cilët janë duke udhëtuar nga vendet e tyre të origjinës drejt Evropës Qëndrore, duke përdorur të ashtuquajturin “Itinerari ballkanik”, po bëhen gjithmonë e më shumë problem për kapacitetin absorbues të Bashkimit Evropian. Akoma më i rëndësishëm është fakti që azilkërkuesit, që për arsye varfërie po lënë vendet e tyre në Evropën Juglindore – të konsideruara si “Vende të Sigurta të Origjinës” - përbëjnë ende pothuajse gjysmën e valës së emigrantëve.

Pavarësisht këtij “imazhi negativ” të rajonit të Ballkanit Perëndimor në lidhje me migrimin, duhet të merren në konsideratë aspektet pozitive të shteteve të Evropës Juglindore bazuar në progresin e tyre të dukshëm të demokratizimit dhe zhvillimit.

Prej më shumë se 10 vitesh, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë përfituar prej disa komponentëve integruar të të ashtuquajturës Strategjia e Para-Anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Në qershor 2003, në Samitin e BE-së të Selanikut, vendeve të Ballkanit Perëndimor iu premtua perspektiva e qartë e anëtarësimit në BE.

Ndërkohë, të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor kanë arritur anëtarësimin, si Kroacia, kanë marrë statusin e vendit kandidat, si për shembull Shqipëria, ose janë kandidatë potencial për në BE, si Bosnja dhe Hercegovina.

Për këtë arsye, “Procesi i Berlinit”, i filluar në vitin 2014, logjikisht mund të karakterizohet si një vazhdimësi konkrete e vendimeve të marra në Samitin e Selanikut të vitit 2003.

Idetë dhe synimet e ciklit të konferencave ndërkombëtare dhe platformës së negociatave të vazhdueshme, - të njohura si “Procesi i Berlinit”, i ndërmarrë dhe frymëzuar nga Kancelarja gjermane Angela Merkel - janë të qarta dhe të dukshme: zbatimi dhe konsolidimi i mëtejshëm i reformave institucionale, ekonomike dhe socio-politike në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Megjithatë, ekzistojnë ende dyshime dhe pasiguri mbi zbatimin dhe transpozimin konkret të kësaj qasjeje të rëndësishme.

Disa pyetje kërkojnë përgjigje të sakta:

Për shembull, si mund të transformohen qëllimet dhe objektivat e sipërpërmendura nga niveli makro në një nivel më të ulët menaxhuesm të projekteve të zhvillimit? Së fundi, pyetje që duhet të

marrin përgjigje: nesë çështjet e kërkuara dhe të nevojshme të Procesit të Berlinit janë në përputhje me IPA II dhe nëse janë pjesë e kuadrit të Strategjisë “Evropa 2020”? Me fjalë të tjera: A shkon afati i parashikuar përtej vitit 2018?

Qëllimi, synimi dhe përmbajtja e Konferencës së Tiranës “Shqipëria në Procesin e Berlinit” - e organizuar nga ShtetiWeb në bashkëpunim me zyrat e Fondacionit Friedrich Ebert, Fondacionit Hanns Seidel dhe Fondacionit Konrad Adenauer, në 5 nëntor 2015 - synuan t'i jepnin përgjigje specifike pyetjeve të sipër-përmendura, në mënyrë që të ofronin një informacion më të detajuar mbi Procesin të Berlinit.

Në Samitin e Ballkanit Perëndimor të mbajtur në Vjenë në gusht 2015, shoqëria civile u ul për herë të parë përkrah krerëve të WB6. Rrjedhimisht, rezultati inkurajues i këtij samiti për rrjetin e OSHC-ve ishte një mundësi për të vepruar si komponent aktiv i Procesit të Berlinit.

Këto fakte ndikuan vendimin e tre fondacioneve politike gjermane në Shqipëri për të nxitur Konferencën e sipër-përmendur të Tiranës dhe për të promovuar botimin e akteve, si një përmbledhje gjithëpërfshirëse dhe të strukturuar mbi këtë tematikë.

Element i rëndësishëm i aktiviteteve të fondacioneve politike gjermane në rajonin e Ballkanit Perëndimor është përparimi i procesit të anëtarësimit në BE, nëpërmjet mbështetjes së reformave të qëndrueshme demokratike.


Secili prej fondacioneve politike po realizon këtë qasje në bashkëpunim me institucionet partnere lokale përkatëse.

Fondacioni Hanns Seidel ka një zyrë përfaqësuese në Shqipëri që prej vitit 1992 dhe që nga ajo kohë është i angazhuar me projekte mbi reformat në administratë dhe në vetëqeverisjen vendore, sikurse dhe në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme. Fokusi i Fondacionit Hanns Seidel tek “shteti i së drejtës” dhe tek çështjet e “sigurisë së brendshme” i korrespondojnë kapitujve 23 dhe 24 të negociatave për anëtarësim në BE, me të cilat Shqipëria do të përballlet kur të fillojnë negociatat.

Fondacioni Hanns Seidel është duke zhvilluar këto aktivitete bashkëpunim të vazhdueshëm me organizatat joqeveritare partnere dhe me sektorin qeveritar. Institucionet tona partnere janë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë dhe Shoqata e Bashkive të Shqipërisë.

Pas nënshkrimit të Traktatit të Stabilizim-Asociimit mes Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në vitin 2009, u deshën pesë vite deri në dhënien e statusit të vendit kandidat në vitin 2014. Shqipëria u kualifikua në vjeshtën e 2015 nga Bundestagu gjerman si vend i sigurt i origjinës. Deri në hapjen e negociatave me BE-në, procesi i reformave në Shqipëri duhet të vazhdojë me përpjekje të pashtershme në të gjithë sektorët e shtetit dhe jetës publike.

Fondacioni Hanns Seidel do të vazhdojë të shoqërojë Shqipërinë në të ardhmen në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian, nëpërmjet asistencës së qëndrueshme në transformimin institucional dhe socio-politik të vendit dhe nëpërmjet kontributit operacional për bashkëpunimin ndërkufitar dhe ndërrajonal të Ballkanit Perëndimor – i frymëzuar dhe konfirmuar nga Procesi i Berlinit.



“Reformat e mëtejshme dhe bashkëpunimi i ngushtë ekonomik i vendeve të Ballkanit Perëndimor” - THOMAS SCHRAPEL, Drejtor i Fondacionit Konrad Adenauer, Zyra për Shqipërinë

Shkëlqesia Juaj z. Hoffmann, ambasador i Gjermanisë dhe Shkëlqesia Juaj z. Fitoussi, ambasador i Francës në Tiranë,

Shkëlqesitë tuaja - ambasadorë të Malit të Zi, Maqedonisë dhe Kosovës,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Ju uroj mirëseardhjen në Konferencën “Shqipëria në Procesin e Berlinit”.

Sikurse përmendën kolegët e mi, është kënaqësi e veçantë për mua t'i uroj mirëseardhjen pjesëtareve të shoqërisë civile, duke theksuar rolin e tyre në Procesin e Berlinit dhe në atë të integritetit evropian të rajonit.

Duke pasur parasysh agjendën tradicionale të konferencave, zakonisht politikanët flasin të parët. Por, sot kemi një rend të veçantë dite, madje kjo është pikërisht ideja e kësaj konference. Nuk e di nëse ka deputetë prezent, megjithatë në program ata janë të pranishëm dhe do të mbajnë disa fjalime në panelin e tretë.

Çështjet evropiane në përgjithësi dhe roli i institucioneve në procesin e zgjerimit të BE-së janë aspekte shumë të rëndësishme të aktiviteteve të Fondacionit tonë Konrad Adenauer (KAS).

Zyra e KAS-it për Shqipërinë ka mbështetur shumë veprimtari në kuadrin e integritetit evropian të Shqipërisë, me partnerë të ndryshëm, qofshin këta politikanë apo aktorë të shoqërisë civile. Ne kemi gjithashtu në fokus prioritetet specifike për brezat e rinj.

Mendoj se të gjithë mund të themi që ekziston një perspektivë e qartë evropiane e Shqipërisë. Shqipëria është një faktor stabilizues për të gjithë Evropën Juglindore. Kjo është edhe arsyeja se pse Kancelarja Merkel ndërmori nismën e Procesit të Berlinit.


Do të doja të theksoja rëndësinë që ka Procesi i Berlinit. Këtë rëndësi mund ta kuptoni në faktin që ai u krijua dhe u zhvillua në momentin kur disa vende anëtare të BE-së, sikurse vetë Gjermania, kërkuan zgjerimin e BE-së. Ky është një proces që ende nuk ka përfunduar.

Megjithatë, është shumë e rëndësishme që të analizohet situata reale e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Një analizë e mirë, që lejon sqarimin e roleve përkatëse të qeverisë, parlamentit apo grupeve të interesit, është shumë e rëndësishme gjatë procesit të anëtarësimit në BE.

Dje lexova në gazetë se Shqipëria dhe BE-ja do të hapin negociatat për anëtarësim në 2016 dhe kryeministri i vendit ka besim për këtë. Kur lexon artikullin duket sikur gjithçka është e sigurt dhe ky përbën një problem. Nëse negociatat për zgjerim do të fillonin vitin që vjen, duhet të punojmë më herët për to. Aktualisht kemi disa hapa të tjera të rëndësishme që duhet të ndërmarrim dhe këto hapa janë në Parlament - dhe sidomos në Parlamentin gjerman ku do të mbahet një proces votimi, i cili më pas kalon përmes qeverisë.

Shqipëria dhe vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të bashkërendojnë forcat për të çuar përpara procesin e reformave dhe të bashkëpunimit rajonal në të mirë të zhvillimit ekonomik dhe mirëqënies së qytetarëve.

Procesi i Berlinit krijoi një shtysë të re në rajon dhe vendet duhet të punojnë së bashku për të realizuar aspiratën kryesore: anëtarësimin në BE.



“Nga Konferenca e Berlinit tek Procesi i Berlinit: Një perspektivë gjermane” - HELLMUT HOFFMANN, Ambasador i Republikës Federale Gjermane në Shqipëri

Dëshiroj të përgëzoj të tre fondacionet politike gjermane për përkrahjen dhe paraqitjen e përbashkët në këtë Konferencë. Kjo nuk ndodh aq shpesh dhe ky është një tregues i qartë se Procesi i Berlinit është shumë i veçantë.

Gjithashtu, mirëpres iniciativën e z. Hackaj për të organizuar Konferencën e Ballkanit Perëndimor – “Procesi i Berlinit” si objekt shqyrtimi për qytetarët e interesuar. Nuk jam i sigurt, por besoj se nocioni “Procesi i Berlinit” erdhi nga Tirana – nuk e shpikëm “ne”. Nuk jam kundër kësaj terminologjie dhe besoj se ju duhet ta bëni pjesë të punës suaj dhe të përfshini në të sa më shumë qytetarë që është e mundur.

Erdha në Shqipëri pothuajse dy vjet më parë, në gusht 2013, dhe isha dëshmitar i procesit që prej fillimit të tij. Origjina e Procesit të Berlinit lidhet me përkujtimin e nisjes së Luftës së Parë Botërore në 1914.

Natyrisht, dikush mund të zgjidhte një ngjarje përkujtimore klasike, për shembull një event franko-gjerman, si në Verdun. Por, unë besoj se idea ishte për të bërë diçka me rëndësi të drejtpërdrejtë politike dhe me orientim operacional për të ardhmen. Prandaj, fokusi u vendos tek rajoni ku nisi Lufta e Parë Botërore, domethënë në Sarajevë, dhe ku tensionet dhe konfliktet vazhdojnë të paraqesin probleme serioze për vetë rajonin, si dhe për Evropën në tërësi. Në këtë mënyrë, duke u fokusuar tek kujtimi i luftës, Gjermania i dërgon një sinjal të qartë rajonit: *“Ne kujdesemi për Ballkanin Perëndimor!”*.

Natyrisht u ngrit pyetja se si do të realizohet kjo. Kam kënaqësinë të deklaroj se ka disa elementë pozitivë që karakterizojnë Procesin e Berlinit.

Së pari, kjo nuk është një konferencë e vetme, por një seri prej pesë konferencash gjatë periudhës 2014-2018. Do të kishte qënë shumë e lehtë të mblidheshin krerët e Ballkanit në Berlin në 2014, për të organizuar një event të vetëm. Seria prej pesë konferencash do të sigurojë vazhdimësinë e procesit dhe do të ketë kohë të mjaftueshme për të treguar rezultatet e tij.

Së dyti, ka partnerë të ndryshëm të përfshirë në proces, si gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor: Kroacia, Sllovenia, Gjermania, Franca, Austria dhe, që prej 2015, Italia, plus institucionet e BE-së dhe në veçanti institucionet financiare dhe Banka Botërore. Pjesëmarrësit në konferencat e Procesit të Berlinit janë përfaqësues të nivelit të lartë, si kryeministra, ministra të punëve të jashtme dhe ministra të ekonomisë.

Së treti, procesi nuk është vetëm produkt i fjalëve inkurajuese mbi ruajtjen e paqes dhe sigurisë, etj. Ai fokusohet tek projekte kryesore dhe të rëndësishme me kontribut operacional të vendeve të Ballkanit Perëndimor! Si diplomat, unë e di se sa e rëndësishme është përsëritja e fjalëve të duhura dhe është e rëndësishme që të thuhet fjalët e duhura në momentin e duhur. Kjo është e vërtetë gjithashtu për Ballkanin sepse veçanërisht këtu ndodh shpesh që njerëzit përdorin fjalët e gabuara.

Gjithashtu, do të theksoja përkushtimin shumë të rëndësishëm të BE-së për mbështetje financiare të projekteve dhe z. Jan Rudolph nga Delegacioni i BE-së me siguri do të shtjellojë këtë çështje. Kjo qasje është e rëndësishme sepse Konferenca e Ballkanit Perëndimor nuk ishte dhe nuk është e *vetmja* nismë rajonale! Ekzistojnë afërsisht 45 nisma/formate në Evropën Juglindore.

Për këtë arsye është e rëndësishme që procesi të fokusohet në aspekte të veçanta dhe këtu kemi dy fusha të mëdha projektesh me rëndësi të dukshme:

- Ndërtimi i shkëmbimeve rinore rajonale
- Agjenda e konektivitetit

Do të theksoja në veçanti përmirësimin e ndërlikimeve rrugore ndër-shtetërore. Shqipëria nuk ka ende një lidhje të pandërprerë me sistemin rrugor evropian.


Një efekt anësor shumë i mirë i Procesit të Berlinit është që vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të paraqiteshin me idetë e tyre dhe të koordinoheshin mes tyre. Si rezultat, takimet e shpeshta midis vendeve të Ballkanit Perëndimor ose në raport dypalësh përbëjnë një mundësi shumë të mirë.

Gjithsesi, kam përshtypjen se nëse në nivel politik gjërat shkojnë mirë, nivelet më të ulëta – si në atë teknik – po hasen probleme në plotësimin e dokumentacionit me detaje praktike. Për shembull, ende nuk është e qartë nëse Ministria e Transportit ka një ide të qartë apo plan se ku do të ndërtohet ekzaktësisht autostrada Adriatiko-Joniane në Shqipëri. Unë nuk jam i sigurt dhe dëgjohej pak në lidhje me këtë. Ministria duket se është duke pritur që ta përcaktojë konsulentët e BE-së.

Përsa i përket shkëmbimeve rinore, ka ende shumë për të bërë. Progresi praktik është ende shumë i ngadalshëm. Deri më tani ka vetëm deklarata të qëllimeve të mira dhe kjo nuk është thjeshtë punë në letër. Struktura duhet të ngrihet në mënyrë që të organizojë sa më shumë shkëmbime rinore.

Një pikë shumë e rëndësishme në Samitin e Vjenës të këtij viti ishte angazhimi me shkrim i krerëve të Ballkanit Perëndimor në zgjidhjen e çështjeve dypalëshe. Nevojiten hapa konkretë nga liderët politikë të rajonit drejt një pajtimi afatgjatë.

Si përfundim, do të ritheksoja rëndësinë e angazhimit të shoqërisë civile. Gjithashtu dhe media duhet të angazhohet dhe të ndjekë zbatimin e projekteve. Në përgjithësi, Prosesi i Berlinit ofron ura të mira lidhëse drejt rrugës së integritimit në BE.



“Samiti i Parisit: Piketa e ardhshme për bashkëpunimin rajonal” - BERNARD FITOUSSI, Ambasador i Francës në Shqipëri

Bashkimi Evropian promovon bashkëpunimin rajonal mes vendeve të Ballkanit Perëndimor që prej mesit të viteve 1990. Nën presidencën franceze, BE-ja nisi Procesin e Royaumont-it në 1995 me synimin e asocimit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në krijimin e një “Evrope të Re - një Evrope demokratike, në paqe, e bashkuar, me stabilitet dhe me fqinjësi të mirë”.

Nisja e luftës në Kosovë e nderpreu këtë nismë. Por dështimi nuk ishte pa pasoja. BE-ja nxori konkluzionin që thellimi i bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor kërkon një kuadër më të institucionalizuar, të pajisur me burime teknike dhe financiare, dhe mbi të gjitha me një ideal të përbashkët – atë të integritetit evropian.

Me këtë qëllim, BE-ja krijoi Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore në qershor 1999, i cili i la vendin në 2008 Këshillit për Bashkëpunim Rajonal. Në 2005, Këshilli Evropian konfirmoi këtë vijë drejtuese kur theksoi se “progresi i çdo vendi në rrugën e integritetit evropian [...] varet nga përpjekjet që ky vend bën në [...] kuadër të Procesit të Stabilizimit dhe Asociimit. Mes dimensioneve të këtij procesi, bashkëpunimi rajonal dhe fqinjësia e mirë janë elementët thelbësor të politikave të BE-së”. Këshilli ndoqi këtë deklaratë me veprime, duke e futur detyrimin e përforsimit të bashkëpunimit rajonal në gati të gjitha marrëveshjet e arritura me qeveritë e rajonit.

BE-ja mbështet zhvillimin e projekteve rajonale duke vënë në dispozicion të shteteve mjete teknike dhe financiare specifike (programet me shumë përfitues). Ajo shpërndan rreth 10% të ndihmës së saj të përgjithshme për para-aderimin për promovimin e bashkëpunimit rajonal. Në 2012, kjo shifër ishte baraz me 213 milion euro, përkundrajt 130 milionëve të 2007.

Bashkimi Evropian kuptohet që nuk është i vetmi që promovon bashkëpunimin rajonal në vendet e Ballkanit Perëndimor. Edhe Franca është e lidhur me Ballkanin Perëndimor nëpërmjet historisë, lidhjeve politike, lidhjeve kulturore, gjuhësore – ku frankofonia ka vendin e vet – dhe gjithashtu nëpërmjet lidhjeve ekonomike.

Shumë më herët, Presidenti i Republikës, z. François Hollande, i është përgjigjur pozitivisht ftesës së vendeve të Ballkanit në mbështetjen e përpjekjeve të tyre drejt integritetit evropian.

Takimet informale u transformuan në instrumenta bashkëpunimi. Institucionalizimi i dialogut do të bëhet përmes ndërtimit të kuadrit ku do të zhvillohen shkëmbime të qëndrueshme dhe një bashkëpunim i frytshëm mes vendeve të rajonit.

1. Konferenca e Brdos: Ndërmarrja e nismës rajonale të Ballkanit dhe mbështetja e Francës

Përpara Berlinit, ishte Brdoja vendi ku filluan diskutimet e para në lidhje me bashkëpunimin rajonal në Ballkan.

Kryetarët e Shteteve të tetë vendeve – Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, Slovenia dhe Shqipëria u mbledhën në një kuadër informal, me iniciativë të Presidentëve sloven dhe kroat, Borut Pahor dhe Ivo Josipovic, më 25 korrik 2013.

Presidenti francez, z. François Hollande, mori pjesë si i ftuar i nderit dhe përfaqësues i BE-së. Mes vendeve pjesëmarrëse, Sllovenia dhe Kroacia janë tashmë anëtare të BE-së, e para që prej 2004 dhe e dyta që prej 2013. Vendet e tjera janë duke përparuar në këtë proces. Mosmarrëveshjet mes Serbisë dhe Kosovës kanë marrë një peshë të veçantë, por prania e dy vendeve njëri pranë tjetrit në këtë samit tregon uljen e tensioneve mes tyre, që prej marrëveshjes së normalizimit të nënshkruar në prill 2013.

I ashtëquajtur i Proces i Brdos përfaqson një mundësi të madhe, veçanërisht për faktin se institucionalizon mbledhjet informale mes drejtuesve të rajonit, të cilët kanë si objektiv të përbashkët rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe pajtimin.

Perspektiva evropiane e Ballkanit dhe angazhimi i Francës


Gjatë Presidencës franceze, në 2000 në Zagreb, perspektiva evropiane u konsolidua përmes pohimit të vullnetit të të gjitha palëve. Sigurisht që procesi i anëtarësimit të përfundojë me sukses, duhet të plotësohen kushtet e nevojshme.

Kushti i parë që duhet të plotësojë çdo vend është zbatimi i reformave ekonomike, si çdo vend që dëshiron të anëtarësohet në BE. Pra duhet të zbatojë reformat politike, institucionale – reforma që kanë të bëjnë me shtetin e së drejtës.

Kushti i dytë që duhet të përmbushë i gjithë rajoni është pajtimi, pra bashkëpunimi rajonal. Ky proces tashmë ka filluar. Në qoftë se mosmarrëveshjet nuk sheshohen, në qoftë se stabiliteti nuk sigurohet, në qoftë se siguria nuk vendoset, nuk mund të ketë integrim në Evropë. Evropa mund të ndihmojë, Evropa mund të të shoqërojë në rrugën tënde, por Evropa nuk mund të zëvendësojë rolin që duhet të luajnë vet shtetet e Ballkanit.

Pse Franca mbështet këtë perspektivë evropiane? Pasi të ndërtosh Evropën, pasi të kemi pranuar që Evropa shtrihet në të gjithë kontinentin, nuk mund të lëmë jashtë Ballkanin, sepse është si të privosh Evropën prej një pjese të saj. Nuk do të ketë Evropë në paqe, Evropë të pajtimit, në qoftë se ne nuk përfshijmë në të dhe Ballkanin.

Por ka shumë përpjekje për të bërë: Sllovenia dhe Kroacia e ilustronjë më së miri. Në këtë rrugëtim Franca do të jetë pranë këtyre vendeve, përmes rolit të saj në Këshillin Evropian, për të theksuar rëndësinë e këtij procesi, të kësaj perspektive dhe për të ndihmuar, nëpërmjet ndërmjetësimit, pajtimin kaq të domosdoshëm në Ballkan.



2. Berlin (2014) dhe Vjenë (2015), një konfirmim i rajonalizimit drejt Samitit të Parisit

Siç u tha dhe nga homologu im gjerman dhe ai i BE-së, Samitet e Berlinit dhe të Vjenës kanë ndjekur dhe thelluar procesin e nisur në Brdo.

Këto samite kanë konsoliduar lidhjet mes vendeve dhe kanë ndihmuar në ngritjen e një shoqërie civile të gatshme për t'u angazhuar në një perspektivë afatgjatë për pajtim dhe bashkëpunim rajonal.

Vjena ka mundësuar një pjesëmarrje më domethënëse të shoqërisë civile. Aty po ashtu është propozuar një kuadër origjinal, që lejon kërkuesit e ndryshëm të punojnë mbi propozime që mundësojnë zgjidhjen e konflikteve rajonale.

Së fundmi, janë aprovuar projekte të shumta që lidhin territoret përmes infrastrukturës - 10 projekte me interes rajonal në transport dhe energji do të bashkë-financohen nga BE-ja.

Cdo të ndodhë në Paris?

Z. Alain Richard, i Ngarkuari me Punë për organizimin e Samitit të Parisit në 2016, do të jetë të hënën e ardhshme në Tiranë për të biseduar me palën shqiptare. Javën që vjen do kemi më shumë informacion.

Që nga Konferenca e Vjenës, tre akse kryesore janë përcaktuar si prioritare për Samitin e Parisit:

- Ekonomia – implikimi i sektorit privat në rritjen e investimeve në rajon;
- Rinia – prezantimi zyrtar i Zyrës për Bashkëpunimin Rinor Rajonal. Prioritet në 2016 do të jetë pa dyshim krijimi i strukturës operacionale sipas Deklaratës së Vjenës;
- Ndërlidhja – zbatimi i projekteve të filluara, identifikimi i projekteve të reja dhe financimi i tyre së bashku me institucionet financiare.

3. Fokusi mbi rininë: një prioritet i samitit të Parisit në shembullin e pajtimit franko-gjerman

Gjatë Samitit të Vjenës, në 27 gusht 2015, Kryeministrat e Shqipërisë, Bosnjes dhe Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë nënshkruan një deklaratë të përbashkët mbi themelimin e Zyrës për Bashkëpunimin Rinor Rajonal në Ballkanin Perëndimor. Në këtë deklaratë, Zyra Franko-Gjermane përmendet si origjina e kësaj inisiative.


Në 1962, në Ludwigsburg, Gjenerali De Gaulle i tha rinisë gjermane “Ihr seid kinder eines großen Volkes” (ju jeni fëmijët e një populli të madh). Ky mesazh theksonte besimin të rinia, tek mundësitë që ajo ka për të tejkaluar grindjet e së shkuarës dhe për të përqaftuar progresin.

Kështu në 1963, Traktati i Elizesë krijoi Zyrën Franko-Gjermane për Rininë (OFAJ), një organizatë ndërkombëtare në shërbim të bashkëpunimit franko-gjerman. Kjo zyrë ka si mision inkurajimin e marrëdhënieve midis të rinjve të të dy vendeve, të ndihmojë mirëkuptimin mes tyre dhe përmes saj të zhvillojë imazhin e vendit fqinj. Disa nga shifrat kryesore të punës së kësaj zyre janë: që nga 1963 instrumenti me perfekt i Traktatit të Elizesë ka mundësuar 8.2 milion të rinj francez dhe

gjermanë të marrin pjesë në 300.000 programe shkëmbimi. Zyra ka mbështetur mesatarisht 9.000 shkëmbime ku kanë përfituar 200.000 të rinj. Këto programe janë të hapura dhe për të rinjtë e vendeve të tjera. OFAJ përdor parimin e subsidiaritetit dhe ka rreth 6.000 organizata partnere. Ajo luan një rol këshillimor dhe ndërmjetësues për pushtetin vendor, si dhe për shoqërinë civile në Francë dhe Gjermani, në lidhje me programet e shkëmbimit rinor.

Ky program shkëmbimesh i drejtohet të gjithë qytetarëve nga tre deri në tridhjetë vjeç. Mund të përfitojnë fëmijët e kopshteve, ata të shkollës fillore, nëntëvjeçare ose të shkollës së mesme, praktikantë, studentë, të rinj të papunë dhe gjithashtu të punësuar. OFAJ kontribuon në ndërtimin e miqësisë franko-gjermane dhe është një nga sukseset më domethënëse të Traktatit të Elizesë.

Ky instrument ka dëshmuar rolin e shkëmbimeve rinore në procesin e pajtimit franko-gjerman. Duke ftuar rininë në procesin e rajonalizimit, vendet e Ballkanit investojnë për të ardhmen e tyre.



“Plotësim apo devijim: Si ndikon ndërlidhja tek dinamikat e integritit në BE të Ballkanit Perëndimor?” - JAN RUDOLPH, Shef i Seksionit Politik, Ekonomik dhe Informacionit, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri

Rajoni i Ballkanit Perëndimor ka bërë një rrugë të gjatë, gjatë 20 viteve të fundit. Ai ka lënë pas vitet e luftës dhe tani është duke lëvizur drejt të ardhmes në Bashkimin Evropian. Megjithatë, kjo paqe dhe ky stabilitet nuk duhet të merren si të mirëqenë.

Procesi i Berlinit dhe nisma “Ballkani Perëndimor 6” janë një mënyrë për të nxitur më tej procesin e integritit në BE dhe për të rikonfirmuar angazhimin tonë për perspektivën në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Konektiviteti – ndërlidhje më të mira fizike midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe me BE-në – është një aspekt i rëndësishëm i këtij procesi.

Investimet në infrastrukturë do të sjellin përfitime konkrete për qytetarët e vendeve në zgjerim, në aspektin e vendeve të punës dhe mundësive për biznes para anëtarësimit në BE, si dhe rritjen emundësive për investitorët e BE-së.

Por Procesi i Berlinit shkon përtej ekonomisë dhe infrastrukturës. Ai ka bashkuar krerët e Ballkanit Perëndimor në një tavolinë për të punuar për një qëllimi të përbashkët.

Krijimi i Komunitetit të Qymyrit dhe Çelikut, për të arritur përfitime ekonomike të përbashkëta, por edhe për të promovuar paqen dhe stabilitetin në Evropë, është arsyeja pse ulem sot këtu së bashku me ambasadorët francez dhe gjerman.

Procesi i Berlinit ka të bëjë me dhënien e mundësive qytetarëve për të bashkëpunuar dhe komunikuar përtej kufijve. Për këtë qëllim, do të doja të theksoja angazhimet e rëndësishme të bëra për të nxitur shkëmbimet rinore midis Ballkanit Perëndimor dhe me Evropën.

Një tjetër shtyllë e rëndësishme e procesit është Konferenca e Përbashkët Shkencore, e cila sjell kontributin kryesor të zërit të shkencës në këtë proces.

Liderët tuaj kanë bërë premtime të rëndësishme në kuadër të Procesit të Berlinit. Tani është koha që këto premtime të kthehen në vepra.

Në gusht të këtij viti, në Samitin e Ballkanit Perëndimor në Vjenë, kryeministrat nga rajoni dhe nga vendet anëtare të BE-së ranë dakort mbi prioritetet për zhvillime të mëtejshme infrastrukturore.

Ata u angazhuan të përfundonin prioritetet më urgjente në fushën e transportit dhe energjisë, duke përfshirë:

- Një rrjet bazë për transportin rajonal,
- Tre korridore transporti të BE-së të shtrira në Ballkanin Perëndimor, dhe
- Integrimin e sistemit të energjisë dhe furnizimit më të mirë me gaz.

Për të arritur përfitimin maksimal nga këto investime infrastrukturore, ato duhet të plotësohen me “**masa të buta**”, si p.sh. me hapjen e tregjeve dhe lehtësimin e procedurave për kalimin e kufirit. Fokusimi në këto “masa të buta” do të jetë një sfidë kyçe.

Për të çuar përpara procesin, Shqipëria dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor tani duhet të prezantojnë **propozime konkrete projektesh që janë gati për t’u zbatuar**.

Vendet tuaja janë tashmë në sediljen e shoferit kur bëhet fjalë për hartim projekt propozimesh, të cilat përfshijnë aspektet teknike dhe lënë mënjanë burimet financiare përkatëse. Ky është procesi juaj ndaj duhet të merrni autorësinë.

Për Shqipërinë, në mënyrë që të jetë në gjendje për të alokuar burimet e nevojshme për investim, është shumë i rëndësishëm përmirësimi i menaxhimit financiar publik. Gjithashtu, do të kërkojnë **rezultate në luftën kundër korrupsionit**, dhe siguri që paratë që i përkasin qytetarëve shqiptarë të shkojnë për infrastrukturën ose shërbimet publike dhe jo për interesa private.

Shoqëria civile ka për të luajtur një rol të rëndësishëm në të gjithë këto aspekte. Kjo u theksua edhe në Vjenë gjatë Forumit të Shoqërisë Civile, në të cilin, ndoshta, disa nga ju sot këtu morën pjesë.

- Shoqëria civile mund të monitorojë dhe t’i mbajë autoritetet përgjegjëse për realizimin e asaj çka kanë premtuar.
- Ajo mund të japë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e bashkëpunimit rajonal – duke forcuar mirëkuptimin e përbashkët, duke kontribuar për politikën dhe strategjitë, duke ndihmuar në përmirësimin e mjedisit insitucional dhe ligjor për shoqërinë civile në rajon.
- Së fundmi, ekspertiza e saj mund të jetë e vlefshme edhe në fushat e infrastrukturës dhe energjisë.


Bashkimi Evropian ka shpërndarë 1 miliard euro për projekte investimesh në ndërlidhje dhe asistencë teknike për periudhën 2014-2020. Në 2015 ofruam 200 milionë për bashkë-financim të 10 projekteve prioritare, përfshirë dy ura, tre hekurudha dhe interkonjeksione të energjisë.

Përmes projekt-propozimeve të projekteve realiste dhe të mirë-planifikuara, këto fonde mund të zhblokohen.

BE është gjithashtu gati të ofrojë mbështetje gjatë fazës së zbatimit:

- Ne po planifikojmë të krijojmë një mekanizëm monitorimi, që do të ndihmojë në gjurmimin e progresit të çdo shteti në realizimin e premtimeve të bëra në Vjenë.
- Gjithashtu, vendet do të mbështeten nga Koordinatorët Evropianë në përgatitjen e planeve të punës për korridoret e transportit dhe zbatimin e tyre.

Angazhimi në drejtim të zbatimit të këtyre prioritetëve nga krerët së bashku me qytetarët e tyre do ta kthejë Ballkanin Perëndimor në një rajon më të fuqishëm dhe më të pasur, i cili, për rrjedhojë, do të jetë pjesë e BE-së.



***“Përfitime të prekshme për vendin/qytetarët:
Projektet e konektivitetit” - NAND SHANI, Menaxher Programi,
Shkolla Rajonale e Administratës Publike***

Zgjerimi i BE-së: situata aktuale

Procesi i anëtarësimit në BE është nxitësi kryesor për reforma në vendet e Ballkanit Perëndimor. Agjenda e anëtarësimit i inkurajon vendet që të adresojnë reformat kryesore në shtetin e së drejtës, reformën në administratën publike dhe qeverisjen ekonomike.

Fuqizimi i shtetit të së drejtës është një sfidë e madhe për shumicën e shteteve dhe nevojiten përpjekje shtesë për të përmirësuar efektivitetin dhe efikasitetin e administratave publike të vendeve të zgjerimit.

Asnjë nga vendet e Ballkanit Perëndimor nuk konsiderohet ende një ekonomi tregu funksionale. Normat e larta të papunësisë, rritja dhe investimet e ulëta, si dhe dobësitë fiskale janë sfida të rëndësishme. Qeverisja më e mirë ekonomike shihet si një instrument i rëndësishëm për tejkalimin e këtyre sfidave. Si përgjigje ndaj krizës ekonomike globale, BE-ja ka forcuar ndjeshëm qeverisjen e saj ekonomike dhe vendet anëtare koordinojnë politikat fiskale dhe strukturore përpara se parlamentet kombëtare të miratojnë buxhetet vjetore përkatëse. Një qasje e ngjashme po propozohet edhe për vendet e zgjerimit. Ato janë të ftuar të përgatisin Programet Kombëtare të Reformës Ekonomike (NERP), të cilët do të përcaktojnë kuadrin makroekonomik dhe politikën fiskale afatmesme, si dhe një propozim mbi reformat strukturore sektoriale (si p.sh. transporti, energjia, arsimi, mjedisi, kërkimi, industria, konkurenca, tregu i përbashkët).

Disa nga prioritetet e NERP-it shqiptar për 2015 përfshijnë rforcimin e financave publike, përmirësimin e efikasitetit të sektorit financiar, heqjen e pengesave në tregjet e produkteve dhe përditësimin e sistemit arsimor, në harmonizim më të mirë me nevojat e sektorit privat.

Roli i bashkëpunimit rajonal

Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë janë një parakusht për anëtarësimin në BE. Kohët e fundit ka patur një spostim shumë të mirëpritur nga paqja dhe stabiliteti drejt bashkëpunim për zhvillim dhe rritje ekonomike. Nën kujdesin e Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, ministrat e ekonomisë së vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe qeveritë e tyre kanë miratuar strategjinë SEE 2020. Mbështetur në kuadrin e mirëqeverisjes, ata janë zotuar të punojnë së bashku për të arritur qëllimet themelore të rritjes së integruar, të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Kjo strategji thekson nevojën për një agjendë reformash gjithëpërfshirëse për të arritur një rritje ekonomike dhe konkurrueshmëri më të lartë.

Procesi i Berlinit dhe nisma “Ballkani Perëndimor 6”

Nisma “Ballkani Perëndimor 6” (WB6) krijon një kuadër të ri për bashkëpunimin mes gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Pas dy ministerialeve të WB6, në Beograd më 23 tetor 2014 dhe në Prishtinë më 25 Mars 2015, kryeministrat e Ballkanit Perëndimor u mbledhën në Bruksel më 21 Prill 2015 për të konfirmuar zotimin e tyre mbi konektivitetin, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, bashkëpunimin rajonal dhe integrimin evropian. Rrjetet ndërkufitare të transportit, energjisë dhe komunikimit janë të pazhvilluara dhe investime të tilla infrastrukturore nevojiten për të nxitur zhvillimin ekonomik të rajonit. Ata ranë dakord mbi rrjetin bazë të transportit për Ballkanin Perëndimor, krijimin e këshillave kombëtare të investimeve dhe themelimin e listës së vetme të projekteve prioritare strategjike për investimet prioritare.

Plani i zgjatimit të Rrjetit të Transportit Trans-Evropian në Shqipëri

Korridori i VIII	Tiranë/Durrës (Shqipëri) – Elbasan (Shqipëri) - Strugë (Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë) – Tetovë (Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë) - Shkup (Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë) – DeveBair (kufiri bullgar)
Itinerari 2	Podgoricë (Mal i Zi) – Durrës (Shqipëri) – Fier (Shqipëri) – Tepelenë (Shqipëri) – Qafë Botë (kufiri grek)
Aeroporti	Aeroporti i Tiranës
Porti Detar	Porti detar i Durrësit

Një vit pas Samitit të Ballkanit Perëndimor, takimi i dytë i Procesit të Berlinit u zhvillua në Vjenë më 27 Gusht 2015. Infrastruktura dhe ndërlidhja, bashkëpunimi rajonal, rinia, sfida e refugjatëve dhe përfshirja e shoqërisë civile dominuan në agjendën.

Ndikimi në terren

Përmes IPA II, BE-ja do të mundësojë 11.7 miliardë euro për periudhën 2014-2020 për të mbështetur vendet e zgjerimit. IPA II rrit fokusin mbi prioritetet e anëtarësimit në BE në fushat e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, si dhe të konkurrenshëmërisë dhe rritjes. Risitë e IPA II janë prezantimi e një qasjeje sektoriale, iniciativat për mbështetje në bazë të rezultateve, rritje të mbështetjes buxhetore dhe prioritizim të projekteve. Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor (WBIF) është një instrument i rëndësishëm për mbështetjen e investimeve infrastrukturore, që pritet të krijojë punësim dhe rritje, së bashku me promovimin e ndërlidhjes në rajon.

Nën WBIF, Komisioni Evropian, donatorët dypalësh dhe institucionet ndërkombëtare financiare po mbështesin investime me vlerën e 4 miliardë eurove në transport, energji, mjedis, ndryshimet klimatike, mbështetje të ekonomisë me burime efikase, sektorin social dhe atë privat. Vendet kanë ngritur këshillat kombëtare të investimeve, të cilët do të udhëheqin procesin drejt listës së vetme të projekteve prioritare strategjike.

Megjithatë, një qasje koherente dhe mekanizma planifikimi të qëndrueshëm janë të nevojshëm për të siguruar identifikimin dhe prioritizimin e investimeve, veçanërisht për vendet si Shqipëria, ku hapësira fiskale është relativisht e limituar. Ngritja e listës së vetme të projekteve prioritare strategjike është një instrument i rëndësishëm, i cili kërkon përshtatje institucionale dhe procedurale. Themelimi i Komiteti Kombëtar për Investime mbështetet në punën e grupeve sektoriale të punës dhe duhet të zhvillojë metodologji të qarta për prioritizimin e projekteve të infrastrukturës, të cilët do të forcojnë pronësinë, transparencën dhe udhëzimet për aktivitetet e grupeve sektoriale të punës.

Rëndësia për shtetin / qytetarët

Ka dëshmi të mjaftueshme, që tregon se të ardhurat nga investimi në telekomunikacion, transport dhe infrastrukturë energjitike i tejkalojnë ato të formave të tjera të investimeve kapitale. Përmirësimi i infrastrukturës dhe ndërlidhjes mund të nxisë investimet më të mëdha; mund të bëjë më të shpejtë, më të lirë dhe më të lehtë lëvizjen ndërkufitare të qytetarëve dhe mallrave në rajon; të rrisë konkurrueshmërinë nëpërmjet sistemeve më të fortë të prodhimit rajonal dhe ekonomive të shkallës; të përmirësojë ndërlidhjen me qendrat ekonomike dhe të krijojë mundësi ekonomike për qytetarët me të ardhura të ulëta; dhe të zgjerojë aksesin tek shërbimet bazë si energjia dhe uji.

Megjithatë, infrastruktura e rëndë dhe e lehtë ndërveprojnë dhe përforcojnë ndikimin e ndërsjellë. Infrastruktura e rëndë duhet të plotësohet me shërbimet përkatëse të transportit, procedurat doganore dhe standartet e harmonizuara, siç janë kornizat rregulluese dhe ligjore.

Për të maksimizuar ndikimin në rritjen e ndërlidhjes, duhet të miratohen politika plotësuese. Për shembull, lehtësimi i lëvizjes së fuqisë punëtore në rajon do të ndihmonte në përputhjen e aftësive përkatëse me vendet e punës.

Pavarësisht përfitimeve të qarta nga përmirësimi i infrastrukturës dhe ndërlidhjes, një pjesë e popullsisë dhe aktiviteteve do të dëmtohen nga efektet e përmirësimit të ndërlidhjes dhe të kostove të reduktuara të tregtisë. Shqetësimet mjedisore dhe eksternalitete të tjera negative duhet të adresohen nëpërmjet politikave dhe institucioneve përkatëse.

Duke pasur parasysh burimet e kufizuara financiare dhe nevojës së madhe për investime në rajon, priorizimi i qartë në agjendën e qeverisë, shoqëruar me mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar, kthehet në faktor thelbësor suksesi. Duhet të mbahen konsultime cilësore me sektorin privat në mënyrë që të identifikohen më mirë pengesat ndaj integritetit rajonal, të punohet së bashku mbi rritjen e konkurrencës dhe të eksplorohej partneritete në realizimin e investimeve.

“Konteksti institucional, instrumentat financiarë dhe mekanizmat: Parakushtet për një proces kombëtar efikas” - ARDIAN HACKAJ,
Drejtor i ShtetiWeb

Desha të filloj me një përshkrim të shkurtër të **aktorëve kryesore në Procesin e Berlinit**.

Siç e tha dhe Ambasadori Hoffmann, ky proces zhvillohet në nivel politik shumë të lartë. Strukturat ndërkombëtare janë Mbledhjet e Kryetarëve të Qeverive. Mbledhjet ministeriale nga Konferenca e Berlinit e deri tani janë shtatë, pa llogaritur faktin që ministrat janë takuar edhe në Vjenë e Berlin. Siç e përmendi edhe Ambasadori Fitoussi, për momentin takohen kryesisht ministrat e jashtëm, ministrat e ekonomisë dhe ministrat e energjisë. Këta vijnë nga gjashtë vendet anëtare të BE-së – Gjermani, Francë, Austri, Itali, Slloveni dhe Kroacia. U bashkohen përfaqësues nga Komisioni i Bashkimit Evropian si dhe Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, kryesisht për temat që mbulohen nga Strategjia SEE 2020, si dhe për mobilitetin, rritjen ekonomike dhe formimin profesional. Është zyrtarizuar dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile. Në këtë kuadër, shoqëria civile ka dhënë me të vertetë një kontribut strategjik në Samitin e Vjenës, dhe është afirmuar si një aktor pa të cilin do të ishte e vështirë të ecej përpara, çka duhet marrë parasysh edhe për Samitin e Parisit.

Shumë interesant është fakti që Shqipëria që mbart “atësinë” e termit “Procesi i Berlinit”, siç e përmendi edhe Ambasadori Hoffmann. Po nga Shqipëria përpara dhjetë ditëve, me iniciativë të deputetes znj. Majlinda Bregu, ka ardhur propozimi inovativ, që edhe deputetët e vendeve të Ballkanit Perëndimor të organizohen në mënyrë që edhe ata të bëhen pjesë aktive në Procesin e Berlinit.

Përsa i përket **aktorëve vendorë**, në Shqipëri aktori kryesor është Komiteti Kombëtar i Investimeve, që është struktura më e rëndësishme e cila merret me aprovimin final të listës së projekteve që do të financohen në kuadrin e Procesit të Berlinit. Në vendin tonë kjo strukturë është krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave më 20 prill 2015. Për të kuptuar rëndësinë që ka ky proces, mjafton të përmendet fakti që ky Komitet drejtohet vet nga Kryeministri, z. Rama.

Në nivel sektorësh dallojmë Grupet Sektoriale të Menaxhimit Strategjik. Për momentin janë katër, për transportin, energjinë, mjedisin dhe çështjet sociale, të cilët janë themeluar gjatë periudhës korrik-gusht 2015. Një nga rezultatet kryesore të këtyre grupeve janë përgatitja e 112 Fishave të Identifikimit të Projekteve. Në fazën e parë këto projekte janë rradhitur për secilin sektor, për të mundësuar identifikimin e produkteve prioritare. Këto projekte janë vlerësuar dhe janë renditur sipas kriterëve për të cilat do të flasim më vonë.

Një strukturë shumë e rëndësishme është ekipi i asistencës teknike ndaj Komitetit Kombëtar të Investimeve, që përbëhet nga Departamenti i Planifikimit Strategjik dhe i Koordinimit të Donatorëve. Është kjo strukturë që vlerëson projektet që vijnë nga ministrat dhe i rendit sipas rëndësisë së tyre strategjike. Domethënë, në kontekstin institucional, në rang kryeministri kemi Komitetin e Investimeve Strategjike, dhe në rang ministrish janë Grupet Sektoriale të Menaxhimit Strategjik.

Një komponent strategjik janë **institucionet financiare**. Është së pari Komisioni Evropian, që me anë të instrumentit IPA, jep ndihmën dërrmuese financiare – shifra prej 1 miliard euro u përmend nga Përfaqësuesi i BE-së, për gjashtë vitet e ardhshme për vendet e Ballkanit, gjë që është shumë e rëndësishme. Janë pastaj institucionet financiare ndërkombëtare si Banka Zhvillimore e Këshillit të Evropës; Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim; Banka Europiane e Investimeve, etj. dhe mbi të gjitha grupi i katër institucioneve financiare të Bankës Botërore. Mbi të gjitha, ajo që është shumë e rëndësishme dhe aktive për momentin për një projekt në Shqipëri është KfW – Banka Gjermane e Zhvillimit. Po ashtu shumë të rëndësishëm janë dhe donatorët bilateralë dhe institucione të tjera financiare, ku mund të përmendim dhe privatët.

Desha ta vazhdoj me kontekstin institucional të të gjithë këtyre aktorëve që merren me financimin, dhe me strukturat ndihmëse. E përmendi z. Shani, me kryesorja është Struktura e Investimeve të Ballkanit Perëndimor – Western Balkans Investment Framework – e cila mund të përshkruhet si një mekanizëm që kombinon grantet edhe kreditë sipas nevojave dhe kërkesave. Gjithashtu, WBIF ndihmon vendet e Ballkanit Perëndimor për të përgatitur projekte sa më të prezantueshme pranë institucioneve financiare. Në kuadrin e Procesit të Berlinit këto projekte duhet të respektojnë dhe të marrin parasysh agjendën e konektivitetit të BE-së dhe nismat respektive. Po përmend vetëm dy nga 46 iniciativat, por që janë shumë të rëndësishme për agjendën e konektivitetit: Observatori i Transportit për Europën Juglindore dhe Projektet e Komunitetit të Interesit për Energjinë, përkatësisht SEETO dhe PIKE. Të dy këto nisma orientojnë strukturat kombëtare drejt projekteve për të cilat Bashkimi Evropian ka interes strategjik. Projektet që janë pjesë e agjendës së konektivitetit dhe që janë në kuadër të Procesit të Berlinit duhet të jenë pjesë e planeve më të gjera evropiane për ndërtimin e infrastrukturës rrugore dhe në këtë rast dhe të energjisë. Kjo është një gjë shumë e rëndësishme, sepse për herë të parë po sinkronizohet, po ndërlidhet që në planifikim, ndërtimi i infrastrukturës së vendeve të Ballkanit Perëndimor me vendet e Bashkimit Evropian. Në këtë këndvështrim, Ballkani Perëndimor konsiderohet jo vetëm si një zonë ku vazhdohet të investohet vetëm në sundimin e ligjit, por edhe që merr pjesë – pak a shumë – në ndërtimin e politikave zhvillimore të BE-së ex-ante dhe jo ex-post.

Përsa i përket **instrumentave financiarë**, WBIF ofron grante dhe kredi. Grantet janë kryesisht për asistencë teknike, për përgatitjen e dokumentave teknike për investimet e infrastrukturës, për hulumtime dhe analiza mbi investimet dhe për të mbështetur reformat politike dhe ndërtimin e institucioneve. Kurse kreditë – dhe kjo është shumë shumë e rëndësishme, prapë i referohem paraardhësit tim z. Shani – përdoren për investime në infrastrukturë. Domethënë, në qoftë se një segment rrugor kushton 100 milion euro, nga këto 5% mund të mbulohet me grant, ndërsa pjesa tjetër duhet të mbulohet me kredi ose me fonde të vendeve përfituese.

Tani kalojmë tek pjesa që është pak e komplikuar, por besoj që do të arrijmë që ta shpjegojmë në detajet e mjaftueshme, pikërisht në mekanikën e përgatitjes dhe identifikimit të një projekti “të Berlinit”. Ajo çka dua të theksoj – edhe këtu po i referohem Ambasadorit Hoffmann, Ambasadorit Fitoussi, z. Rudolph – është që Procesi i Berlinit është një nismë, që është pronë e autoriteteve kombëtare. Domethënë projektet duhet t'i përgatisim ne, duhet t'i përgatisin autoritetet shqiptare. Bashkimi Evropian, vendet anëtare të BE-së na ndihmojnë për t'i përgatitur më mirë, por projektet janë tonat. Duhet t'u përgjigjen nevojave tona dhe në mënyrë sa më cilësore. Dinamika e mëposhtme shpjegon pak a shumë këtë koncept:

Hapi i parë është themelimi i grupeve sektoriale të menaxhimit strategjik. Sic e thashë, janë grupe që veprojnë në nivel sektori dhe jo në nivel ministrie dhe për momentin janë krijuar katër prej tyre: në transport, në energji, në mjedis dhe në çështje sociale.

Hapi i dytë është ndërtimi i kriterëve që nënvizojnë rëndësinë strategjike, si dhe i fishave të identifikimit të projekteve. Kjo ka të bëjë më tepër me metodologjinë. Është përgatitur me asistencën teknike të WBIF, por në konsultim të përhershëm me partneret shqiptare, si dhe është adoptuar nga ministritë e interesuara.


Në *hapiin e tretë*, këto grupe që janë krijuar, që kanë marrë edhe metodologjinë e përgatitjes së projektit, përgatisin fishat e projekteve. Deri me datën 15 shtator, ishin përgatitur mbi 100 fisha të tilla. Domethënë, qeveria shqiptare, institucionet, ministritë shqiptare kanë përgatitur, dhe kanë dërguar tek Sekretariati i Komitetit Kombëtar për Investimet mbi 100 projekt-ide. Ky është një numër për t'u lavdëruar.

Çfarë mund të përmirësohet? Në rradhë të parë, cilësia e përgatitjes së fishave. Cilësia ka qënë modeste. Por duhet thënë që është hera e parë që bëhet një ushtrim i tillë dhe ka vend për përmirësim. E dyta, sic e përmendi dhe z. Qehajaj nga Bashkia e Durrësit, nuk ka patur implikim të njëjësive të pushtetit lokal. Është e vërtetë që janë projekte strategjike, por sidoqoftë edhe për planifikimin urban dhe të territorit, mendoj që bashkitë që preken nga këto projekte mund të ishin konsultuar. E treta, janë identifikuar probleme të koordinimit ndërsektorial. Kjo ka qënë më e ndjeshme në sektorin social ku, për shembull, për projektet e arsimit është dashur të koordinohet Ministria e Arsimit për programin arsimor dhe Ministria e Infrastrukturës për infrastrukturën e ndërtimit të shkollës. Mbi të gjitha duhet marrë parasysh dhe përfshirja e projekteve në zhvillim e sipër dhe impakti në planifikimin buxhetor afatmesëm: Si ndikojnë projektet në zbatim e sipër në planifikimin buxhetor, krahasimisht me projektet e pafilluara të Procesit të Berlinit.

Në *hapiin e katërt* bëhet rankimi i këtyre projekteve në nivel sektori. Në paraqitje grafike kemi katër “tuba”, një për çdo sektor, ku secili permban disa projekte të përzgjedhura. Këto projekte rankohen sipas rëndësisë së tyre strategjike. Këtu do të ishte me vend, mendoj unë, që të identifikohesh mundësia ku shoqëria civile, akademikët, intelijenca, lobet e ndryshme do të kishin mundësi të jepnin kontributin e tyre.

Hapi i pestë është finalizimi i një listë me projekte të rankuara për çdo sektor – nga “katër tuba konvergjojmë në një tub”. Këtu fillojnë problemet strategjike, ku më i rëndësishmi është identifikimi i hapësirës buxhetore. Projektet që janë në tubin final – rreth 78 – kushtojnë mbi 2 miliard euro. Problemi tjetër është harmonizimi me IPA-n, domethënë ku ndërvepron instrumenti IPA me këto projekte, etj. Problemi i fundit qëndron tek vendimi final, i cili i lihet nivelit politik. Është kryeministri i cili vendos cilat janë projektet prioritare apo jo.

Pika e gjashtë është prodhimi i listës finale, që do t'u prezantohet donatorëve lista e vetme e projekteve prioritare strategjike. Ky është “tubi i vetëm i projekteve”, lista e vetme e projekteve. Tani Shqipëria është në këtë proces për momentin.



Hapi i fundit është mbyllja e procesit dhe miratimi nga Komiteti Kombëtar për Investimet.

Çfarë projektesh Berlini kemi ne në Shqipëri për momentin? Për momentin janë tre e gjysëm. Them tre e gjysëm, sepse tre janë të aprovuara dhe njëri është projekt kandidat. Projekti i parë i aprovuar është linja 400 KhV Fier-Elbasan-Bitolë (Maqedoni). Deri tani janë marrë grant 2.1 milion euro, plus 14 milion euro të tjera për investime në 2015. KfW ka rënë dakord në parim për të dhënë një kredi për 70 milion euro.

Projekti i dytë është projekti Adriatiko-Jonian. Është bërë studimi i fizibilitetit dhe vlerësimi i impaktit mjedisor më një grant prej 3.5 milion eurosh. Për ta bërë realitet projektin, duhen 800 milion euro kredi, që duhet t'i marri qeveria shqiptare. Në këtë kuadër, është aprovuar së fundmi studimi i fizibilitetit për rehabilitimin e hekurudhës Durrës-Pogradec, me një shumë 750 mijë eurosh.

Në nëntor 2015, kemi 78 projekte të rankuar sipas sektorit, numër të fishave të projekteve, numrit të vlerësuar të projekteve dhe kostos përkatëse. Vlera totale shkon në mbi 2 miliard euro. Pra, projektet që janë tani në vlerësim nga qeveria shqiptare kanë nevoja financimi prej 2 miliard eurosh.

Po e mbyllim me disa sfida për Samitin e Parisit. Së pari, është kompleksiteti i përgatitjes teknike. Së dyti, kosto e financimit të projekteve të infrastrukturës është rreth 2 miliard euro, a e përballon dot buxheti i Shqipërisë? Së treti, është ndërthurja e investimeve strategjike me strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe me strategjinë fiskale. Së katërti, është nevoja për koordinim më të mirë ndërsektorial edhe monitorim të progresit. Së pesti – dhe kjo na rri për zemër ne si ShtetiWeb – është mbivlerësimi që i bëhet infrastrukturës dhe jo manifakturës. Për neve mund të bësh rrugë shumë të mira, por nuk të hyjnë në punë në qoftë se nuk ke çfarë të shkëmbesh. Në fund të fundit, nuk përfitojnë prodhuesit vendore. Kështu që dhe manifaktura duhet të zërë vendin e saj të merituar. Së gjashti, në fakt një nga më të rëndësishmet, është roli i qytetarit dhe formalizimi i kontributit të rolit të shoqërisë civile në Procesin e Berlinit dhe zhvillimet e lidhura. Po e mbyll me nevojën për një vizibilitet më të lartë dhe mbështetje më të madhe nga të gjithë aktorët institucionalë për iniciativën e Konferencës së Përbashkët mbi Shkencën, e cila po zhvillohet në kuadër të Procesit të Berlinit, por që për momentin nuk ka vizibilitetin e duhur.

***“Agjenda e Qeverisë Shqiptare”* - ODETA BARBULLUSHI, Zëvendësministre e Punëve të Jashtme**

Është kënaqësi të paraqes perspektivën e vendit tonë në lidhje me Procesin e Berlinit nga pozicioni qeveritar. Megjithatë ky është një proces interqeveritar mes qeverive të vendeve pjesëmarrëse, sigurisht një komponent i rëndësishëm është shoqëria civile. Ky forum sot mund të thuhet se është një prej efekteve dhe produkteve të cilat i ka mobilizuar vet Procesi i Berlinit. Angazhimi i Ministrisë së Jashtme dhe i gjithë Qeverisë është që të punojmë ngushtë me të gjithë organizmat dhe aktorët joqeveritarë për të vazhduar dialogun e nisur në Vjenë, i cili do të vijojë edhe në vitet e ardhshme, në lidhje me gjithë zhvillimet, kufizimet dhe përfitimet e këtij procesi.

Procesi i lancuar nga Kancelarja Merkel, në një farë mënyre, krijoi hapsirën dhe i dha një shtysë të re bashkëpunimit mes vendeve tona. Është një proces i dallueshëm, i ndryshëm nga procesi i integritetit të vendeve të Bashkimit Evropian, por në të njëjtën kohë komplementar i procesit të anëtarësimit në BE.

Përveç Gjermanisë, që e lancoi këtë proces në gusht të 2014, kemi edhe një numër vendesh të tjera të Bashkimit Evropian, të cilat janë të investuara në mënyrë të drejtpërdrejtë në sigurinë, stabilitetin dhe integritetin evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor, siç janë Austria, Franca, Italia. Besoj që fjalët nuk mjaftojnë për ta theksuar se sa i rëndësishëm është ky proces, në sensin që krijon mundësinë e përfitimeve të prekshme dhe konkrete për qytetarët e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe në të njëjtën kohë i afron ato më pranë Bashkimit Evropian.

Agjenda e Procesit të Berlinit është ambicioze dhe bazohet në shtylla si infrastruktura, transporti, energjia, disi më pak mjedisi - por aty ka një hapsirë ku mund të punohet më shumë në konferencat e ardhshme të këtij procesi; ka shtyllën politike, e cila përfshin zgjidhjen e çështjeve bilaterale mes vendeve të Ballkanit Perëndimor para anëtarësimit të tyre në Bashkimin Evropian; si dhe komponentin e rinisë dhe dialogimin me shoqërinë civile.

Përsa i përket shtyllës së parë, do të përmend disa prej arritjeve kryesore të përgatitjes sonë në Samitin e Vjenës dhe hapat që po ndërmarrim deri në Samitin e ardhshëm në Paris. Përsa i përket infrastrukturës, projektet me të cilat u paraqitën vendet e Ballkanit Perëndimor në Vjenë ishin të gjitha projekte, që kanë të bëjnë me ndërlidhjen e këtyre vendeve përmes rrjetit bazë rajonal dhe ndërlidhjen energjitike përmes projekteve të Komunitetit të Energjisë.

Në Samitin e Vjenës u arritën të miratoheshin 10 projekte, 6 në infrastrukturën rrugore dhe 4 në infrastrukturën energjitike, një pjesë e mirë e së cilave do të mbulohen nga fondet IPA të Bashkimit Evropian. Nga këto dhjetë projekte, u miratua linja e interkonjeksionit mes Shqipërisë dhe Maqedonisë, vlera e investimit të së cilës për pjesën shqiptare arrin në 70 milion euro. Po ashtu, përveç këtyre projekteve të rëndësishme rajonale, ku disa prej tyre janë afatgjatë, vendet e Ballkanit Perëndimor ranë dakord për një listë masash “të buta” që do të implementohen përpara samitit në Francë në 2016.

Përveç aspektit të infrastrukturës energjitike, një prej aspekteve që u diskutua në Samitin e Vjenës ishte dhe efica energjitike, përfshirë këtu prodhimin, transmetimin, përdorimin eficient të energjisë në sektorin publik, si dhe përmirësimin e përdorimit të teknologjisë në këtë fushë. Në këtë kontekst mund të përmend konferencën e pak ditëve më parë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, në bashkëpunim me Ministrinë e Energjitikës, Ministrinë e Mjedisit dhe me Komunitetin e Energjisë. Në këtë konferencë u bë një vlerësim i kapaciteteve kombëtare dhe rajonale në fushën e energjisë, të shkallës së përputhjes së legjislacionit vendas dhe legjislacionit evropian në këtë fushë, si dhe u shpalosën disa prej elementeve bazë të një konceptimi të ri të energjisë, jo vetëm si çështje sigurie, por edhe si çështje që ka lidhje me zhvillimin ekonomik të rajonit.

Vizioni ynë politik është që stabiliteti në rajon dhe integrimi evropian nuk mund të jenë të qëndrueshëm pa një rritje të qëndrueshme ekonomike. Për këtë arsye Procesi i Berlinit duhet të konkretizohet në projekte të ndërlidhjes rajonale, të cilat kanë impakt ekonomik për vendet tona, forcojnë bashkëpunimin dhe ofrojnë përfitime të prekshme për qytetarët. Rivitalizimi i zgjerimit të Bashkimit Evropian nëpërmjet Procesit të Berlinit duhet të përkthehet në financimin e projekteve konkrete. Në këtë drejtim duhet përmendur hapësira e limituar buxhetore e vendeve tona. Për shkak të krizës ekonomike, buxhetet janë kryesisht të përqendruara në stabilizim, dhe jo në fillimin e projekteve të reja, aq më pak të kësaj shkalle apo impakti rajonal në nivelin infrastrukturor.


Paraqitja e projekteve sa më konkrete në Paris do të mundësonte një perspektivë të prekshme për qytetarët tanë dhe do të krijonte një rajon në kuptimin ekonomik të fjalës. Është perspektiva ekonomike, zhvillimore dhe infrastrukturore pikërisht ajo çka i mungon Ballkanit Perëndimor. Në këtë kontekst, Shqipëria ka ngritur Komitetin Kombëtar të Investimeve dhe disa prej projekteve prioritare janë: Porti i Durrësit, segmentet rrugore veri-jug pjesë e autostradës Adriatiko-Joniane, segmenti hekurudhor Durrës-Hani i Hotit dhe Aeroporti “Nënë Tereza”. Financimi i këtyre projekteve është parashikuar si pjesë e planifikimit të investimeve kombëtare. Në kuadrin e Procesit të Berlinit dhe në përputhje me vizionin politik të Qeverisë, planifikimi kombëtar i investimeve përfshin dhe komponentin rajonal, i cili bazohet tek nevoja e përmirësimit të infrastrukturës rajonale.

Përsa i përket komponentit politik, Procesi i Berlinit ka krijuar një moment shumë të mirë për forcimin e marrëdhënieve mes shoqërive të Ballkanit Perëndimor. Në Samitin e Vjenës, nëpërmjet deklaratës së përbashkët, vendet e Ballkanit Perëndimor ranë dakord të vazhdojnë të forcojnë bashkëpunimin rinor. Këtu do të përmendja inisiativën e dy kryeministrave të Shqipërisë dhe Serbisë në ngritjen e qendrave të përbashkëta rajonale rinore me seli në Tiranë dhe Beograd, sipas modelit të zyra rinore franko-gjermane. Këto qendra synojnë ripajtimin, dialogimin dhe normalizimin e marrëdhënieve mes shoqërive tona. Po aq i rëndësishëm është krijimi i mundësisë, instrumentave dhe hapësirës për të rinjtë, që të bashkëpunojnë në programe arsimore, të aplikojnë për fonde të përbashkëta në fushën e kërkimit shkencor, etj., si dhe në fushën e trajnimit profesional.

Pjesë e axhendës së Berlinit është zgjidhja e çështjeve bilaterale, që do të jetë prioritet në diskutimet e Samitit të Parisit. Në këtë drejtim, Qeveria shqiptare mbetet e angazhuar për të kontribuar në zgjidhjen e problematikave dypalëshe në rajon, në përputhje me frymën e fqinjësisë së mirë, me të drejtën ndërkombëtare dhe me bindjen për objektivin e integritetit të këtyre vendeve në strukturat euro-atlantike.

Dëshiroj të theksoj se Procesi i Berlinit është një iniciativë e skicuar për rajonin, në sensin që merr parasysh specifikat kontekstuale të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Avantazhi i dytë që sjell ky proces janë projektet që sillen në tryezë, të miratuara më përpara nga vet vendet e Ballkanit Perëndimor, çka demonstron me së miri shkallën e maturimit, emancipimit dhe bashkëpunimit mes këtyre vendeve.

Në mbyllje, në lidhje me bashkëpunimin me institucionet e tjera, me organizatat dhe aktorët e tjerë joqeveritarë, është e rëndësishme në këtë drejtim, si për bashkëpunimin rajonal dhe për integrimin evropian, që vet shoqëritë e vendeve tona të ndihen se janë pjesë dhe se ka një lloj hapësire për të folur dhe për të kontribuar. Objektivi i “local ownership” (pronësisë vendore) i këtij procesi është po aq i rëndësishëm sa dhe vet investiment ekonomike që do të përfitohen prej tij.



“Kontributi i Parlamentit (I)” - MAJLINDA BREGU, **Kryetare e Këshillit Kombëtar të Integritimit Evropian**

Ka një paradoks që bashkëjeton me procesin e integritimit evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Sot procesi është më afër realizimit të tij në krahasim me 15 apo 20 vjet më parë. Ekziston pothuajse njëpërdorim i përditshëm i konceptit të integritimit evropian në Ballkan. Nga një rajon në luftë, që pothuajse kundërshtoi në shekuj të jetojë në paqe, sot ai po përdor mprehtësinë e mendjes dhe jo britmat e luftës. Por, në qoftë se mprehtësia e mendjes, e cila verbalisht artikulon se destinacioni është Evropa e bashkuar, nuk përputhet me mençurinë për të ecur në mënyrë të qëndrueshme në rrugën e përmbushjes së detyrimeve – porzgjedh një rrugë të rreme – destinacioni përfundimtar do të jetë i largët. Ballkani ka shansin për të përsëritur dhe përforcuar mesazhin që uniteti dhe jo ndarja, respekti për diversitetin e njëri-tjetrit, arsyeja e forcës iluminuese dhe besimi në aftësinë për të bashkëpunuar, janë të vetmet garanci se zgjerimi i BE-së me vendet e rajonit tonë do të arrihet.

Stabiliteti dhe siguria janë investimet afatgjata për të gjithë kontinentin. Çdo konflikt i mundshëm ose vonesë e pakuptimtë për arsye të shpikjeve burokratike, të marrëdhënieve politike mes BE-së dhe një vendi që synon anëtarësimin drejt BE-së, është më kërcënuese për paqen dhe zhvillimin demokratik. Ndërsa krimi i organizuar është në veprim dhe nuk ndalon për të lexuar deklarata dhe rekomandime, unë besoj se ka ardhur koha të marrim në konsideratë se zgjerimi nuk mund të jetë pjesë e politikës së jashtme të BE-së më shumë se sa pjesë e politikës së saj të brendshme.


Ne kemi nevojë për të rritur energjinë e re pozitive të momentit, të krijuar nga Procesi i Berlinit, për perspektivën evropiane të Ballkanit Perëndimor. Vëmendja e Gjermanisë dhe Kancelares Merkel meriton të konsiderohet prioritet. Kjo qasje e Gjermanisë nuk është flirtim, por politikë gjeo-strategjike, e cila meriton një qasje reciproke, serioze nga ana jonë. Ndërtimi i rrugëve, hekurudhave, infrastrukturës energjike dhe detare mbetet sot dhe gjithmonë, çelës për zhvillimin e ekonomive tona. Kjo është platforma ku Shqipëria dhe Kosova, së bashku me vendet e tjera të rajonit, mund të paraqesin projekte ambicioze.

Duke mirëpritur përfshirjen e shoqërisë civile, si një element shtesë i rëndësishëm i Procesit të Berlinit, qëndrimi im mbështet fortë idenë se parlamentet kombëtare të vendeve të Ballkanit Perëndimor duhet të bëhen pjesë e bashkëpunimit të ri mes vendeve tona dhe me BE-në, çka është vënë tashmë në lëvizje nga ky proces. Roli thelbësor i parlamenteve kombëtare në mbikqyrjen e politikave përkatëse të integritimit në BE do të forcohet më tej me përfshirjen e tyre në Procesin e Berlinit, çka do të kontribuojë gjithashtu në forcimin e stabilitetit politik dhe në përmirësimin e klimës politike të rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Nga Samiti i Vjenës për Ballkanin Perëndimor kam diskutuar me kolegët e rajonit, me përfaqësues të Parlamentit Evropian dhe të Komisionit Evropian, dhe të gjithë ranë dakord të mbështesin

propozimin tim për një përfshirje më të madhe të Parlamenteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Procesin e Berlinit. Unë besoj fuqimisht se një dimension parlamentar i Procesit të Berlinit është një parakusht që do të sigurojë intensifikimin e mëtejshëm të reformave të nevojshme për fazat e ardhshme të procesit të integrimit dhe për një bashkëpunim të përfortuar rajonal.

Për këtë arsye, së bashku me kolegët e Konferencës së Komisioneve Parlamentare për Integrimin Evropian të vendeve që marrin pjesë në Procesin e Stabilizim-Asociimit të Europës Jug-Lindore në (COSAP), i kemi paraqitur Ministrit francez të Punëve të Jashtme dhe Zhvillimit Ndërkombëtar, Presidentit të Parlamentit Evropian dhe Presidentit të Komisionit Evropian propozimin për krijimin e një Forumi Parlamentar në kuadrin e Samitit të ardhshëm për Ballkanin Perëndimor që do të mbahet në Paris.



“Kontributi i Parlamentit (II)” - EDUART SHALSI,
Kryetar i Komisionit Parlamentar për Veprimtaritë Prodhuese,
Tregëtinë dhe Mjedisin

Të nderuar pjesëmarrës,

E prita me shumë kënaqësi ftesën që më drejtoi miku im vjetër, z. Haçkaj, për dy arsye: ishte hera e dytë që më ftonin për të folur mbi Procesin e Berlinit dhe të them të drejtën që nga hera e parë kam pësuar edhe unë një ndryshim të brendshëm dhe ndjem më i përgatitur. Herën e parë m'u drejtua një pyetje: “Si mund të marrim një informacion në lidhje me Procesin e Berlinit? Duhet të trokasim në ndonjë agjenci qeveritare? Duhet të shfletojmë gazetat? Cilin mjet duhet të përdorim?”. Në fakt, nuk kishte një website; kishte lajme por jo informacion të strukturuar, të thjeshtë, të qartë, të kuptueshëm mbi këtë proces.

Këto pyetje më bënë të reflektoj dhe të informohem më mirë se çfarë synon ky proces. Procesi i Berlinit synon që vendet që aspirojnë për t'iu bashkuar Europës të mos trajtohen si të izoluar por të trajtohen si një bllok, si një rajon. Deri më sot përpjekjet e Shqipërisë, Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi për t'iu bashkuar Europës kanë patur një qasje individuale. Ky proces nuk është i vetmi; ka një iniciativë siç është Komuniteti i Energjisë, që trajton rajonin si një të vetëm për çështjet energjitike, një rrjet që merr përsipër të gjykojë edhe për prioritetet e zhvillimit dhe të investimeve në energji, duke u nisur jo vetëm nga nevojat e secilit vend. Pra, procesi synon të integrojë rajonin si një tërë, duke vendosur ura më të thella komunikimi midis vendeve të ndryshme.

Katër vjet më parë, në legjislaturën e kaluar kam qënë nënkryetar i Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit. Si kryetar kam mësuar diçka të rëndësishme: sa herë që ka një ligj apo debat parlamentar, sa më shumë njerëz të përfshish apo t'i japësh mundësinë për t'u përfshirë në debat, aq më i mirë do të jetë produkti. Ndaj e nisa me rëndësinë e informacionit. Sa më shumë njerëz të jenë të informuar, sa më shumë njerëzve t'i japësh mundësinë për të kontribuar, aq më i mirë dhe aq më rezultativ do të jetë procesi.

Procesi i Berlinit është i ndërlikuar. Kosto është një element për t'u marrë në konsideratë. Por ka edhe elementë të tjerë, sidomos në grupin e aktorëve, që mund të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë proces – sikurse është Parlamenti. Duhet të pohoj që jo gjithmonë Parlamenti ka qënë në nivelin ku qytetarët e prisnin apo nevoja e vendit e kërkonte. Ju jap një rast të thjeshtë, atë të komisioneve parlamentare: në shumicën e rasteve kanë qënë – disa vazhdojnë të mbeten – anekse të Qeverisë. Roli i tyre mbikqyrës ka qënë i zbehtë. Madje edhe në rastet kur tentohej të ushtrohej ky rol, trysnia e qeverive ka qënë gjithmonë e madhe. Në këtë moment, do të thoja që kushtet janë pjekur dhe disa komisione po luajnë në mënyrë aktive rolin e monitorimit të Qeverisë.


Mendoj që duhet institucionalizuar pjesëmarrja e parlamentarëve të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Procesin e Berlinit. Pjesëmarrja mund të realizohet në forma të ndryshme. Kjo është vetëm

fillesa e një debati ku duhet të kuptojmë Parlamentin me të gjithë komponentët – të maxhorancës dhe opozitës. Procese të tilla janë shumë të rëndësishme që të mos marrin meritën e një grupi politik, por të kenë të përfshirë sa më shumë faktorë tëndryshëm nga spektri politik. Parlamenti mund të përgatisë pyetje, rezoluta apo raporte se ku ishim një vit më parë dhe ku jemi sot. Çfarë është realizuar nga ajo që pritej përpara një viti dhe për çfarë do të flasim në samitin e tretë.

A është ky një proces qeveritar apo kombëtar? Sigurisht që do t'a vendosja theksin tek aspekti kombëtar. Qeveria ka rolin e vet, por aktorët – për të patur vijimësi procesi – duhet të përfshihen nga të gjithë pjesët e spektrit politik. Unë këtu kam një eksperiencë pozitive në komisionin që drejtoj, duke nxjerrë mësim nga Parlamenti i kaluar, se rezultati në hartimin e një ligji është shumë më i mirë sa më shumë bëhen pjesë e diskutimit dhe merren në konsideratë sugjerimet, vërejtjet, komentet e kundërshtarëve politike.

Shpesh herë, kur flasim për projekte, gjeja e parë që na shkon në mendje është aspekti i kostos së projektit. Kemi shembuj në Shqipëri se si për shkak të një mungese planifikimi adekuat që nga fillimi, fondet nuk janë shpenzuar në mënyrë efikase. Janë të panumërt shembujt ku kemi para të investuara, ndërkohë rentabilitetin e investimit nuk e kemi matur. Janë me dhjetra projekte dhe ne kemi marrë vetëm një aspekt – atë të ujit – të cilin po e monitorojmë me shumë kujdes. Janë qindra miliona euro të shpenzuara në sektorin e ujit, ndërkohë kanë qënë të pakoordinuara. Nuk ka patur një vizion apo një roadmap se ku jemi, ku synojmë të shkojmë dhe si do të shkojmë nga njëra hallkë tek tjetra.

Ka disa çështje kombëtare ku pavarësisht ndryshimit të qeverive, vizioni duhet të mbetet. Sa më mirë të planifikohet, aq më i garantuar është rezultati pozitiv. Në këtë kontekst, do të thoja që në qoftë se po flasim për rolin e Parlamentit dhe forcimin e dimensionit politik, përfshirja do të jetë një moment shumë i rëndësishëm. Sfida është e madhe dhe nuk jemi të përgatitur për t'i dhënë përgjigje çdo lloj pyetjeje mbi rolin e parlamentareve.



“Kontributi i Parlamentit (III)”- GENC POLLO, Kryetar i Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

Procesi i Berlinit është shumë i rëndësishëm në kuadrin e qëndrimeve të politikës së jashtme apo europiane të Shqipërisë, ku prej vitesh ka një konsensus në thelb.

Mendoj që shkaqet që ndikuan në krijimin e Procesit të Berlinit mund të përmbliidhen në tre. I pari është gjeopolitik - rishfaqja agresive e Rusisë me pretendime hegjemonike në Ballkan, kundrejt influencës europiane apo euro-atlantike. Pra ishte një lëvizje e mirë për të dëshmuar vullnetin e qeverive dhe të shoqërive, që perspektiva e tyre europiane – dhe direkt ose indirekt ajo atlantike – është e konfirmuar edhe nga shtete të rëndësishme, si Republika Federale Gjermane.

E dyta, lidhet me procesin e integritit dhe perspektivën e anëtarësimit – e hapur me Samitin e Selanikut në vitin 2003 – dhe lënë disi në hije. Komisioni Evropian ka patur një politikë afatgjatë, ku është zbatuar parimi “regata” dhe ku çdo vend gjykohet nga meritat e veta në përmbushjen e kriterëve të anëtarësimit, duke filluar me të ashtëquajturit “Kritere të Kopenhagenit” dhe duke vazhduar me aftësinë për të adoptuar dhe zbatuar *acquis communautaire*, pra legjislacionin evropian. Në parimin e “regatës” gjithkush nxitet për të avancuar përpara; por, parimi i konkurrencës jo gjithmonë mund të funksionojë.

Deri më tani ka munguar dimensionin ndër-rajonal dhe në këtë drejtim Procesi i Berlinit është i rëndësishëm dhe i dobishëm. Ajo që ne shohim sot në terma konkrete dhe pozitive është fakti që qeveri të ndryshme nxiten të bëjnë projekte të përbashkëta – kryesisht infrastrukturore – të rëndësishme, por jo të mjaftueshme për zhvillimin e përgjithshëm dhe për perspektivën europiane.

Megjithatë, fondet janë po ato. IPA, në planin shumëvjeçar financiar të Bashkimit Evropian, është po ajo që ka qënë përpara se Berlinit të ndërmernte këtë inisiativë. Qeveria, opozita, populli shqiptar – e njëta gjë do thuhet për vendet aspirante të Ballkanit Perëndimor – do kishin dashur të dëgjonin për fonde shtesë, që të justifikonin ato projekte, që quhen “të reja” sipas Procesit të Berlinit. Ato fonde ishin parashikuar për përafrimin dhe aftësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, por vërejmë një rialokim të tyre nga një projekt në tjetrin. Megjithëse të gjithë jemi dakord për nevojën e infrastrukturës, nuk mund të biem dakord për domosdoshmërinë, dobinë dhe nevojën e një realokimi të tillë.

Gjykoj vërtet pozitive nismën për më shumë shkëmbime rinore, bazuar në modelin franko-gjerman. Shkëmbime të tilla sigurojnë një bazë më të gjerë mirëkuptimi mes shoqërive të Ballkanit, që kanë nevojë për ta parë njëri-tjetrin jo në prizmin e armikut, por ta njohin në raporte njerëzore. Kjo sjell me vete shpresën që në të ardhmen shoqëritë do të kenë një imazh dhe një ndërveprim, që do të jetë shumë më i civilizuar seç ka qënë në të shkuarën.

Përtej listës pozitive të gjërave që sjell Procesi i Berlinit, për fat të keq kemi vënë re dhe një instrumentalizim për promovim vetjak. Në Samitin e Vjenës pati një ndeshje futbollit ku në një anë luanin politikanët e Ballkanit dhe në anën tjetër politikanë të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian. Stilizimi i kryeministrave të Ballkanit si Adenauer dhe De Gaulle i shekullit të XXI është ahistorik dhe nuk ka ndonjë qëllim paqtimi, por vetëm vetpromovim. Unë do të besoj që pushtetmbajtësit e Ballkanit – këtu nuk do të bëja dallim midis të majtëve dhe të djathtëve, të sotmëve, të djeshmëve dhe shpresoj jo atyre të të nesërme – jo vetëm që do të luanin futboll nëse kjo do të ndihmonte në ruajtjen e pushtetit, por do të ishin gati të bënin edhe martesë dinastike për ruajtjen e pushtetit.

Në vijim të pjesëmarrjes sime në konferencën “Speak Up” në Bruksel gjatë ditëve të fundit, ajo që u vu në dukje nga përfaqësuesit e lartë të Komisionit Evropian është degradimi sistematik i medias gjatë 12-15 viteve të fundit. Me shembuj që kërcasin nga Shqipëria, Kosova dhe Serbia, pushtetarët nuk kursejnë të përdorin dhe kërcënime direkte për t’u mbyllur gojën gazetarëve investigativ, që zbulojnë skandale të mëdha financiare. Kjo është diçka shqetësuese dhe kam përshtypjen se nuk ka gjetur ekon e duhur në Procesin e Berlinit. Procesi do lipsej t’i jepte një shtysë “Kritereve të Kopenhagenit”.

Tre autostradat që kalojnë nga Mali i Zi, përmes Shqipërisë dhe Greqisë, do të sillnin një zhvillim ekonomik, por nevojitet forcimi i institucioneve të shtetit ligjor, kultura demokratike, përfshi dhe lirinë e medias.

Në nivel të brendshëm, ne kemi një problem specifik dhe do të ishte një ndihmë e madhe për Shqipërinë sikur dekriminalizimi të ishte trajtuar në një nga hallkat e Procesit të Berlinit. Kjo do të mundësonte një kornizë të nevojshme dhe do të ndihmonte realisht vende si Shqipëria. Mora rastin konkret të dekriminalizimit, sepse është shumë aktual në Shqipëri. Në qoftë se kjo konferencë do të mbahej në Beograd, në Prishtinë apo në Mal të Zi do të kishim tema të tjera të ngjashme.

Këto janë tema reale që e përgatisin Shqipërinë dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor për të qënë më afër dhe një ditë anëtarë të BE-së, çka është dhe objektivi final i deklaruar që në mbledhjen e parë të iniciuar nga Kancelarja Merkel në gusht të vitit të kaluar dhe besoj që kjo do të ishte një ndihmë e mirë edhe për Shqipërinë.

